



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 17 NËNTOR 2022**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 17. NOVEMBRA 2022. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR  
2022**

## **Rendi i ditës**

1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
2. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
3. Pyetjet parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

## **Dnevni red**

1. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
2. Izjave van dnevnog reda,
3. Parlamentarna pitanja,
4. Prvo razmatranje N/zakona br. 08/L-193 o budžetskim izdvajanjima budžeta Republike Kosovo za 2023. godinu.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, ju njoftoj se me kërkesë të Kuvendit dhe sipas rekomandimit të KQZ-së, presidentja e Republikës së Kosovës e ka nxjerrë Vendimin nr. 74/2022 për zëvendësimin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës si në vijim:

Deputeti Milan Kostiq, kandidat i subjektit politik Lista serbe, e zëvendëson deputetin Slavko Simiq, për shkak të dorëheqjes së tij,

Deputeti Zoran Maksimoviq, kandidat i subjektit politik Lista serbe, e zëvendëson deputetin Igor Simiq, për shkak të dorëheqjes së tij,

Deputetja zonja Olivera Zdravkoviq, kandidate e subjektit politik Lista serbe, e zëvendëson zonjën Milijana Nikoliq, për shkak të dorëheqjes së saj,

Deputeti Milan Jaksimoviq, kandidat i subjektit politik Lista serbe, e zëvendëson zotin Zoran Mojsiloviq, për shkak të dorëheqjes së tij,

Deputetja zonja Ksenija Bozoviq, kandidate e subjektit politik Lista serbe, e zëvendëson zonjën Verica Qeraniq, për shkak të dorëheqjes së saj,

Deputeti Rados Mihajloviq, kandidat i subjektit politik Lista serbe, e zëvendëson zotin Branislav Nikoliq, për shkak të dorëheqjes së tij,

Deputeti Nenad Radenkoviq, kandidat i subjektit politik Lista serbe, e zëvendëson zotin Milosh Peroviq, për shkak të dorëheqjes së tij,

Deputeti Svetislav Jokiq, kandidat i subjektit politik Lista serbe, e zëvendëson zotin Lubinko Karaxhiq, për shkak të dorëheqjes së tij,

Deputetja zonja Biljana Maksiq, kandidate e subjektit politik Lista serbe, e zëvendëson zonjën Jesmina Dediq, për shkak të dorëheqjes së saj, si dhe

Deputeti Svetko Velkoviq, kandidat i subjektit politik GI za Slobodu, Pravda i Opstanak, e zëvendëson zonjën Dragana Antonijeviq, për shkak të dorëheqjes së saj.

Deputetët e rinj, me sa po e shoh, i kemi të pranishëm, kështu që tekstin e betimit të deputetit e kanë para vetes.

Për ta përmbushur këtë detyrim rregull në Kuvendin e Kosovës është që të ngriheni në këmbë, ta dëgjoni tekstin që e lexoj unë dhe në fund ta shqiptoni së bashku fjalën Betohem.

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do të përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë shtetasve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e sovranitetit, tërësisë territoriale dhe integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në përputhje me ligjet e vendit. Betohem!

I lus deputetët që personalisht ta nënshkruajnë tekstin e betimit dhe t'ia dorëzojnë atë Shërbimit të Deputetëve.

E kemi kuorumin e pranishëm.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

## **1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme**

Deputetë të nderuar,

Ju pyes nëse keni vërejtje në procesverbalin e seancave të mbajtura më 8 nëntor 2022? Nëse nuk ka vërejtje askush prej deputetëve, konstatoj që procesverbali i seancave të 8 nëntorit u miratua.

## **2. Deklarimet jashtë rendit të ditës**

Fjalën prej Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes e ka kërkuar deputetja Fitore Pacolli-Dalipi. Flisni në emër të grupit?

FITORE PACOLLI-DALIPI: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderur qytetarë,

Sot sa po u ktheva nga Sharm EL-Sheik në Egjipt, ku po mbahet konferenca e 27 e OKB-së për ndryshime klimatike, apo e njohur me emrin Konferenca e Palëve apo COP.

Kjo është hera e parë që Kosova po merr pjesë fizikisht dhe po përfaqësohet në nivelin qeveritar nga ministri i Mjedisit, zoti Liburn Aliu, i cili po vazhdon takimet bilaterale edhe sot, dhe në nivel parlamentar nga unë me ftesë të ministrit në cilësinë e kryetares së Komisionit për Mjedis.

Për dallim prej konferencës së kaluar COP27, ku me ndihmën e UN Habitatit, në pamundësi për të marrë pjesë fizikisht, më është mundësuar që në cilësinë e kryetares së Komisionit ta prezantoj Kosovën vetëm në një aktivitet përmes platformës Zum, kësaj radhe pjesëmarrja e Kosovës në COP27 e mundësuar nga Qeveria gjermane është unike dhe ka rëndësi të veçantë, sepse jemi fizikisht në COP27 dhe kemi shumë takime bilaterale.

Po ashtu për herë të parë Kosova organizon aktivitetin e saj, i cili do të mbahet këtë të premte në pavijonin gjerman, ku ministri Aliu dhe unë do të prezantojmë politikat e Qeverisë së Kosovës dhe plotësimet legjislativë për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike.

Në të gjitha takimet tona bilaterale me shtetet aleate dhe sot i kemi informuar se Komisioni Ndërministror për Ndryshime Klimatike, i themeluar nga Qeveria e Kosovës në janar të vitit 2022, ka filluar punën e hartimit të ENDISI-ve të Kosovës në mënyrë që të bëjmë të gjitha përgatitjet për ratifikim të njëanshëm të Marrëveshjes së Parisit.

Qeveria e Kosovës synon që brenda periudhës 2023 dhe 2024 në mënyrë unilaterale të ratifikojë Marrëveshjen e Parisit. Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, përveç Kosovës, e kanë ratifikuar këtë marrëveshje.

E mbi të gjitha po kërkojmë që Kosova të ketë të drejtën e qasjes në fonde dhe në negociata për ndryshime klimatike.

Në të gjitha takimet tona bilaterale përfaqësuesit e shteteve aleate u pajtuan se qasja në fonde dhe negociata mbi parimin e OKB-së për gjithëpërfshirje është kërkesë e drejtë dhe se do ta mbështesin Kosovën, ndonëse është një proces i vështirë, por jo i paarrtshëm.

Kërkesa jonë në fonde dhe në negociata do të theksohet edhe në aktivitetin e Kosovës që do të mbahet këtë të premte në COP27. Pjesëmarrja në fonde dhe negociata është shumë e rëndësishme, e sidomos për shtetet në zhvillim siç është Kosova.

Të nderuar deputetë,

Raporti i pestë i panelit ndërkombëtarë për ndryshime klimatike ka konstatuar se Ballkani Perëndimor, ku bën pjesë edhe Kosova, do të ndikohet nga ndryshimet klimatike me rritje të temperaturave, reshje të paparashikueshme, thatësira dhe zjarre në pyje.

Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, përveç Kosovës, kanë qasje në negociata dhe në fonde për ndryshime klimatike.

Edhe pse OKB nisat nga parimi Let no one be left behind që do të thotë “Të mos lihet askush prapa”, OKB-ja po e lë Kosovën prapa, duke ia mohuar qasjen në fonde dhe në negociata.

Kosova nuk është anëtare e OKB-së, por kjo assesi nuk guxon të përdoret si arsye për mospërfshirjen e Kosovës kur bëhet fjalë për ndryshime klimatike.

Ndryshimet klimatike nuk njohin kufij. Kosova ndikohet dhe ndikon në ndryshimet klimatike, prandaj parimi i OKB-së për gjithëpërfshirje duhet të aplikohet dhe në rastin e Kosovës. Kosova nuk mund të përgatitet e as të ballafaqohet me ndryshime klimatike pa marrë parasysh vullnetin tonë, pa mbështetje aktive nga organizatat ndërkombëtare, e sidomos nga OKB-ja. Prandaj, kërkesa jonë në fonde dhe në negociata do të ritheksohet në të gjitha takimet tona bilaterale që do t'i kemi ditëve në vijim në konferencën COP27. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të PDK-së, flet Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Konjufca!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Njëra prej dilemave kryesore që e kam sot është se si mund t'i adresohesh një qeverie pa ide, si mund t'i adresohesh një qeverie pa vizion, pa punë dhe e cila nuk bën po thuajse asgjë çka duhet të bëjë, e kur nis të bëjë, e bën mbrapshtë duke lënë pasoja të gjithanshme.

Brenda një jave, kolegë deputetë, kanë ndodhur disa veprime jonormale me protagonist Qeverinë e Republikës së Kosovës, prej të cilave është poshtëruar e kaluara, është bërë qesharake e tashmja dhe është rrezikuar e ardhmja.

Sikur nuk mjaftoi skandali i financimit nga Qeveria e Kosovës të artikullit në revistën franceze, ku Kosova përshkruhet si vend i trashëgimisë ortodokse serbe. Në pah doli edhe një skandal tjetër, ai i nderimit të një pllake përkujtimore me ushtarë serbë. Pra, garda e FSK-së i ka qëndruar në nderim një pllake përkujtimore për ushtarët serbë të rënë gjatë viteve 1912-1918. Përkujtimi i datës të përfundimit të Luftës së Parë Botërore në vetvete nuk përbën ndonjë problem, përkundrazi, për shumë vende shndërruan në ditën e veteranëve, kur edhe bëhen thirrje për paqe, duke kujtuar se çfarë shkatërrimesh ka sjellë lufta.

Skandali, kolegë deputetë, qëndron në faktin që homazhet u bën para një monamenti që glorifikonte të rënët e ushtrisë serbe gjatë viteve 1912-1918, pra jo vetëm ata të Luftës së Parë Botërore, por edhe ata ushtarë, të cilët pushtuan Kosovën dhe zhvilluan dy luftëra ballkanike që rezultuan me dhjetëra-mijëra shqiptarë të vrarë dhe qindra mijëra të dëbuar drejt Turqisë dhe Shqipërisë.

Masakrat ndaj civilëve u dëshmuar dhe u raportuar nga qindra gazetarë evropianë që i ndoqën konfliktet nga afër. Prandaj, nderimi i FSK-së ndaj atij lapidari poshtëron kujtimin e dhjetëra-mijëra paraardhësve tanë civilë të pafajshëm që u shfarosën nga ushtarët serbë që nderon ai lapidar, duke përbërë një akt të turpshëm, një akt fyes dhe një akt poshtëruar ndaj shqiptarëve. Dhe kështu nuk kanë asnjë faj ushtarët e FSK-së.

Unë sot nuk kam dalë këtu që t'i fajësoj ata. Ata vetëm zbatojnë urdhra, urdhërdhënësit e FSK-së nuk kanë faj, sepse ata i përgjigjen detyrës së tyre. E detyra e tyre është t'i përgjigjen kontrollit civil të ushtrisë sonë.

Për më tepër është një papërgjegjshmëri ndaj vuajtjeve të shqiptarëve dhe nuk do të doja të mendoja që është bërë me vetëdije një akt i tillë nga ministri Sveçla. Në rastin më të keq, nëse

është bërë me vetëdije të plotë, atëherë do të përbente një akt të rëndë e të turpshëm, antikombëtar që do të kishte hak kërkimin e dorëheqjes nga vetë kryeministri Kurti.

Dorëheqja morale do të duhej të ishte virtyt e adresimi i përgjegjësisë institucionale detyrë, këta nuk e kanë bërë asnjërin e nuk e kanë bërë as tjetrën, nuk e kanë bërë as virtytin e as përgjegjësinë.

Në një vend normal me institucione të përgjegjshme, Ministria e Mbrojtjes do të duhej të jepte shpjegime për gafën e prezencës së Gardës së Nderit në një monument serb të dedikuar veprimtarisë së ushtrisë së tyre, që përbëjnë një nga periudhat më kulminante të gjenocidit ndaj shqiptarëve. Me këtë rast, një kërkimfalje publike do të ishte më e pakta që do të duhej kërkuar.

Përkundrajt ambasadave që janë të akredituara në Kosovë e jo në Serbi, një ministri serioze, kolegë deputetë, një Ministri serioze e Punëve të Jashtme të Kosovës do të duhej të kërkonte sqarime përse është zgjedhur prej tyre që të bëhen homazhe pikërisht në një monument serb kontravers, që përkujton një periudhë traumatike për historinë dhe për memorien kolektive të popullatës së Kosovës.

Në vend të kësaj, të dashur qytetarë të Kosovës, ministrja Gërvalla s'ka të ndalur me gafat e saj. Kaq deficit ka në punën e saj, si ministre e Jashtme e Kosovës, kaq larg rrjedhës së ngjarjeve që është ajo në punën e vet, sa që del diçka si puna e raketave në Poloni, e bëhet gaz i botës me deklaratat e saj për NATO-n e BE-në për të plotësuar deficitin e punës së saj. Dhe, është me të vërtetë shumë qesharake se ku ka përfunduar sot diplomacia jonë.

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës konsideroj që Kosova meriton një qeverisje krejt tjetër. Por, derisa një e tillë të bëhet, neve nuk na mbetet asgjë tjetër, përveçse të kërkojmë prej kësaj qeverie vetëm një gjë, aman mos na bëni horë! Sepse, në këtë rast vetëm sherrin jemi duke ua parë. Kaq ka mbetur të kërkohet prej jush. Po e përsëris, aman, mos na bëni horë!

**KRYETARI:** Fjalën e ka kryetari i Grupit të AAK-së, Besnik Tahiri.

**BESNIK TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Dje Kosova nga Brukseli e mori edhe një lajm të keq, atë që ndërlidhet drejtpërdrejt me liberalizimin e vizave. Si Kuvend nuk mund të rrimë të heshtur dhe nuk mund të mos reflektojmë

në një paaftësi serioze të Qeverisë në raport me trajtimin e agjendës së integrimit evropian, mirëpo edhe të liberalizimit të vizave.

Vetëm kthehuni prapa nja dy muajsh dhe lexojini deklaratat, prej kryeministrit, zëvendëskryeministrit, ministrave, në raport me liberalizimin e vizave. Do të thotë, e patën sjellë aq afër, sa që me të vërtetë është duke e vendosur kjo qasje, kjo paaftësi serioze Kosovën në një situatë jashtëzakonisht të pafavorshme.

Nuk ka asnjë informacion, as tash e as më herët, se çka është duke ndodhur. Agjenda e integrimit evropian, agjenda e Qeverisë për të filluar procedurën e kandidimit në Unionin Evropian si vend kandidat, është qorrsoak. Me këtë qasje, me këtë mënyrë të komunikimit dhe me këtë anashkalim, që i bëhet Kuvendit dhe qytetarëve, realisht është një keqardhje e madhe.

Liberalizimi i vizave, të gjithë e dimë, është një arritje meritore e të gjitha qeverive veç e veç. Të gjitha e kanë dhënë kontributin e vet. Mirëpo, paaftësia dhe pazotësia për ta trajtuar këtë temë dhe keqinformimi i qytetarëve me të vërtetë është për secilën kritikë. Unë kërkoj nga kryeministri që dy çështje t'i sqarojë rreth kësaj teme. E para, çka ka ndodhur dhe në raport me liberalizimin e vizave dhe ku jemi? Dhe, e dyta, a e ka në plan ta procedojë kërkesën për vend kandidat, duke e ditur se Ukraina dhe Moldavia e kanë marrë këtë vendim nga Unioni Evropian, si vendim politik, jo si vendim teknik. Pra, përderisa është diskutuar gjithmonë që vendet mund të jenë candidate vetëm atëherë kur të përmbushin aspektet teknike, e dimë që me rastin e Ukrainës dhe me rastin e Moldavisë kriteret nuk kanë qenë teknike, por politike dhe në pritje është edhe Gjeorgjia.

Tash, prej kryeministrit i dua dy sqarime. E para, ku jemi sot me liberalizim dhe ku është agjenda evropiane? Dhe e dyta, a e ka në plan për të kandiduar?

Kërkesa jonë si Grup Parlamentar i AAK-së është për ta bërë kandidaturën, pra të përgatitet dokumentacioni për vend kandidat dhe atë në këtë vit, në mënyrë që të shohim se cili do të jetë reagimi nga pala tjetër. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e merr deputetja Fatmire Kollçaku.

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Faleminderit, kryetar!

Dy ditë më parë, saktësisht më 15 nëntor, në Kuvend të Republikës së Kosovës, me përkrahjen tuaj dhe në bashkorganizim me UNFPI-in ne festuam shënimin e banorit të tetëmiliardtë, apo lindjen e banorit. Dhe, më 15 nëntor 2022 popullsia e botës u rrit në 8 miliardë njerëz. Një moment historik për zhvillimin njerëzor.



Kjo rritje, në mes tjerash për shkak të rritjes graduale të jetëgjatësisë njerëzore, për shkak të përmirësimeve në shëndetin publik globalisht, të ushqyerit, higjienës personale dhe mjekësinë. Është gjithashtu edhe rezultat i niveleve të larta dhe të vazhdueshme të lindshmërisë në disa vende, por fatkeqësisht kryesisht në vendet e varfra dhe ulje e lindshmërisë në vendet e zhvilluara.

Ndërsa, popullsisë globale iu deshën dymbëdhjetë vjet për t'u rritur nga shtatë në tetë miliardë, do të duhen afërsisht pesëmbëdhjetë vjet deri në vitin 2037 që ajo të arrihet në nëntë miliardë. Një shenjë e ritmit të përgjithshëm të rritjes së popullsisë globale, pra rritja e popullsisë globale në fakt po ngadalësohet.

Është koha e fundit që të reflektojnë edhe vendet e zhvilluara në raport me vendet e pazhvilluara. Ne e dimë që në kohën e globalizmit, ku ndikimet e mëdha klimatike, epidemitë që lehtësisht po shndërrohen në pandemi, konfliktet që kanë tendencë zgjerimin, pabarazia e theksuar aty ku e ceka që ka lindshmëri më të lartë, ndërsa aksesit në shërbime shëndetësore e në edukim është shumë më i ulët, tregon se sëmundjet, ndryshimet klimatike, për shkak të zhvillimit industrial nuk njohin kufi. Prandaj, është obligim që të investohet çdo kund që mirëqenia të jetë obligim i të gjithë neve, të eliminohen të gjitha pabarazitë.

Pra, ne duhet të kuptojmë dhe të parashikojmë tendenca demografike, në mënyrë që qeveritë të mund të bëjnë politika të informuara dhe shpërndarje të burimeve për të pajisur popullsitë e tyre me aftësitë, rrjetet dhe mundësitë e duhura. Por, ndërsa tendenca demografike mund të ndihmojnë në drejtimin e zgjedhjeve të politikave që bëjnë shoqëritë, ka zgjidhje të tjera, duke përfshirë dhe se ne ku dhe kur duhet të kemi fëmijë, kjo politikë nuk mund të diktohet, sepse ato i përkasin çdo individ.

Prandaj, është obligim i shteteve që të bëjnë politika të mençura, duke përkrahur çifte të reja, të cilat në pamundësi fatkeqësisht edhe në Kosovë kemi një zvogëlim të lindshmërisë, gjë që vit pas viti do të fillojë të jetë problem dhe bazuar në statistika që janë prezantuar dhe ditën kur e organizuam në Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm atë konferencë që ishte...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia zgjatni edhe pak fjalën deputetes, ju lutem!

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Faleminderit!

Desha vetëm edhe një para deputetëve të Republikës së Kosovës, të cilët e dinë fort mirë se ne në vitin 2018 kemi miratuar një rezolutë, e cila obligon të gjitha institucionet në zbatimin e agjendës 20/30. Ky këshill është në Kuvend të Republikës së Kosovës në formë të një trupi koordinues, ku participojnë kryesisht kryetarë të komisioneve në emër të anëtarëve të tjerë, ku kemi përfaqësues

të zyrës së kryeministrit, zyrës së presidentes, jemi të mbështetur nga agjenci të Kombeve të Bashkuara dhe nga OJQ-të, por edhe sektori privat, që është koha e fundit që të reflektojmë, të gjithë të orientohemi në agjendën 20/30 dhe të monitorojmë përfshirjen e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm, ku një ndër objektivat kyçe është eliminimi i pabarazisë dhe ulja e varfërisë. Unë mendoj që edhe Buxheti, i cili sot do të miratohet, është pikërisht reflektim i këtij synimi të Qeverisë së Republikës së Kosovës në rend të parë për uljen e varfërisë dhe eliminimin e pabarazisë.

Ftoj kolegët deputetë, që të jenë shumë më aktivë në punimet e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm, bazuar në obligimin që kemi marrë të gjithë në rezolutën e miratuar pikërisht këtu në vitin 2018.

**KRYETARI:** Fjalën tash e ka deputetja Ariana Musliu-Shoshi.

**ARIANA MUSLIU-SHOSHI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Zoti kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot Kosova ndodhet në një udhëkryq të madh sa i përket kredibilitetit të saj si partner i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian.

Përderisa bota po ballafaqohet me sfida nga më të ndryshmet, të cilat po e minojnë rendin botëror, kjo Qeveri ka vendosur të marrë një tremë triviale, siç është çështja e targave dhe ta kthejë në “mollë shërri” me SHBA-në dhe BE-në. Një qasje e tillë e Qeverisë sonë, në radhë të parë e minon rendin e Republikës së Kosovës si partner strategjik dhe si faktor i sigurisë në rajon.

Për ta hequr çdo dyshim deri më tani, më duhet të theksoj se vendimi për targat është absolutisht i drejtë, por momentum dhe mënyra se si këtë po e bën Qeveria jonë është absolutisht e gabuar. Aq e gabuar madje, sa edhe kësaj radhe Kosova po shihet nga Perëndimi si jokonstruktive e Serbia po amnistohet, falë politikave të kësaj Qeverie.

Pa fije dyshimi Qeveria është dashur të marrë për bazë kërkesën e SHBA-së për ta filluar zbatimin e këtij vendimi pas dhjetë muajsh. Nëse ato targa janë përdorur për plot 23 vjet, s’do të ishte fundi i botës edhe nëse përdoren edhe për dhjetë muaj e Kosova të dalë faqebardhë nga i gjithë ky proces. Kjo politikë, jo vetëm që na i dëmton raportet me aleatët tanë kryesorë, Shtetet e Bashkuara, por edhe bllokon procesin e dialogut, i cili po shihet se është kyç në rrugën e Kosovës drejt çfarëdo anëtarësimi në cilëndo organizatë ndërkombëtare, e madje po del të jetë kyç edhe në lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës në zonën Shengen.

Është e qartë që BE nuk dëshiron të importojë probleme të reja, andaj edhe normalizimin e marrëdhënieve e ka vendosur si top-prioritet. Përfaqësues të kësaj shumice parlamentare dalin çdo ditë e na flasin se si Kosova është shtet sovran dhe se si SHBA-ja duhet ta pranojë këtë fakt. Harrojnë se SHBA-ja është arsyeja kryesore e këtij sovraniteti, e ajo bashkë me KFOR-in janë garantues të sigurisë sonë.

Pra, për të mos arsyetuar këtë koordinim dhe për ta arsyetuar moskoordinimin me aleatët tanë, ata flasin për sovranitetin, ani pse janë të paaftë për të garantuar mbrojtjen e këtij sovraniteti në një situatë eventuale, kur forcat e KFOR-it edhe do të tërhiqeshin nga Kosova. Në këtë fazë kur arma e vetme është mbledhja e mbështetja nga partnerët tanë ndërkombëtarë, në krye të diplomacisë kemi dikë që s'ia ka haberin kësaj pune. Nëse vetëm pak do ta kuptonte rolin që mban, sigurisht që ne nuk do të vinim në këtë pikë si Republikë, ku sekretari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës haptazi në Twitter shfaq zhgënjimin me Kosovën. Në kohën kur as presidenti i SHBA-së e as ai i Polonisë, besa as NATO-ja, por edhe shtetet e tjera të fuqishme evropiane nuk thanë se sulmi në Poloni është bërë nga raketat ruse, ne kemi një ministër të Punëve të Jashtme e cila e konfirmon këtë.

Pra, të nderuar kolegë, pasojat e veprimeve të dëmshme të kësaj Qeverie ne do t'i bartim për shumë gjatë. Subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës është në rrezik edhe më të madh që nga çlirimi, pasi që një grusht të veshurish me pushtet e arrogancë kanë vendosur që të...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Doni edhe një pjesë të kohës për fjalën tuaj? Urdhëro!

**ARIANA MUSLIU-SHOSHI:** Kanë vendosur të bëjnë eksperimente që kanë kosto të madhe për vendin, e të cilat nuk gëzojnë mbështetje, as brenda dhe as jashtë vendit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Këtu në monitor nuk po më paraqiten deputetë të tjerë. Ju lutem, prekini edhe një herë aparaturat tuaja. Në radhë është deputetja Time Kadrijaj.

**TIME KADRIJAJ:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Këtë periudhë duke qenë të shqetësuar për situatën politike, që po mbretëron në vendin tonë dhe duke qenë në terr informativ, ndoshta i kemi lënë pas vetes plot çështje të tjera që janë shqetësim i qytetarëve të Kosovës.

Unë do ta ngre një shqetësim, vërtet është shqetësim, po që ministri i Punëve të Brendshme sot është këtu. Ka muaj që qytetarët e Kosovës nuk mund të pajisen me letërnjoftime, por nuk mund të pajisen as me patentë shoferë. Dhe, kjo nuk është thjesht një pasaportë dhe thjesht nuk është

një patentë shoferë, sepse qytetarët e Kosovës gjatë qarkullimit me veturat e tyre, nëse ndalen nga policia e Kosovës do të gjobiten, sepse kanë një patentë shoferi me afat të skaduar.

Andaj, ministri menjëherë duhet të japë një urdhër që qytetarët të mos gjobiten për shkak se kanë patentë shoferë me afat të skaduar, sepse nuk është faji i tyre. Është faji i institucioneve, që me muaj të tërë po i lë qytetarët pa patentëshoferë dhe pa letërnjoftime. Kjo duhet të zgjidhet menjëherë. Tash nuk është çështje e një patentëshoferi, nuk është çështje e një pasaporte. Por shumë qytetarë të cilët nuk po mundën të vazhdojnë afatin e pasaportave, janë studentë të cilët kanë fituar bursa dhe që duhet me afat të caktuar të shkojnë në ambasada, të pajisen me vizë dhe më pas të udhëtojnë në vendet ku kanë fituar bursa dhe kjo u është pamundësuar nga kjo Qeveri. Të mos flasim për persona të cilët kanë viza pune duke e ditur që terminet në ambasada janë të ngarkuara, ata prapë duhet t'i humbin terminet të cilat i kanë marrë nëpër ambasada, sepse nuk kanë pasaporta. Kjo është një padrejtësi që po u bëhet qytetarëve.

Së fundi, meqenëse Kryeministri është këtu, ndoshta Kryeministri sot këtu nuk do të na lë në terr informativ se çfarë po ndodh në Bruksel. U munduam gjatë vizitës së fundit të zëvendëskryeministrit të kuptojmë përmes ndonjë statusi të tij me ditë se çfarë po ndodh në Bruksel. Është e padrejtë që deputetët të mos kenë informata se çfarë po ndodh dhe meqë jeni sot këtu prezent është mirë të na tregoni çfarë po ndodh dhe çfarë po dialogohet në Bruksel dhe cili do të jetë fati për targat. Qytetarët me shqetësim po i presin datat e caktuara. Po presin datën 21 nëntor dhe po presin cili do të jetë rezultati i këtij dialogu që po ndodh në Bruksel për çështjen e targave. Besoj se nuk do të hezitoni, sepse duhet të jeni transparent ndaj deputetëve dhe qytetarëve të Kosovës, të cilët vërtet janë të shqetësuar dhe janë në terr informativ për këto ngjarje. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe pse ditëve të fundit tema kryesore është situata e krijuar në veri, unë sot do të flas për një çështje tjetër. Për mendimin tim po aq shqetësuese që është largimi masiv i shqiptarëve nga Kosova, veçanërisht i të rinjve. Arsyeja pse po flas për këtë temë, edhe pse situata politike është e destabilizuar, është se pikërisht temat e mëdha në këtë vend e kanë vënë nën hije qytetarin dhe përditshmërinë e vështirësitë e tij. Këtë e kam thënë me dhjetëra herë dhe vazhdoj ta mbroj qëndrimin tim se krahas temave të ashtuquajtura të mëdha të politikës, po harrohet se mirëqenia e qytetarit është tema më e madhe që duhet të trajtohet nga politikanët dje, sot, nesër dhe përgjithmonë.

Neglizhenca për të trajtuar shqetësime e përditshme dhe të vërteta të qytetarëve tanë, ka ndikuar që sot të kemi ikje masive nga Kosova dhe përtej kësaj çdo i dyti person me të cilin trajtojmë këtë fenomen shprehet se me mundësinë e parë do të ik nga këtu.

Si deputete kam marr shumë shkresa nga të rinjtë që po e lëshojnë Kosovën, përmes të cilave ata më shprehin dhimbjen e tyre dhe më bëjnë të ditur se nuk po e marrin me dëshirë këtë hap. Ndjehem keq që këta të rinj nuk kanë platformën e duhur për t'u angazhuar në shtyrjen përpara të ideve të tyre këtu, në vendlindjen e tyre, prandaj po e shfrytëzoj platformën time për t'u dhënë atyre simbolikisht hapësirën time që t'u dëgjohet zëri sot. Shpresoj që kjo thirrje të gjej përkrahje dhe të fillohet të punohet për ta zbutur sadopak këtë eksod të shqiptarëve.

Letra e fundit që kam marrë është ajo e një të riu me emrin Behar nga Malisheva e Kosovës, që ka përfunduar studimet në juridik me 21 vjet. Ka përfunduar shumë trajnime dhe është angazhuar në tryeza të ndryshme me tema nga fusha e drejtësisë. Behari ndër të tjera shkruan, pas shumë aplikimeve, zhgënjimeve dhe vështirësive u detyrova ta kap valixhen dhe të marrë rrugën e kurbetit. Ishte dhimbje e madhe largimi nga shtëpia, lagjja e vendlindja. Ishte një mërzi e madhe largimi nga familja, miqtë dhe shokët. Ne po largohemi me zemër të thyer, me pak shpresë për t'u kthyer një ditë.

Për fund, shkruan Behari, e kam një lutje për institucionet e vendit tim, qofshin ato lokale apo qendrore, që të punojnë sa më shumë që rinia jonë të mos jetë e detyruar të largohet, krijoni perspektivë dhe mundësi. Punësimi në Kosovën tonë të dashur. Tani ne jemi duket u qeverisur nga një qeveri që erdhi në pushtet me propagandë, një propagandë që një gjeneratë e tërë ua mbolli në tru se në këtë vend nuk jetohej, përderisa ky vend nuk qeveriset nga Albin Kurti. Populli i besoi rrenave të tij, e bëri kryeministër.

Situata e vështirë ekonomike dhe politike është një arsye për ikje, por jo kryesorja. Arsyeja kryesore është zhgënjimi me ata që u shesin ëndrrat e tyre për një grusht vota...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia zgjatni deputetes fjalën.

**GANIMETE MUSLIU:** Është zhgënjimi me degjenerimin e politikëbërjes në këtë vend, është zhgënjim nga vrasja e shpresës së tyre nga ata që me shpresën e tyre erdhën në pushtet, është zhgënjim nga mungesa e reformave dhe nëpërkëmbja e meritokracisë, është frika nga e ardhmja e fëmijëve të tyre nesër. Në këtë kontekst, Albin Kurti sot, çdo kryeministër nesër e ka obligim të kujdeset që rinia e këtij vendi të angazhohet për të ardhmen e tyre këtu, çdo Qeveri duhet ta ketë top-prioritet zhvillimin e vendit dhe krijimin e perspektivës për të jetuar me dinjitet. Politika nuk është fushë ku vetëm flitet. Politika është fushë ku edhe duhet të bëhet, të krijohet e të zhvillohet.

Sot ua përkushtova fjalën time të gjithë atyre zëri i të cilëve nuk dëgjohet, por ka ardhur koha që secili qytetar i këtij vendi të ngrihet dhe të flas për veten dhe për të ardhmen, të ngrihen dhe të kërkojnë llogari nga secili pushtetmbajtës, të ngrihet dhe t'ua kujtoj pushtetmbajtësve se nuk janë sundues të tyre, por janë në shërbim të tyre. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Sërish nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur. Kalojmë te pjesa e Qeverisë nëse dëshiron dikush ta marrë fjalën. Nëse jo, kalojmë te pika tjetër:

## **2. Pyetjet parlamentare**

Kemi pyetjet parlamentare. Fillimisht janë ato të cilat nuk kemi mundur t'i përfundojmë në seancën e kaluar. Fillojmë nga ato. Deputetja Ariana Musliu-Shoshi ia ka drejtuar një pyetje zv.kryeministres, Donika Gërvalla-Schwarz.

**ARIANA MUSLIU-SHOSHI:** Nuk do të vazhdoj me pyetjen, me shpresën që do të vij në Kuvend.

**KRYETARI:** Mirë. deputeti Bekim Haxhiu ia ka drejtuar një pyetje ministrit të Kulturës, por as atë Nuk e kemi këtu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, kryetar!

Sinqerisht është e papërgjegjshme që tani kjo seanca e tretë ose e katërt që ministri i Kulturës, Rinisë e Sportit nuk vjen të përgjigjet në një pyetje që ka të bëjë me investimet kapitale.

Jemi në fund të vitit dhe sigurisht që sportdashësit do të donin ta dinin se çka po ndodh me investimet kapitale, në veçanti kur sot është edhe buxheti i planifikuar dhe prapë këto investime kapitale prolongohen dhe qasja e ministrit dhe e një pjese të kabinetit qeveritar që të mos përgjigjen në pyetjet e deputetëve ishte edhe një nga vërejtjet e raportit të progresit.

Pasi kryeministri është këtu, sa ka qenë opozitar ka insistuar shumë që ministrat t'u përgjigjen deputetëve. Le t'ua ngre pak veshin ministrave të tij që të përgjigjen para deputetëve dhe në pyetjet parlamentare, sepse ka marrë përgjegjësi të qeverisë dhe duhet të përgjigjen. Parlamenti është monitorues i punës së Qeverisë dhe do të duhej të paktën atë që e ka kërkuar kur ka qenë opozitar, tash si kryeministër ta zbatojë.

**KRYETARI:** Tash Avdullah Hoti i cili nuk ndodhet këtu, me sa e di është në një udhëtim, ka një pyetje për kryeministrin Albin Kurti. Nuk e kemi deputetin këtu.

Deputetja Mirlinda Sadiku po ashtu e ka një pyetje për ministrin e Kulturës, të cilin thashë që nuk e kemi këtu. Mundet edhe me shkrim t'u përgjigjet ministri po ashtu.

Deputetja Ganimete Musliu ka pyetje për ministrin e Bujqësisë, Faton Peci. Urdhëro, e nderuar deputete.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Pyetja që kam parashtruar në disa seanca po që e kam pasur të pamundur që ta adresoj, është që në tërë botën veç Kosovës, profesioni i veterinarisë është i rregulluar me ligj të veçantë. Në Kosovë ordinancat e tyre licencohen nga AUV, por ata vetë janë të palicencuar në mungesë të ligjit për Odën e Veterinarisë së Kosovës, e cila do të duhej të licenconte të gjithë veterinarët. Oda e Veterinarëve të Kosovës është organizatë e pavarur dhe profesionale, e cila mbron, përfaqëson dhe promovon interesat e veterinarëve. Duke pasur parasysh se ata janë direk të lidhur me mbrojtjen e shëndetit publik, duke kontrolluar çdo gjë që hamë dhe përmes parandalimit të sëmundjeve që barten nga kafshët te njeriu, më intereson të di, zotëri ministër, se a mund të na thoni kur do ta sillni në Kuvend Ligjin për Odën e Veterinarëve të Kosovës?

KRYETARI: Fjala është e juaja, ministër!

MINISTRI FATON PEÇI: Faleminderit, kryetar!

E nderuar deputete,

Ju thatë që disa herë e keni ngritur këtë çështje. Unë për herë të parë kam marrë pyetje nga ana juaj më 19. 10. 2022. Sikur jeni në dijeni, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës ka diku dy muaj që është pjesë e përgjegjësisë së Ministrisë së Bujqësisë. Ne aktualisht jemi në proces të dëgjimeve publike për koncept-dokumentin për veterininë.

Në momentin e përfundimit të koncept dokumentit, në kuadër të planit legjislativ për vitin e ardhshëm, do ta trajtojmë edhe çështjen e Odës së Veterinës.

KRYETARI: E nderuar deputete Musliu, a keni pyetje tjetër shtesë?

GANIMETE MUSLIU: Ndoshta më shumë sqarim. E thatë edhe vetë pyetjen parlamentare e kam bërë më 19. 10. 2022 dhe kjo pyetje ka ardhur dy herë, hera e tretë është sot. Prandaj thashë disa herë, por s'kam pasur mundësi që ta adresoj, kështu që unë e mora përgjigjen. Shpresoj dhe uroj që ky premtim që sapo u dha sot apo kjo deklaratë që sapo u dha sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbahet, sepse edhe më herët është thënë që për vitin 2023 do të jetë në agjendë legjislative, por unë do t'ju mbaj për fjale zoti ministër që në 2024 ta kemi këtë projektligj në Kuvendin e Kosovës.

KRYETARI: Tash dy pyetje i ka Ariana Musliu-Shoshi. Të parën e ka për kryeministrin Kurti.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, kryetar!

Pyetjet e mia janë nga muaji tetor, por do t'i lexoj për kryeministrin.

I nderuar kryeministër,

Kur do të raportosh në Kuvend lidhur me procesin e dialogut Kosovë - Serbi? Çka do të ndodhë pas dt. 21 nëntor, pra pas të hënës, përveç se do të vijë e marta, çka do të kemi nga kjo Qeveri lidhur me vendimin e targave? Kur do të raportoni lidhur me planin franko-gjerman? Cili është qëndrimi i kësaj Qeverie lidhur me Asociacionin e komunave me shumicë serbe apo Zajednicës siç e keni quajtur në vazhdimësi?

KRYETARI: Fjalën e ka kryeministri Kurti.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Faleminderit kryetar i Kuvendit, Konjufca!

Faleminderit deputetja Ariana Musliu-Shoshi,

Unë këtë pyetje e kam pranuar nga ju dhe jam përgjigjur me shkrim. Arsyeja ka qenë sepse atë ditë kur mbahej seanca e Kuvendit ndodhej për vizitë Presidentja e Komisionit Evropian, znj. Ursula Von der-Leyen, andaj u përgjigja me shkrim, po tash unë përgjigje tjetër nuk kam, po mund ta them edhe publikisht atë çfarë ju kam shkruar.

Për bindjen time të fuqishme, dialogu Kosovë - Serbi nuk ka qenë asnjëherë më transparent që prej rifillimit të tij ne jemi treguar transparent ndaj qytetarëve dhe publikut. Kemi treguar gatishmëri për komunikim korrekt me partitë opozitare, por edhe kemi treguar kujdes e maturi ndaj vetë procesit të dialogut, duke mos e dëmtuar atë e as interesat tona. Takimet në nivel të lartë politik, por edhe ato në nivel të zëvendëskryeministrit Bislimi kanë qenë publike. Pas çdo takimi të nivelit të lartë politik, publiku është informuar për qëndrimet dhe propozimet tona. Gjithçka ka filluar më 15 qershor të vitit të kaluar kur kemi bërë publike katër propozimet tona në atë takim, të cilat ishin si në vijim:

E para, që gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor ta avancojnë CEFTA në SEFTA sipas modelit të EFTA-EA.

E dyta, Kosova dhe Serbia menjëherë të nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët të paqes, duke u zotuar se nuk do ta sulmojnë njëra-tjetrën.

E treta, pas njohjes së ndërsjellë, Kosova dhe Serbia të kenë reciprocitet bilateral, përfshirë çështjen e pakicave kombëtare.

E katërta, Velko Odaloviq të largohet nga pozita e drejtuesit të delegacionit serb për çështjen e të pagjeturve, të zhdukurve me dhunë për shkak të kaluarës së tij.

Njësoj kemi vepruar edhe pas takimit të 19 korrikut, duke i bërë publike dokumentet tona të prezantuara në atë takim, deklaratën e paqes me gjashtë nene që përfshijnë zotimin për



mossulmim dhe reciprocitet të të drejtave dhe përmbledhjen me njëmbëdhjetë shkelje që Serbia i bën ndaj Kosovës nëpër barriera kundër tregtisë së lirë.

Ndërsa disa ditë pas takimit të 18 gushtit, në mbledhjen e 94-të, kanë dhënë një elaborim të gjatë të atij takimi dhe kanë prezantuar pikë për pikë propozimin tonë të gjashtë kapitujve për elementet e kornizës së marrëveshjes ligjrisht të obligueshme me njohjen reciproke në qendër.

Zëvendëskryeministri Bislimi u është përgjigjur ftesave të komisionit parlamentar të linjës, me përjashtim të rasteve kur ka qenë jashtë vendit apo kur këtë ia ka pamundësuar agjenda e tij. Ndërkaq, me liderët e opozitës, i kam ftuar, jam takuar, kemi diskutuar për procesin e dialogut dhe hapat përpara, e të cilët janë bërë edhe publike.

Sa i përket qëndrimin tonë lidhur me marrëveshjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe apo të Zajednicës, ky është i njohur edhe i qartë. Në një çështje për të cilën jam përgjigju për numër herë, nuk kam përgjigje të re, sepse pyetja është e vjetër.

Marrëveshja për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe natyrisht që nuk e ka kaluar testin e Gjykatës Kushtetuese, e cila praktikisht e ka shpallur atë jokushtetuese.

**KRYETARI:** Zonja Musliu-Shoshi, a keni pyetje shtesë për kryeministrin?

**ARIANA MUSLIU-SHOSHI:** Po, zoti kryetar!

Kryeministri nuk u përgjigj në të gjitha pyetjet që i kisha unë. Pra, unë dëshiroj të di nga ai se kur do ta shpallësh planin franko-gjerman apo të ndajë me ne aq informatë sa ka lidhur me këtë.

Zoti kryeministër, nuk e di se çfarë po kupton me transparencë. As ky Kuvend dhe as Komisioni për Punë të Jashtme, i cili ka detyrë kryesore mbikëqyrjen e dialogut nuk e kemi as edhe një faqe shpjegim nga ana e Qeverisë lidhur me procesin se ku jemi. Nuk e kemi as platformën për dialog.

Ju e dini që kjo është përgjegjësi komplet juaja, dhe rezultatet e këtyre negociatave janë meritë juaja, mirëpo transparenca është zero. Ju e dini sa keni qenë shef i opozitës keni bërë një rezolutë në këtë Kuvend, ku keni kërkuar nga kryeministra para jush që të vijnë në Kuvend dhe të raportojnë para dhe pas çdo udhëtimi në Bruksel. Tani që mveshur me pushtet, mendoj që duhet ta respektoni rezolutën të cilën e keni marrë vetë në Kuvend, e keni sjellë vetë në këtë Kuvend, dhe po deputetët që kanë qenë në këtë sallë e kanë aprovuar.

**KRYETARI:** Një përgjigje, po ashtu të shkurtër nga kryeministri, pastaj deputetja ka të drejtë ta përmbyllë diskutimin siç dihet.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Nuk mendoj që është e drejtë të thuhet që transparenca është zero. Ju pyesni, unë përgjigje. Gjithashtu, edhe në komisionin parlamentar, ministrat, zëvendëskryeministri vijnë.

Dhe, unë i kam pasur në takim të tre liderët e tri partive opozitare, ku kemi diskutuar edhe për atë përmbledhje të propozimeve, ideve, opsioneve që mënyrë të popullarizuar njihet si propozim franko-gjerman. Gjithashtu, edhe çdoherë kur keni thirrur seancë të jashtëzakonshme...

KRYETARI: Ju lutem të mos i ndërhyri në fjalë kryeministrit!

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Unë kam ardhur dhe kam marrë pjesë në diskutim. Në njërin anë i përmbahem transparencës së procesit, por në anën tjetër edhe konfidencialitetit të bisedimeve. Nëse ju e konsideroni të nevojshme që përtej asaj çfarë ju kanë njoftuar liderët e partive tuaja, ose nëse e konsideroni që nuk ju kanë njoftuar, atëherë natyrisht që mund të organizojmë edhe seancë të Kuvendit edhe të hapur, edhe me dyer të mbyllura, si të doni. Por, nuk mund të thoni se transparenca është zero.

Besoj që qëndrimi ynë ka qenë i drejtë dhe në këtë kuptim jemi treguar të përkushtuar, kreativ, konstruktiv dhe mbase ridiskutojeni edhe njëherë me kryetarët e subjekteve tuaja politike që ta kuptoni që asnjëherë nuk ka pasur më shumë transparenca sesa kësaj radhe.

KRYETARI: Zonja Musliu-Shoshi, e keni dhe një pjesë përfundimtare të kohës nëse dëshironi t'i jepni fund këtij diskutimi.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, kryeministër!

Po pajtohem, transparenca është 0,1%, pasi që sot veç kishim një fjalë tuajën lidhur me këtë proces. Ju jeni i detyruar që të raportoni para këtij Kuvendi, para deputetëve dhe jo para kryetarëve të partive, sepse unë nuk e kam për obligim apo deputetët e tjerë që të marrim informata nga kryetarët e partive, mirëpo nga ju, sepse ju jeni ai i cili jeni i ngarkuar që ta udhëhiqni procesin e negociatave me Serbinë dhe dialogun.

Deri më tani pak a shumë jeni arsyetuar në mungesë të përvojës, mirëpo tani çdo veprim do të shihet si i qëllimshëm. Çdo dështim është me qëllim drejt së ardhmes së këtij vendi. Çdo dështim është i qëllimshëm i reputacionit të Kosovës, dhe çdo rrezik që për prishje të marrëdhënieve që i kemi me shtetet tona aleate, SHBA-të dhe Bashkimin Evropian, do të merret si i qëllimshëm nga ana juaj.

Përderisa nuk kemi transparenca në asnjë proces të cilin kalon kjo Qeveri sa u përket marrëdhënieve me Serbinë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Zonja deputete, e keni edhe një pyetje për ministrin Sveçla, por ministri nuk ndodhet këtu.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, kryetar!

Pyetjen do ta bart për në seancën e radhës.

KRYETARI: Këto besoj që nuk barten në seancën e radhës. Mund t'iu jap, po ashtu ministri përgjigje me shkrim nëse ka mundësi, apo erdhi ministri. Ministër, a po do të përgjigjesh apo keni nevojë që të përgatiteni pak? E ka një pyetje deputetja për juve. Së shpejti besoj që ministri i përgjigjet kësaj pyetjeje.

Deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi e ka një pyetje për ministrin e Kulturës, i cili nuk është këtu. Mirë, kur të vjen ministri.

Deputetja Adelina Grainca e ka pyetjen për ministren Rozeta Hajdari. Ministren, po ashtu nuk e kemi këtu. Herën tjetër. Deputeti Milazim Salijaj ka pyetje për ministrin Liburn Aliu, i cili po ashtu nuk është këtu. Herën tjetër. Deputeti i njëjtë e ka, po ashtu pyetjen për ministren Arsimit, Arbërie Nagavci. Ministren e kemi këtu. Urdhëro, deputet! Mund t'ia bësh pyetjen ministres.

MILAZIM SALIJAJ: Faleminderit, i nderur kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja ka të bëjë me objektin e stërvjetruar të shkollës fillore “Emin Duraku” në Kaçanik.

E nderuar ministre,

Shkolla fillore “Emin Duraku” në Kaçanik është një objekt shkollor mjaft i vjetër i ndërtuar gjatë viteve 1950-1952, dhe një aneks i kësaj shkolle i ndërtuar 10 vjet më vonë, përkatësisht gjatë viteve 1960-1962. Tani ky objekt shkollor nuk i plotëson kushtet as për së afërmi për mbarëvajtjen e procesit mësimor, duke e pasur parasysht edhe numrin e nxënësve, diku rreth 902 nxënës të përfshirë në 36 paralele dhe dy ndërrime.

Duke e parë që objekti ekzistues është mjaft i vjetruar dhe i amortizuar, e me qëllim të krijimit të kushteve optimale për mbarëvajtjen e mësimin, ndërtimi i një objekti të ir shkollor do të ishte zgjidhje më e mirë për 902 nxënës të kësaj shkolle.

Ky objekt shkollor do të mund të ndërtohej në lokacionet e tanishme të shkollës fillore “Emin Duraku”, përkatësisht në pjesën e parcelës kadastrale nr. 665-0, zona kadastrale Kaçanik, me sipërfaqe prej 6 mijë metrave katrorë pronë e Komunës së Kaçanikut.

Andaj, duke u nisur nga kjo që u elaborua, pyetja për juve e nderuar ministre, është: A do të planifikoni apo ndoshta veç keni planifikuar në Buxhetin e vitit 2023, ndërtimin e objektit të shkollës fillore të mesme të ulët “Emin Duraku” në Kaçanik. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministrja Nagavci e ka fjalën.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar deputet, Salijaj. Faleminderit për pyetjen!

Ne e kemi pranuar kërkesën për ndërtimin e shkollës “Emin Duraku” në Kaçanik dhe ajo është prioritetuar nga komisioni i Ministrisë së Arsimit qysh në vitin 2020.

Kryesisht planifikimet afatmesme nga Ministria e Arsimit për projektet e reja zakonisht bëhen 3 vjet përpara. Megjithatë, për objektet ekzistuese sikurse edhe në rastin e shkollës “Emin Duraku” në Kaçanik, është e nevojshme që të kemi një ekspertizë në lidhje me gjendjen e shkollës, gjendjen teknike dhe qëndrueshmërinë e objektit të shkollës, stabilitetin e objektit, dhe arsyeshmërinë se a duhet të ndërtohen një objekt i ri apo të rinovohet objekti ekzistues, të cilin e kemi trajtuar edhe me Komunën e Kaçanikut.

Në raste të tilla kur bëhet fjalë për një objekt, sikurse shkolla “Emin Duraku”, një objekt prej 2 575 metra katrorë së bashku me bodrumin dhe tri katet, ka një kosto të konsiderueshme, andaj është e domosdoshme që përpara marrjes së vendimit për investim, të bëhet një arsyeshmëri për nevojën e ndërtimit të objektit të ri apo renovimit të objektit ekzistues.

Pra, nga komisioni i MASHTI-it është ranguar si prioritet, por ne presim që të jepet arsyeshmëria nga Komuna e Kaçanikut, ose nga ekspertët që mund t’i angazhojnë në këtë drejtim, dhe pastaj të vendoset për llojin e investimit që duhet të bëhet. Pra, duhet të jetë një ndërtim i ri apo renovim në këtë drejtim, kërkesë kjo që do të trajtohet në buxhetet e viteve vijuese.

Po ashtu, për informatën tuaj, MASHTI-i në vitin 2020 ka funksionalizuar objektin e ri të shkollës në Kaçanik të Vjetër, një objekt të ri shkollor në qytetin e Kaçanikut dhe është në ndërtimin shkolla në Doganaj të Kaçanikut.

Përveç kësaj, janë rinovuar dhe ndërtuar anekse në shkollat “Vëllezërit Çako”, “Feriz Guri” dhe “Skënderbeu”, e në Kaçanik sipas prioriteteve dhe kërkesave që kemi pasur nga Komuna e Kaçanikut janë trajtuar të gjitha këto. Pra, jemi në proces të trajtimit të kërkesave dhe krijimit të mundësive sa më të mira për zhvillimin e mësimin për fëmijët e Komunës së Kaçanikut. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Salijaj, a keni pyetje tjetër apo mjaftoi kjo përgjigje? Mirë! Tash janë tri pyetje për ministrin Sveçla. Zonja Ariana Musliu-Shoshi ia bën pyetjen e parë ministrit Sveçla.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Përpos problemeve të shumta me të cilat po përballen qytetarët tanë, s'po ju mundësohet pajisja me dokumente.

Shumë qytetarë janë ankuar së fundmi se nuk po arrin të pajisen me dokumente valide të Kosovës, siç është letërnjoftimi, pasaporta e patentë shoferi. Situata është edhe më e rëndë te kategoritë e qytetarëve të cilët kanë nevojë urgjente për pajisje me dokumente.

Vlen të theksohet se përgjatë gjithë këtij viti, qytetarët kanë hasur në probleme të tilla pothuajse çdo dy muaj. Zoti ministër, kur do të bëhet furnizimi me materialet bazë në mënyrë që qytetarët tanë të pajisen me letërnjoftime, me pasaporta me patentë shoferë?

KRYETARI: Ia japim fjalën ministrit për t'u përgjigjur në këtë pyetje.

MINISTRI XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, e nderuar deputete!

Situata e krijuar nga lufta Rusi-Ukrainë dhe sanksionet që pasuan pastaj, kanë ekspozuar dobësitë e sigurisë në furnizimin me lëndë të para kritike për prodhimin industrial, duke afektuar rëndë tregjet globale.

Çrregullimi i zinxhirit të furnizimit me lëndë të parë ka implikuar ekonomitë botërore, duke shkaktuar shqetësim masiv global tek të gjitha kompanitë ndërkombëtare, të cilat po dështojnë në përmbushjen e kërkesave për një gamë të gjerë të mallrave.

Kjo situatë e krijuar si forcë madhore ka atakuar edhe prodhuesit e materialit për dokumente personale. Problemi i mungesës së materialit dhe dokumenteve është paraqitur në fillim të muajit gusht të këtij viti, dhe nuk është e vërtetë që përgjatë gjithë këtij viti kemi pasur probleme.

Në mesin e gushtit të këtij viti, Ministria e Punëve të Brendshme ka lëshuar urdhër--blerje edhe për sasinë shtesë të 30% mbi totalin e kontraktuar që sipas kushteve kontraktuale liferimi është 40 ditë kalendarike, mirëpo për shkak të mungesës së lëndës së parë për material të dokumenteve duke u thirrur në forcë madhore, furnitori ka kërkuar afat shtesë të liferimit. Pra, aktualisht Ministria e Punëve të Brendshme është në pritje për furnizim me dokumente personale, ku fillimisht në fund të këtij muaji do të furnizohemi me patentë shoferë dhe letërnjoftime dhe pas dy muajve edhe me pasaporta, gjithsej 73 mijë copë. Faeleminderit!

KYRETARI: Kjo ishte përgjigjja. Zonja deputete, a keni pyetje shtesë? Bëjeni pyetjen shtesë.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Zoti ministër, është shumë e çuditshme qysh lufta në Ukrainë nuk e ka shfaqur këtë problem në Maqedoni apo në Shqipëri, por vetëm në Kosovë. Është e vërtetë

apo nuk është e vërtetë që ky problem çdo dy muaj është shfaqur në ministrinë që udhëhoqi ju, ju lutem, kërkon raport nga departamenti adekuat apo edhe shfrytëzoni mediat, të cilat kanë shfaqur këtë problem bash çdo dy muaj që nga dita kur jeni në krye të kësaj Qeverie.

Nuk e di a është problem sigurimi i furnizimit të lëndës së parë, apo është problem tenderomania në ministrinë tënde, të lutem, më shpjego!

KRYETARI: Përgjigjja e dytë e ministrit.

MINISTRI XHELAL SVEÇLA: Sa për tenderomani, mendoj që subjekti juaj më së miri mund të na e shpjegojë këtë. Sa i takon tenderomanisë, ju jeni ekspertët. Tash unë po ju them qartazi, brenda kontratës ekzistuese ne kemi bërë porositë e nevojshme, furnitori është arsyetuar me forcë madhore, e cila parashihet edhe në kontrata. Në momentin e parë që dokumentet na vijnë, ne i procedojmë tutje.

Për sa i takon raportit që thatë, unë do të kërkoj raport nga Agjencia e Regjistrimit Civil dhe me atë raport do t'ju njoftoj në ndërkohë.

KRYETARI: Deputete, e ke fjalën.

ARJANA MUSLIU-SHOSHI: Zoti ministër, llogari për tenderomani kërkoj nga dita kur ju jeni ministër, secili jep llogari për punën që e bën dhe për keqpërdorimet që i bën sa është vetë në detyrë.

KRYETARI: Deputeti Elmi Reçica po ashtu e ka një pyetje për ministrin Sveçla, urdhëroni, zoti Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Ju e dini që unë e kam bërë pyetjen prej 28 tetorit dhe në seancën e kaluar e kam parashtruar pyetjen, s'ka qenë ministri këtu, po megjithatë për shkak të seriozitetit të çështjes dhe për shkak të komplikimeve, realisht, po edhe për shkak që ministri më shumë po merret me çështje të tjera se sa të përgjigjet në këtë pyetje, do ta parashtroj pyetjen. Sigurisht e ka të njëjtën përgjigje, mirëpo unë do ta parashtroj edhe një herë pyetjen, përkundër pakënaqësisë me përgjigjen në raport me pyetjen e koleges time paraprake dhe duke pasur parasysh që edhe zonja Kadrijaj e ngriti në fillim të seancës këtë çështje.

Thotë prodhimi i pasaportave të Republikës së Kosovës dhe tash ndërkohë është shkaktuar edhe...

KRYETARI: Ju lutem, ta mbani qetësinë sepse ministri nuk po mund ta dëgjojë pyetjen e deputetit.

ELMI REÇICA: Pyetja:

Pse Ministria e Punëve të Brendshme është duke prodhuar sasi të limituar të pasaportave për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe mërgatën tonë?

Zoti ministër,

Nga informacionet që kam, por duke pasur parasysh ankesa të shumta të mërgimtarëve tanë si dhe të qytetarëve që jetojnë në Republikën e Kosovës, ministria që ju drejtoni është duke prodhuar sasi të limituar të pasaportave, gjë që cenon përveç të drejtën e qytetarëve për t'u pajisur me dokumente të udhëtimit, në të njëjtën kohë atyre u shkakton probleme elementare dhe serioze studentët, artistët, sportistët po edhe komuniteti i biznesit në mungesë të dokumenteve të udhëtimit nuk mund të realizojnë qëllimet, ambicie dhe interesat e tyre.

Në veçanti kjo situatë prek mërgimtarët tanë, të cilët për shkak të mungesës së pasaportave nuk po mund të pajisen me leje qëndrimi dhe për pasojë mund të humbin vendet e tyre të punës. Nuk mund të planifikojnë udhëtimet e tyre për në vendlindje e për pasojë nuk mund t'i kalojnë festat e fundvitit në vendlindjen e tyre. Vonesat për të marrë një pasaportë në procedurë të rregullt shkojnë deri në dy muaj, njëkohësisht vonesat janë paraqitur edhe te prodhimi i patentë shoferëve.

Qytetarët e Kosovës dhe mërgata jonë paguajnë për t'i marrë këto dokumente nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe do të duhej të ishte e përgjegjshme karshi përgjegjësive që i ka.

Prandaj, zoti ministër

A mund të më thoni çka janë duke ndodhur këto vonesë dhe çfarë jeni duke bërë për t'i evituar të njëjtat.

KRYETARI: Po për afërsisht e njëjta pyetje, të cilën e bërë zonja Shoshi, fjalën ia japim ministrit.

MINISTRI XHELAL SVEÇLA: Faleminderit!

Është pak a shumë e njëjta pyetje, unë po e plotësoj përgjigjen edhe pak.

Çfarë ka bërë Agjencia e Regjistrimit Civil është që duke pasur parasysh numrin e limituar të dokumenteve që i kemi në dispozicion kanë prioritetizuar lëshimin e këtyre dokumenteve për kategoritë me urgjencë, që do të thotë rastet e sëmundjeve, rastet e bashkimit familjar, rastet e aktiviteteve sportive, diplomacia, këto kategori kanë prioritet. Kurse për qytetarët e tjerë, më vjen keq, por duhet t'u përshtatemi rrethanave në të cilat po jetojmë dhe unë jam duke punuar jashtëzakonisht shumë edhe me kompaninë që ajo sa më parë të furnizojë vetveten së pari me

lëndën e parë dhe pastaj të prodhojë dokumentacionin e nevojshme që ta sjellë në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Reçica!

ELMI REÇICA: Zoti ministër,

Përafërsisht ishte përgjigja e njëjtë, e ngjashme, mirëpo kjo mund të jetë një përgjigje për ne këtu, po nuk është përgjigje për qytetarët që presin dhe tash kolegja Musliu po më thotë që edhe për raste urgjente realisht nuk jeni duke dhënë, duke prodhuar pasaporta. Duke pasur parasysh që kontratën ju e keni nënshkruar, ka qenë kontratë njëburimore, e keni përzgjedh operatorin, e keni nënshkruar kontratën më 7 shtator 2021 dhe ju sigurish keni pasur parasysh edhe në rast se ndodh lufta ose ndodhin trazira, si e keni paraparë si ministër i Brendshëm, ndodh edhe Veriu i Kosovës, mund të ndodhin edhe në të ardhmen probleme dhe telashe të tilla. Ka qenë dashur në kontratë të merreni vesh që të prodhohen sasinë çfarë ju e keni pasur kontratën. Ju e keni pasur kontratën të prodhohen 360 mijë copë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Po, e keni pastaj edhe një pjesë të fjalës tuaj. Urdhëro, ministër!

MINISTRI XHELAL SVEÇLA: Tashmë u përgjigja që ka një listë të profesioneve edhe arsyeve prioritare për t'u furnizuar me pasaporta, atë është duke menaxhuar Agjencia për Regjistrimin Civil. Po, pa tjetër, nuk kam kurrfarë telashe që të bëhet publike kushdo që merr pasaportë edhe arsyen pse. Do të thotë ekziston një numër i limituar i rasteve ku marrin pasaportë për të udhëtuar, këtu janë emergjencat. Ekziston kontrata, e cila është ende valide, me kohë janë bërë porositë, por siç thashë është arsyeja madhore që furnitori nuk ka mundur t'i plotësojë obligimet e tij.

KRYETARI: Zoti Reçica, fjala përfundimtare është juaja.

ELMI REÇICA: Zoti ministër,

Unë po e kuptoj që në asnjë çështje, as në çështjen e dokumenteve nuk jeni duke vepruar dhe duke i kryer obligimet tuaja si ministër. Mua po më zhgënjën përgjigja juaj para qytetarëve këtu. Ju jeni ata që keni kritikuar ministrin paraprak për kontratën njëburimore për dokumente. Ndërsa tash keni nënshkruar të njëjtën kontratë dhe nuk e keni paraparë që mund të kemi situata të jashtëzakonshme, kjo është obligim dhe detyrë e juaja.

Ministër, nuk shkojnë dushku për gogla, ta kesh parasysh, të jesh i përgjegjshëm, e di që i ke 100 probleme të tjera, e di që je duke u marrë edhe me çështje që s'janë tuat, por megjithatë merru me prodhimin e dokumenteve, kjo është esenciale, sepse je duke shkaktuar pakënaqësi.



Nuk është problemi që unë po dua të të mbroj ty, po dua ta mbroj institucionin që t'i e drejton...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Deputetja Ganimete Musliu ka pyetje për ministrin Sveçla, pyetja e fundit dhe pastaj kalojmë te pika e radhës që është shqyrtimi i buxhetit.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Policia e Kosovës po udhëhiqet me ushtrues detyre të drejtorit më tepër se tre muaj që nga data 30 gusht 2022.

I nderuar ministër,

Pse nuk po e emëron drejtorin e Policisë?

KRYETARI: Urdhëro, ministër, për t'u përgjigjur, fjala e juaj!

MINISTRI XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, e nderuar deputete!

Ndonëse një ushtrues detyra nuk konsideroj që ka mungesë apo ngecje brenda Policisë së Kosovës, përkundrazi gjithë zyrtarët policorë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës janë në nivel të lartë të detyrës, me përkushtim e disiplinë duke zbatuar misionin e tyre.

Pozita e drejtorit të Policisë është ndër funksionet më të rëndësishme të shtetit tonë, pasi kemi të bëjmë me menaxhimin e një organizate që garanton siguri, rend dhe ligj në gjithë Republikën e Kosovës.

Që nga marrja e mandatit jemi angazhuar që jo vetëm brenda policisë, po në të gjitha institucionet tona të ketë njerëz me integritet e profesionalizëm në detyrat e tyre. Shembull i tillë duhet të jetë edhe menaxhmenti, e në veçanti drejtori i Policisë, si prirës i organizatës.

Unë tash më besoj se ju e dini që faza e dorëzimit të aplikacioneve është përmbyllur, tani jemi në proces të themelimit të komisionit që do të vijojë faza të tjera të procesit. Sa po të themelohet komisioni me anëtarët që plotësojnë kriteret, do të vazhdojmë me procedurat e tjera deri në finalizim.

Unë shpresoj, po jam edhe i bindur që komisioni me profesionalizëm e në bashkëpunim edhe me monitorët vendorë, po edhe ndërkombëtarë, të këtij procesi, do t'ia dalin me sukses këtij procesi jashtëzakonisht të rëndësishëm.

KRYETARI: Zonja Musliu, keni rastin tash për pyetjen tjetër.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Zoti ministër,

Vetë mosemërimi i drejtorit të Policisë që sa kohë që kanë kaluar mbi tre muaj, domethënë është një lloj shkelje dhe një lloj neglizhence e punës në këtë sektor që po bëhet nga ju, dhe jo nga policia. Në asnjë formë dhe në asnjë rrethanë nuk dyshoj në profesionalizmin e Policisë së Kosovës, po më intereson të di kur do të përfundojë ky proces, sepse e kam të qartë që është mbyllur procesi i aplikimit ose i konkursit dhe tani kanë kaluar afër dy muaj që po e kalon edhe afatin ligjor dhe ju ende thoni që do të themelohet komisioni, i cili do të procesojë pastaj, kështu-ashtu dhe nuk po tregoni se kur do ta emëroni dhe pse s'po e emëroni. Ku është filozofia e kësaj që ju nuk po e emëron drejtorin? A nuk po ju besoni atyre kandidatëve apo çka është në pyetje?

KRYETARI: Ministrit Sveçla i ka mjaftuar përgjigjja e parë.

Ka përfunduar kjo pjesa e pyetjeve parlamentare. Tash dalim te projektligji i vetëm që e kemi në rend të ditë për sot:

#### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Buxhet e ka shqyrtuar Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Këtë projektligj për ndarjet buxhetore para Kuvendit e prezanton kryeministri Albin Kurti. Urdhëroni!

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Të dashur qytetarë,

Viti i kaluar ishte viti më i suksesshëm në historinë e shtetit tonë për sa u përket të hyrave dhe rritjes ekonomike. Ky vit, me gjithë sfidat dhe krizat globale, vazhdoi trendin pozitiv, dhe na mundësoi të kemi një konsolidim të financave publike. Sipas vlerësimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Kosova është prej vendeve të para në mesin e ekonomive në zhvillim në Evropë që ka arritur një sukses të tillë, e që është referencë e FMN-së për shtetet e tjera sa i përket konsolidimit të financave publike.

Kjo na vë në pozitë më të favorshme për sfidat që mund të na presin vitin tjetër. Ndërkohë që kemi një projeksion mjaft pozitiv për vitin e ardhshëm fiskal.

Buxheti për vitin 2023 do të jetë 3 miliardë e 212 milionë euro, kurse të hyrat buxhetore do të arrijnë vlerën prej 2 miliardë e 884 milionë euro. Me ç'rast kemi ndarë 745 milionë euro në kategorinë “Paga dhe mëditje”, 493 milionë euro në kategorinë “Mallra dhe shërbime”, 1 miliard e 98 milionë euro në “Subvencione dhe transfere” dhe 811 milionë euro në “Shpenzime kapitale”.

Për sa u përket projekteve specifike, ato reflektojnë Programin tonë Qeverisës: Kemi shtuar 240 pozita të reja për inspektoratet. Kjo nënkupton më shumë inspektorë të punës që të mbrohen të drejtat e punëtorëve; më shumë inspektorë në shëndetësi që të sigurohet cilësia e shërbimeve; më shumë inspektorë të tregut që të sigurohet mbrojtja e konsumatorit; dhe më shumë inspektorë tatimorë që të sigurohet mbledhja e tatimeve që mundëson ofrimin e shërbimeve më të mira publike.

Kemi ndarë 296 milionë euro për sektorin e shëndetësisë, më së shumti ndonjëherë që prej shpalljes së pavarësisë. Nga këto, 60 milionë euro janë për barna esenciale, në mënyrë që sigurohemi që spitalet dhe qendrat e mjekësisë familjare janë mirë të furnizuara për të ofruar shërbime ndaj qytetarëve.

Rëndësi i kemi kushtuar edhe ndërtimit të infrastrukturës shëndetësore. Rritjen e buxhetit në infrastrukturën shëndetësore e kemi shoqëruar edhe me rritjen e numrit të stafit mjekësor, ku kemi shtuar 400 pozita. Në linjë me premtimin tonë për zhvillimin e hershëm të fëmijëve, kemi vazhduar linjën buxhetore për ndërtimin e çerdheve, ku për këtë vit kemi buxhetuar 11 sosh.

E njëjloj sikurse në shëndetësi, investimet në infrastrukturë i kemi përcjellë me rritjen e kapaciteteve njerëzore. Kemi shtuar 243 pozita të reja për staf për çerdhet që parashihen të funksionalizohen. Gjithashtu, me këtë projektbuxhet, po e përmbushim, madje duke e tejkaluar atë që në vitin e dytë të mandatit, premtimin tonë për angazhimin e 500 asistentëve për fëmijë me aftësi të kufizuara. Kemi vazhduar mbështetjen për bujqit dhe fermerët tanë. Për vitin 2023, buxheti për ta për herë të parë e kap shifrën 87 milionë euro. Bashkë me mbështetjen nga fondet e jashtme, presim ta tejkalojmë vlerën prej 100 milionë euro, çka edhe ka qenë premtim yni. Në kontekstin aktual, mbështetja në sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes është e rëndësishme.

Andaj kemi shtuar 300 pozita të reja për Policinë dhe kemi rritur buxhetin për blerje të armatimit modern për ushtrinë tonë. 123 milionë euro parashihet buxheti i përgjithshëm për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin tjetër. Pra në këtë vit e patëm rritur buxhetin për mbrojtje për përafërsisht 52% krahasuar me vitin e shkuar, ndërkaq në vitin që do të vijë do të jetë edhe 20% përafërsisht më i lartë se sa në këtë vit.

Përveçse më i larti ndonjëherë, ai është gati dyfish më i lartë se sa buxheti që patëm trashëguar në vitin 2021, nga 67 milionë, në 123 milionë – teksa qeverive të kaluara u janë dashur 10 vjet

për ta bërë njëjtën gjë. Në vitin 2011 buxheti ka qenë 35 milionë, e më pastaj në vitin 2021, 67 milionë.

Shtesat për lehona e për fëmijë që i premtuam, i filluam në kohë kur të gjithë ishin skeptikë që ato do të mund të realizohen. Brenda vitit të dytë të qeverisjes, me buxhetin për vitin 2023, po e përmbushim edhe këtë premtim tonin, duke i përfshirë në skemë të gjithë fëmijët nën moshën 16-vjeçare. Për këtë kemi ndarë buxhet në vlerë prej 60 milionë eurosh.

Kthimi i terminaleve doganore shtetërore ishte gjithashtu njëri nga premtimet tona. Përmbushjen e tij e filluam në vitin që po lëmë pas, me hapjen e terminalit doganor shtetëror në Mitrovicë, në hapësirat e ndërmarrjes publike Trepça. Kurse sivjet funksionalizuar terminalin doganor shtetëror në Durrës dhe atë në Podujevë. Kësisoj do të vazhdojmë edhe me terminalin në aeroportin e Prishtinës dhe në Vërmicë, si dhe me terminalet e tjera, për çfarë kemi ndarë gjithsej 6 milionë euro.

Kemi buxhetuar përfundimin e rrugëve që tashmë janë në proces për disa vjet, si dhe kemi shtuar edhe buxhet për nisjen e zgjerimit të rrugës Prishtinë-Pejë, dhe ndërtimin e rrugës Prizren-Tetovë. Për banimin e përballeshëm, tani që kemi studimin e fizibilitetit të kompletuar, kemi paraparë nisjen e punës vitin që vjen, dhe njëkohësisht kemi filluar procedurat për të siguruar financimin e nevojshëm nga institucionet financiare ndërkombëtare. Do të vazhdojmë edhe mbështetjen e ndërmarrjeve publike, në rikthimin e tyre në fitimprurëse, ashtu që ato të bëhen kontribuese të zhvillimit ekonomik. Edhe këtë herë, kemi ndarë 40 milionë euro për investime në këto ndërmarrje.

Pas një viti jashtëzakonisht të suksesshëm në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, buxheti për vitin e ardhshëm i kësaj ministrie do të jetë mbi 57 milionë euro, pra dukshëm më i lartë se sa ai i këtij viti. Për rezervat shtetërore i kemi ndarë edhe 15 milionë euro shtesë për vitin 2023 për të vazhduar mbushjen e tyre, pas ndarjes 10 milionë euro për këtë vit në të cilin ndodhemi.

Dhe tani me mbështetjen e Bashkimit Evropian do t'i kemi edhe 75 milionë euro të tjera që do të shkojnë për mbështetje të qytetarëve për ta tejkaluar krizën energjetike. Kjo vjen shtesë mbi projektet e shumta në sektorin e energjisë që do të fillojnë së shpejti, siç është ai me zgjerimin e ngrohjes qendrore, parkun solar në KEK, e bateritë me Korporatën e Sfidës së Mijëvjeçarit.

Në politikën e jashtme, fokusi i investimit buxhetor këtë vit do të jetë në Diplomaci Publike, Diplomaci Ekonomike dhe mërgatë. Ka edhe shumë projekte e nisma të tjera që janë në këtë buxhet, por ka edhe shumë sfida. Megjithatë, bashkërisht, do të duhej që përmes realizimit të Programit Qeverisës, dhe ekzekutimit të mirëfilltë të këtij buxheti, ta lehtësojmë jetën e qytetarëve, ta zhvillojmë ekonominë dhe ta rrisim punësimin.

Të nderuar qytetarë,

Jemi të vetëdijshëm për situatën e rëndë ekonomike dhe energjetike, e cila është shkaktuar nga lufta e Rusisë në Ukrainë. Ky projektbuxhet është menduar që t'u vihet tërësisht në ndihmë juve. Me të vazhdojmë realizimin e zotimeve dhe projekteve tona zgjedhore e qeveritare, e gjithashtu edhe ballafaqimin me krizën aktuale. Kur garuam në zgjedhjet e 14 shkurtit të vitit të kaluar, të vetmen krizë që e kishim para, ishte ajo COVID-19. Me të ardhur në detyrë arritëm që shumë shpejt t'i sigurojmë vaksinat për të.

Por, në ndërkohë lindi edhe një krizë e re, e cila u shkaktua si pasojë e agresionit ushtarak e invazionit rus ndaj Ukrainës. Inflacioni, kriza energjetike e kriza ushqimore janë këto tri pika kryesore, të cilat po diskutohen në të gjitha vendet e botës. Prandaj, të gjitha ato që i përmenda më herët, janë në shërbim edhe të kësaj. Si kabinet qeveritar ne kemi vigjilencën e shtuar që të marrim masa e vendime konkrete sa herë të jetë e nevojshme, për t'ju lehtësuar jetën e për t'ju rritur mirëqenien.

Andaj, Pakon e Ringjalljes Ekonomike që e filluam në vitin 2021, e vazhduam edhe në vitin 2022, duke ia bashkangjitur edhe Pakon e Përbaljes me Inflacionin.

Andaj, të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës, këtë mbështetje për fushat e lartpërmendura dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës, që parasheh projektbuxheti për vitin e ardhshëm 2023, ju ftoj që ta mbështesni me votuan tuaj sot. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kjo ishte paraqitja e Projektligjit për ndarjet buxhetore nga kryeministri.

Tash ia japim fjalën kryetarit të Komisionit për Buxhet, deputeti Armend Muja. Fjala e tij është për ta arsyetuar raportin e këtij komisioni.

**ARMEND MUJA:** I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere e ka shqyrtuar Projektligjin për ndarje buxhetore 2023 dhe u ka rekomanduar deputetëve të këtij Kuvendi që të njëjtin ta miratojnë në parim.

Trajtimi i këtij projektligji është bërë në dritën e ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit dhe provizionet mbi miratimin e buxhetit vjetor.

Komisionet gjegjëse funksionale fitojnë të drejtën të dëgjojnë organizatat buxhetore ngjashëm sikur deputetët.

Miratimi në parim sot i këtij projektligji inicion procedurën dhe mundësinë e rishikimit ndërmjet dy leximeve.

Deputetët mund të propozojnë amendamente brenda dhjetë ditësh pas miratimit në parim, ndërkohë që komisionet parlamentare propozojnë amendamente brenda katërmëdhjetë ditësh pas miratimit në parim.

Nëse ky projektligj mbështetet sot në parim, atëherë afati i fundit për pranim të amendamenteve është 27 nëntori për deputetët, ndërsa data 1 dhjetor për komisionet parlamentare.

Komisioni për Buxhet të paraqesë raport përfundimtar para këtij Kuvendi, jo më larg se 10 dhjetor të vitit 2022, në ndërkohë që ne shpresojmë që në seancën e datës 15 dhjetor, ashtu siç e parasheh Rregullorja, do të rezervohet për shqyrtim të dytë të Projektligjit për ndarje buxhetore.

Në lidhje me përmbajtjen e Projektligjit për ndarje buxhetore Qeveria ka propozuar që ky buxhet vjetor të ketë shpenzime në vlerë prej 3 211 000 000 euro. Ky buxhet i propozuar është më i larti në historinë e Kosovës. Shpenzimet e propozuara për vitin 2023 janë për rreth një miliard më të larta sesa shpenzimet e qeverive gjatë viteve 2019, 2020 dhe potencialisht edhe vitit 2021.

Shpenzimet e propozuara mbështeten edhe në nevojën për financim të brendshëm dhe të jashtëm. Sidoqoftë, shkalla e borxhit publik në raport me bruto produktin vendor do të mbetet në shkallën 22,5%, aq sa ishte në vitin 2020.

Deficiti buxhetor, si definicion i rregullës fiskale dhe në raport me bruto produktin vendor, parashihet të jetë nën 2% dhe është brenda kufijve të paraparë buxhetorë në Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Rikthimi brenda margjinës së lejuar të deficitit fiskal mund të jetë arritur edhe më herët seç parashihej në vitin 2022 dhe 2023. Kjo demonstroi një politikë fiskale të përgjegjshme dhe performansë të mirë buxhetore.

Kosova mbetet vendi me shkallën e borxhit publik më të vogël në rajon dhe potencialisht edhe në mbarë Evropën. Shpenzimet e propozuara në zëra të ndryshëm buxhetor janë bërë të mundura nga performansa e dy vjetëve të kaluara në rritje ekonomike, në formalizim të sektorëve të ndryshme të ekonomisë, kontributet e diasporës në remitenca dhe në sektorin tonë të shërbimeve.

Po ashtu, këto shpenzime bëhen për shkak të rritjes së kontributeve në zëra të ndryshëm. Për shembull, bizneset parashihet të kontribuojnë rreth 193 milionë euro në formë të tatimit në të ardhura të korporatave, që paraqet një dyfishim krahasuar me kontributet e vitit 2019 dhe vitit 2020. Kjo ka ardhur pa u ndryshuar politika fiskale, apo pa u rritur tatimet.

Të ardhurat nga tatimet në të ardhura personale, apo tatime që kontribuojnë kryesisht punëtorët e Kosovës, parashihet të jenë 263 milionë euro dhe kjo paraqet një rritje prej 66% krahasuar me vitin 2020 dhe 55% krahasuar me vitin 2019.

Të ardhurat më të larta natyrisht parashihen të jenë nga mbledhja e tatimeve në konsum, apo në TVSH. Në këtë kategori të të hyrave projektligji parashikon mbledhje tatimore në vlerë prej 1 387 000 000 eurosh. Kjo paraqet pothuajse dyfishim krahasuar me vitin 2020. Natyrisht, këto mbledhje tatimore reflektojnë një rritje reale të konsumit, që nga atëherë, po edhe rikthimin ekonomik. Por, ekonomia jonë që nga atëherë nuk është dyfishuar, janë dyfishuar mbledhjet tatimore.

Ekziston mundësia që edhe inflacioni të ketë ndihmuar që këto të hyra të rriten, megjithatë shkalla e inflacionit gjatë vitit 2021 dhe vitit 2022 nuk e ka tejkaluar 12,2%, në ndërkohë që të hyrat nga TVSH-ja janë dyfishuar.

Përderisa kontributet janë të regjistruara, ne gjykojmë që kjo reflekton kryesisht një kombinim të performansës ekonomike, luftimit të evazionit fiskal, që në vetvete paraqesin synime strategjike të Kosovës, po edhe të kësaj Qeverie.

Të nderuar deputetë,

Të hyrat e Kosovës nga tatimet në vitin 2020 ishin 1,5 miliardë euro. Të hyrat e propozuara tatimore për vitin 2023 parashihet të jenë 2,6 miliardë euro. Ndërmjet 2010 dhe vitit 2019 ka pasur rritje të të hyrave tatimore në Kosovë, për çdo vit janë shtuar nga 60 milionë euro. Që nga viti 2021 të hyrat tatimore të Kosovës në baza vjetore po shtohen nga 333 milionë euro.

Në kuptim të kategorive operative dhe programore të shpenzimeve është e rëndësishme të potencohet se shpenzimet në paga parashihet të rriten nga 671 milionë euro, në 746 milionë euro. Është një rritje e ndjeshme dhe kryesisht në frymën e Ligjit për menaxhimin e financave publike.

Shpenzimet në investime kapitale, që kryesisht reflektojnë prioritete të mëdha infrastrukturore, parashihet të arrijnë një rekord prej 811 milionë eurosh. Shpenzimet që i dedikohen qeverisjes lokale parashihet të arrijnë në 660 milionë euro, që është një rritje për 100 milionë euro, krahasuar me vitin paraprak.

Deputetë të nderuar,

Shpenzimet për subvencione dhe transfere, që reflektojnë kryesisht programet për barazi sociale, parashihet të arrijnë në 1,1 miliard euro, që është diku rreth 500 milionë euro më shumë sesa viti parapandemik 2019.

Shpenzimet për pensionet bazike, që parashihet të arrijnë në vlerën prej 182 milionë euro, është një rritje prej 8% krahasuar me vitin paraprak, apo 25% krahasuar me vitin 2019. Pensionet për personat me aftësi të kufizuar parashihet të arrijnë në 23,1 milionë euro, që është një rritje prej 25% krahasuar me vitin e kaluar, apo 44% më shumë sesa viti 2019.

Pagesat për shtesat e fëmijëve dhe lehonave parashihet të rriten në 60 milionë euro, për të kompletuar kështu skemën e kompletuar të shtesave për fëmijë. Transferet sociale për familje që jetojnë në varfëri parashihet të jenë 48 milionë euro, që është një rritje prej 33% krahasuar me vitin 2019.

Janë edhe disa prioritete të tjera të rëndësishme, që duket se kanë marrë vëmendjen e Qeverisë.

Shëndetësia, arsimi, mbrojtja dhe prodhimi.

Shpenzimet në shëndetësi parashihet të arrijnë në 300 milionë euro, që është një rritje prej 15% krahasuar me vitin 2022, apo rreth 50% më shumë sesa viti parapandemik 2019. Pra, nga 200 milionë që ishin në vitin 2019, shpenzimet në shëndetësi kanë arritur në 300 milionë.

Shpenzimet në arsim kanë arritur një rekord të ri. Shpenzime të konsiderueshme i janë dedikuar gjithëpërfshirjes në arsim, ndërtimit të çerdheve, arsimit profesional dhe digjitalizimit të shkollave.

Shpenzimet në mbrojtje dhe siguri arrijnë në 123 milionë euro, që është një dyfishim krahasuar me vitin 2019.

Buxheti i propozuar, që synon nxitjen e prodhimit në bujqësi dhe ndihmesë për bujqit, arrin në 87 milionë euro, që është një rritje e konsiderueshme krahasuar me vitet paraprake.

Si përfundim, në kuadër të Buxhetit parashihet shtim i shpenzimeve publike në investime kapitale e mallra dhe shërbime, që arrijnë vlerën 1.3 miliardë euro dhe kjo kontribuon substancialisht në shtimin e aktivitetit biznesor dhe zhvillimin ekonomik.

Buxheti parashihet transfere rekord sociale për të ndihmuar familjet në nevojë, gjithashtu edhe shpenzime rekord në mbrojtje dhe siguri.

Shi për këtë, kërkojmë që deputetët të miratojnë këtë projektligj në parim, në mënyrë që t'i hapet rrugë procedurës së rishikimit të këtij buxheti. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash është radha e grupeve parlamentare. Së pari Vetëvendosja, kryetarja e këtij grupi, Mimoza Kusari-Lila.



MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës.

Sot po e trajtojmë një ndër projektligjet më të rëndësishme në vitin kalendarik, Projektbuxhetin e vitit 2023.

Ashtu sikur është prezantuar nga Qeveria, ky projektbuxhet parashihet të jetë buxheti më i lartë në historinë e Republikës së Kosovës, në vlerën prej 3 211 000 000 euro. Megjithatë, përtej statistikave dhe numrave të prezantuar në përgjithësi, është me rëndësi të prezantohen politikat dhe projektet në veçanti, të cilat kanë marrë mbështetjen e Qeverisë së vendit për planet e vitit të ardhshëm.

Rritja e të hyrave të planifikuara në Projektbuxhetin në vlerën prej 16%, apo 453 milionë euro, përveç numrit tregon edhe për rritjen e besimit në institucionet e vendit dhe kthimin e stabilitetit në performansën buxhetore. Vetëm prej tatimeve parashihen të hyra prej 2,52 miliardë euro, që është një rritje e jashtëzakonshme për mbi 356 milionë euro krahasuar me vitin aktual, apo vitin 2022.

Shpenzimet e planifikuara parashihet të jenë 3 211 000 000 milionë, që është rritje prej 10%, apo 313 000 000 euro, krahasuar me rishikimin buxhetor të vitit 2022.

Nëse analizojmë shpenzimet sipas kategorive kryesore, Projektbuxheti i vitit të ardhshëm paraqet vlerat si vijon:

Në kuadër të kategorisë për pagat gjithashtu është e paraparë një vlerë shtesë, apo një rritje prej 74 000 000 euro. Në total është 745 000 000 euro, që gjithashtu e jep përgjigjen për gjithë zhurmën që është bërë se në Projektbuxhetin e vitit 2023 nuk është përfshirë Ligji i pagave.

Me këtë projektbuxhet dhe me këtë shumë kontingjente shihet se është tërësisht i implementueshëm Ligji i pagave, i cili pritet që shumë shpejt të miratohet në Qeveri dhe pastaj t'u vijë deputetëve të Kuvendit të Republikës për të hyrë në fuqi në momentin kur miratohet në këtë Kuvend.

Mallra dhe shërbime janë 493 milionë euro, apo rreth 90 milionë euro më shumë krahasuar me vitin aktual, apo vitin 2022.

Subvencione dhe transfere 1 098 000 000 euro, apo 53 milionë euro të planifikuara më shumë se në vitin 2022. Përderisa, ashtu siç e thanë edhe parafolësit, kategoria e investimeve kapitale shënon një rritje të ndjeshme, që kap vlerën prej 106 milionë euro.

Të nderuar deputetë,

Është me rëndësi të theksohet se rritja e buxhetit në këtë masë është bërë pa shkaktuar deficitin buxhetor dhe rritjen e borxhit publik. Përkundrazi, me buxhet është kthyer në suaza të normales deficitin buxhetor, i cili do të jetë vetëm -2% të bruto produktit vendor, përderisa pritet që vitet e ardhshme kjo vlerë edhe të zvogëlohet.

Borxhi publik është mbajtur, ashtu siç e tha edhe kryetari i komisionit, në përqindje 22,5%, i cili është i njëjtë me vitin aktual dhe më i ulëti në rajon.

Me Buxhetin e vitit 2021 ishte projektuar që në vitin 2023 të kishte rritje të borxhit publik deri në 36% të bruto-produktit vendor. Por, falë politikave të shëndosha fiskale dhe rritjes së të hyrave nga tatimet, futja e vendit në borxhe të tilla është ndalur, edhe pse ka pasur ide edhe projekte të reja që mund të realizoheshin.

Të nderuar deputetë,

Projektbuxheti i vitit 2023 është buxhet i mirëqenies sociale, buxhet i zhvillimit ekonomik, buxhet i sigurisë, mbrojtjes, shëndetësisë dhe arsimit. Është buxhet i mirëqenies sociale, sepse do të rritet mbështetja për kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë, siç janë lehonat, po ashtu përfshirje në skemën e shtesave të të gjithë fëmijëve deri në moshën 16-vjeçare, me një buxhet prej 60 milionë euro.

Janë planifikuar edhe 6,5 milionë euro për çerdhe të reja, e cila politikë do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e punësimit, mundësimin e prindërve, me theks të veçantë nënave, në inkuadrimitin e punës, duke marrë parasysh që kemi një përqindje tepër të vogël të grave që janë punëkërkuese aktive në tregun e punës.

Gjithashtu, për herë të parë do të ketë skemë të veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara, për të cilët janë ndarë 3,5 milionë euro.

Po ashtu, janë paraparë projekte kapitale, që do rrisin mirëqenien tek shtresa të caktuara të shoqërisë, siç është rasti i ndërtimit të pesë shtëpive për kujdesin e të moshuarve.

Është buxhet i zhvillimit ekonomik, sepse parashihet rreth 106 milionë euro rritje tek investimet kapitale, 120% apo 90 milionë euro rritje në buxhetin e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, 15 milionë euro rritje për Ministrinë e Bujqësisë të fokusuar tek subvencionet, buxhet për sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes, që është rritur për 20% krahasuar me vitin aktual,

buxhet në sektorin e shëndetësisë, që do të jetë 296 milionë, me një rritje prej 15%, krahasuar me vitin aktual. Buxhet e arsimit, sepse do të ndahen 285 milionë euro në këtë sektor, duke përfshirë shkolla të reja, çerdhe për fëmijë, investim në teknologji dhe ngritje të cilësisë së arsimit. Buxhet për kulturën, rininë dhe sportin, sepse do të ndahen 45%, apo 17,8 milionë euro më shumë sesa viti aktual, të fokusuara në investime kapitale dhe subvencione në këta sektorë.

Të nderuar deputetë,

Sigurisht që ky projektbuxhet nuk ka lënë anash edhe rritjen e mbështetjes për komunat, duke mbështetur komunat si asnjëherë më parë në projekte kapitale edhe tek rritja e numrit të stafit për arsim dhe shëndetësi.

Buxheti për nivelin lokal është rritur për 92 milionë euro, krahasuar me vitin 2022, prej tyre 60 milionë janë rritur investimet kapitale, 21,5 milionë mallrat dhe shërbimet dhe 7,6 milionë rritje për subvencione dhe transfere.

Duke marrë parasysh veprimet që i kanë paraprirë këtij buxheti e që janë rregullimi i çështjeve të shpronësimeve për projektet kapitale, miratimi i Ligjit për punët publike, rishikimi dhe ribuxhimi i projekt-kodeve të bartura ndër vite, buxheti i vitit të ardhshëm do të jetë buxheti me përqindjen më të madhe të realizuar ndonjëherë.

Të nderuar deputetë,

Projektligji për buxhetin është njëra ndër ngjarjet kryesore të Kuvendit të Republikës për vit kalendarik. Është me rëndësi të theksohet se për herë të parë me ndryshimin e Rregullores së punës së Kuvendit shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin do të bëhet edhe nga komisionet funksionale parlamentare, sipas fushave që mbulojnë. Andaj, ftoj të gjithë të interesuarit, organizatat e shoqërisë civile, që të bëhen pjesë e dëgjimeve dhe diskutimeve publike kur komisionet funksionale të Kuvendit t'i caktojnë ato, në mënyrë që edhe të informohen për projektet në kuadër të Buxhetit, por edhe të japin propozimet e tyre në mes të dy leximeve.

Në emër timin dhe të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje ju ftoj më që të mbështesim në parim sot Projektbuxhetin e vitit 2023. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kush e paraqet qëndrimin e Grupit të Partisë Demokratike? Deputeti Mërgim Lushtaku e bën këtë.

**MËRGIM LUSHTAKU:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë,

Parti Demokratike e Kosovës e ka analizuar Projektligjin për ndarjen buxhetore për vitin 2023. Vlerësojmë në tërësi se projektligji nuk është i bazuar në rritje reale ekonomike, por në rritjen ekonomike në inflacion, ku Qeveria Kurti 2 duke mos bërë asnjë politikë fiskale lehtësuese për qytetarët në kohë krize, luftoi në rritje statistikore për perceptim, duke varfëruar më tej qytetarët e vendit në kohët më të vështira të tyre.

Buxhetit të Kurtit i mungon ambicia zhvillimore, i mungon ndërlidhshmëria me premtimet e tij elektorale, i mungon ndërlidhshmëria me kërkesat qytetare, i mungon ndërlidhshmëria me strategjinë legislative për vitin 2022 – 2023, sikurse ai për zbatimin e Ligjit të pagave në sektorin publik, apo për Ligjin për mbështetjen e punëve publike, i cili është bërë pa kosto buxhetore dhe natyrshëm që i mungon vizioni, se ku do të jetë Kosova në fund të vitit 2023.

E kemi thënë edhe disa herë, Buxheti i këtij viti po rezulton më i lartë në krahasim me vitin paraprak, kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve në ekonomi dhe jo për shkak të rritjes së aktiviteteve ekonomike apo atyre politike qeveritare.

Rritja ekonomike për 5,5% në vitin 2023, i paraparë nga Qeveria Kurti 2, është imagjinar dhe bie në kundërshtim me parashikimet e Fondit Ndërkombëtar Monetar dhe Bankës Botërore, si institucion më kredibil, i cili vlerëson se rritja ekonomike për vitin 2023 nuk pritet të jetë më e lartë se 3%.

Për të marrë më të saktë një qeveri duhet ta krahasojmë atë me çfarë ka premtuar në fund të vitit 2021 dhe ka realizuar deri më tani, në vitin 2022. Qeveria Kurti për vitin 2022 kishte dhënë fjalë të mëdha. Ka prezantuar shifrën buxhetore të investimeve kapitale për mbi 700 milionë euro, ndërsa tashmë kur ka kaluar pjesa më e madhe e vitit 2022 investimet kapitale të realizuara nuk rezultojnë të jenë më të larta se 25%. Ndërsa, dihet fare mirë që për shkak të paaftësisë së kësaj Qeverie qytetarët mbetën pa i shfrytëzuar investimet publike, që do të lehtësonin jetën e tyre të përditshme. Po të ishin ato mjete në xhepat e qytetarëve, apo në arkat e bizneseve, këto para do të dyfishoheshin, apo edhe do të trefishoheshin, ndërsa në thesin e Qeverisë po humbasin çdo ditë vlerën për nga inflacioni, së paku 20%.

Në këtë projektbuxhet janë planifikuar të jenë vetëm 810 milionë euro dhe janë skajshmërisht të ulëta nëse do të krahasojmë me fillimin e buxhetit total dhe me rreth 500 milionë euro të papërfunduara për vitin 2022. Sigurisht, që punët e papërfunduara të vitit 2022 do të tentojnë t'i përfundojnë në vitin 2023, por me një kosto shumë më të lartë për buxhetin e shtetit, për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore, ku humbja dhe keqmenaxhimi i parasë publike do të jetë evident.

Në aspektin e orientimit të buxhetit në nivel qendror dhe lokal në aspektin e përqindjes, shihet qartë një zvogëlim i mbështetjes së komunave. Sigurisht se është shqetësuese, kur dihet se dera e parë e kërkesave, ankesave dhe sigurisht ndihmave, janë pikërisht nga komunat.

Kur jemi tek projektet kapitale, ju kujtohet reagimi im për largimin e pashembullt të një projekti vital për qytetarët, edhe pse ishte në fazën e fillimit të punimeve, vetëm e vetëm për hakmarrje politike ndaj një rajoni. E kam fjalën për ujësjellësin në Brus, i cili do të lehtësonte rajonit të Mitrovicës dhe do t'u ndihmonte qytetarëve të Skenderajt që të kenë ujë të pijshëm dhe të mjaftueshëm.

Ju keni premtuar se nuk e keni për hakmarrje politike, por në vitin 2023 do të planifikoni. Por, ja që këtë nuk e bëtë dhe po e vërtetoni që ju po hakmerreni për një rajon, vetëm e vetëm sepse qytetarët e vendit nuk e kanë besimin në Vetëvendosje si parti, si ideologji dhe si mendësi.

I njëjti fat është edhe me projektin e Stadiumit Kombëtar, ku janë, ku është ky projekt që po harrohet nga kjo Qeveri, dhe projekte të tjera që duhet të ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe në punësim në sektorin privat.

Të nderuar qytetarë,

Lideri i një partie të majtë më konsekuent në ideologjinë e gjithë kontinentit evropian është sot në luftë me sindikatat. Edhe pse u premtoi se në vitin 2023 do ta kemi Ligjin e pagave të zbatueshëm, me këtë projektbuxhet shihet qartë që janë të mashtruar dhe të harruar. Janë të harruar mësimdhënësit, nëpunësit civilë, mjekët, punëtorët në sektorin privat, dy sektorë të sigurisë, policët dhe ushtarët, e të tjerë. Rritja e pagave në sektorin privat e publik, rritja e pensioneve dhe ndihmave sociale për të paktën aq sa është rritur niveli i përgjithshëm i çmimeve, nuk shihet në horizontin e planifikimit të Qeverisë Kurti as në vitin 2023.

Sigurimet shëndetësore janë temë që është harruar, po ashtu edhe mbështetja me buxhet të shëndetësisë shihet si statistikë, e jo si investim në shëndetin publik, pasi që duket se nuk kanë një ekip profesionist, apo një politikan, për ministër të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili duhet ta ketë prioritet këtë sektor të ndjeshëm, ku çdo ditë e më shumë, për shkak të shtrenjtimit të barnave esenciale dhe qeverisjes së majtë të Kurtit, i ka harruar fare qytetarët e ngratë që e kanë të vështirë mbijetesën e lëre më të paguajnë për barnat esenciale.

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka kritikuar, duke kërkuar që të rritet transparenca dhe që të kenë më shumë dobi qytetarët në procesin e menaxhimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës. Sa i përket financimit, nëse keni pasur performansë të mirë të të hyrave si rezultat i kësaj Qeverie, atëherë nuk është dashur të kemi një rritje të konsiderueshme të financimit nga burimet e jashtme.

Nëse e krahasojmë, kemi një rritje të projekt-kreditë, pra nëse e përkthejmë në të dhënat, nga 227,7 milionë euro në vitin 2020, ndërsa kemi rritje në vitin 2023 në 422,9 milionë euro, apo 195 milionë euro më tepër. Domethënë, marrim kredi për mallra dhe shërbime.

Nëse vështojmë projekt-kreditë nga rishikimi i vitit 2022, ku kanë qenë 193,5 milionë, në këtë projektbuxhet kemi 203.3 milionë, rritje për 6,8 milionë euro për projekt-kreditë. Kemi rritje të stokut të kredive, arritje vlere prej rreth 4,18 miliardë euro, duke shënuar kështu një rritje prej 18,6% në krahasim me vitin paraprak. Stoku i kredive të ndërmarrjeve është rritur me 18,2, kurse stoku i kredive të ekonomive familjare me 18%. Kjo pasqyron më së miri gjendjen faktike të kësaj qeverie me kredi dhe gjithashtu, edhe të këtij populli.

Investime totale private e publike kanë pasur një kontribut negativ në rritjen reale të bruto-produktit vendor rreth 6,7%, apo rënie vjetore prej 16,8%, kryesisht si rezultat i mosmenaxhimit adekuat i kësaj Qeverie, dinamikës së ngadaltë të ekzekutimit të shpenzimeve kapitale. Nuk pritët të ketë performansë të mirë as në këtë projektbuxhet.

Kur jemi të bilanci tregtar, është rënduar akoma më tepër. Pra, në këtë projektbuxhet nga neto-eksportet e mallrave dhe shërbimeve do të rritet deficiti tregtar për 139 milionë euro më tepër.

Nuk ka paraparë mjete për reformat në Policinë e Kosovës, freskimin e strukturës përmes pensionimeve të parakohshme dhe vërehet një shpërfillje e plotë e strategjisë së sigurimeve kombëtare, e cila u dëmtua së fundmi. Andaj, edhe ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike, duke ngritur të gjitha këto shqetësime, shohim që kjo Qeveri nuk meriton të mbështetet me këtë projektligj për vitin 2023.

**KRYETARI:** Tash është radha e Lidhjes Demokratike. Kush e bën qëndrimin e grupit? Deputeti Besian Mustafa e jep qëndrimin e Lidhjes Demokratike për ndarjet buxhetore.

**BESIAN MUSTAFA:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar media dhe qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kemi dëgjuar këtë Qeveri shpeshherë duke thënë në media dhe në këtë Kuvend se ky qenka buxheti më i madh në histori, por dua t'ju rikujtoj se kjo është e vërtetë për secilin vit. Pra edhe vitin e kaluar, edhe vitin e ardhshëm do të jetë buxheti më i madh në histori, e pas atij viti do të jetë përsëri buxheti më i madh në histori e kështu me radhë, sepse jemi shtet i vogël në zhvillim e sipër dhe gjithnjë do të kemi buxhet më të madh. Do të vijë një ditë ndoshta kur do të kemi buxhet të njëjtë nga viti në vit, por ajo do të jetë dekada e dekada nga sot.

Kjo lëvdata që kemi buxhetin më të madh në histori ka qëndruar secilin vit nga viti 1999, e do të vazhdojë kështu edhe për dekada me radhë.

Në anën tjetër, kemi një inflacion të produktet bazike dhe materialet ndërtimore, pra tek pjesa më e madhe e buxhetit që kalon shifrën mbi 20 për qind. Kjo i bie se buxheti real është diku 2.6 miliardë dhe jo 3,2 miliardë. Por përkundër kësaj shifre, kur vjen puna tek ndarja e buxhetit të ministritë, nuk kemi zgjidhje të asnjë problemi të vetëm. Në asnjë ministri në vitin 2023 nuk zgjidhet asnjë problem i vetëm nga fillimi deri në fund. Pra kemi një ndarje anemike të dikasteret e Qeverisë.

Po filloj me Ministrinë e Ekonomisë. Asnjë cent i vetëm për rritjen e kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike e Kosova ndodhet në krizë energjetike. Asnjë cen për rritjen e kapaciteteve prodhuese.

Te shëndetësia, përveç që nuk kemi ministër, kemi tre ministra që një vit e gjysmë, që dy vite, pra përveç që s'kemi ministër, nuk ka asnjë cent të dedikuar për reformimin dhe organizimin e këtij sektori vital. Fondi për sigurime shëndetësore në vitin 2023 ka buxhetin e njëjtë si në vitin 2022. Pra nuk e ka asnjë rëndësi të shtuar në vitin e ardhshëm. Në anën tjetër, asnjë cent për funksionalizimin dhe zbatimin e legjislacionit për këtë fond. Nuk shihet që të ketë zhvillime dhe avancime të fondi për sigurime shëndetësore.

Ka shkurtime të rreth treqind vendeve të punës dhe pjesa dërmuese është te arsimit. Pra, në vitin 2023 parashihet të ketë më pak mësues e arsimtarë në shkollat e Republikës së Kosovës. Po ashtu te arsimit, nuk kemi vërejtur te buxheti asnjë reformë përmbajtjesore, asnjë investim në ndërlidhjen e shkollave me tregun e punës, ndërsa arsimit profesional në kolaps të tërë.

Te mjedisi, kemi të ndarë vetëm 6,8 milionë euro buxhet, që është buxhet i mjerë, asnjë cent për master-planin për ujitje të tokave bujqësore. Asnjë zgjidhje për rehabilitimin e shtretërve të lumenjve, ku avaritë shkaktojnë miliona e miliona euro dëme në bujqësi çdo vit dhe askush s'po merret me këtë çështje, asnjë cent i ndarë në këtë drejtim. Asnjë zgjidhje për rezerva dhe sisteme të ujit të pijes nuk parashihet për vitin 2023.

Te infrastruktura, më falni, gati asnjë projekt i ri për vitin 2023. Pra thuhet tërësisht janë vazhdime të projekteve kapitale nga viti 2022 e tutje. Po ashtu te projektet infrastrukturore kemi buxhete anemike. Po i marr disa shembuj. Autostrada ose rruga Besi-Merdar, imagjinoni për vitin 2023 ka vetëm treqind mijë euro, Besi-Merdar, çka do të bëni me këto para, më trego dikush. Në vitin 2024 nuk përmirësohet gjendja fare në këtë rrugë, prapë treqind mijë euro, çka do të bëni me to në rr. Besi - Merdar. Imagjino në vitin 2025, prapë 300 mijë euro, pra për tri vite nëntëqind mijë euro për rr. Besi - Merdar. Nëse di dikush të më tregojë, as shenjzimin horizontal e vertikal nuk arrini ta bëni me ato para.

Zgjerimi i magjistrales Prishtinë - Podujevë, premtim pas premtimi elektorale, qoftë në zgjedhjet parlamentare, qoftë në zgjedhjet lokale që do të përfundojë në tetor e në nëntor, e pastaj në nëntor të vitit 2022, tash imagjinoni çka ndodh në buxhet, thonë që në vitin 2023 do të investojnë gjashtë milionë euro, në vitin 2024 pesë milionë euro dhe në vitin 2025, 11,3 milionë. Pra, më së shumti punë pritet të bëhet në vitin 2025 në magjistralen Prishtinë-Podujevë, e premtimi ka qenë që në nëntor të vitit 2022 do të përfundojë kjo magjistrale. Tash shtyhet për të paktin tri vite.

Rruga Prishtinë-Mitrovicë, përsëri buxhet anemik. Viti 2023, një milion e gjysmë, viti 2024 pesëqind mijë euro, viti 2025 po ashtu gjysmë milioni. Ata që janë të këtij regjioni e dinë çka mund të bëhet me gjysmë milioni në këtë rrugë.

Te drejtësia, nuk kemi parë asgjë substanciale. Ku është buxheti për vetingun, ku është buxheti për Byronë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme? Ku është buxheti për Gjykatën e Punës? Po ashtu më pak buxhet për Këshillin Prokurorial.

Te rinia e Kosovës, imagjino gjithë rinia e Republikës së Kosovës do të duhet të mjaftohet me 1,86 milionë euro. Pra, e gjithë rinia e Kosovës do të duhet të mjaftohet me një investim prej 1,86 milionë euro për vitin 2023, a thashë edhe njëherë as rrugicat nuk mund të shtrohen me këtë buxhet e lëre më të investohet e të avancohet rinia e Republikës së Kosovës.

Natyrisht, si në çdo gjë tjetër, nuk ka planifikim të rregullt, nuk ka transparencë, nuk ka shpalosje, sepse grumbullohet buxheti në zëra. Kanë zbuluar Ministria e Financave tani një trik të ri, ku buxhetin që pastaj nuk duan ta shpalosin e të vendosin çka do të bëjnë me të, duke parë e duke bërë siç e thotë populli, te Ministria e Financave e kemi një fond enorm të kontigjencave. Pra, te investimet kapitale për vitin 2023 njëzet milionë euro. Çka do të bëhet me këto njëzet milionë euro, asnjë fjalë e vetme, duhet të prisni që të shihni se çka do të bëjë Ministria e Financave me njëzet milionë euro kapital kontigjencë në vitin 2023. Nëse kjo ju duket shumë marramendëse, imagjino në 2023, te kapitale ose projekte kontigjente 104,7 milionë, pa thënë asnjë fjalë të vetme se ku do të investohen këto. Në 2025, 100,8 milionë buxhet kontigjent për kapitale pa thënë asnjë fjalë të vetme se ku. Zero transparencë.

Te subvencionet dhe transferet, në vitin 2023, 40,7 milionë euro subvencione dhe transfere kontigjente pa thënë asnjë fjalë të vetme se ku do të investohen këto dhe natyrisht kontigjenca për energji 75 milionë euro. S'ka nevojë thotë ministri, ka një krizë energjetike, po imagjino, në vend që t'ia ndajë Ministrisë së Ekonomisë për të rritur kapacitetet e gjenerimit të energjisë elektrike, Ministrisë së Ekonomisë i ndan asnjë cent për energjinë elektrike, ndërsa në Ministrinë e Financave kemi 75 milionë euro për energjinë. Imagjinoni planifikimin.

Te Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, kemi te zonat ekonomike po ashtu asnjë fjalë për shpalosjen se ku do të investohet. Thotë në vitin 2023, pesë milionë euro për zona



ekonomike, në cilat komuna, në cilat zonat ekonomike, e di ministrja të japë përgjigje. Në 2024, dy milionë për zona ekonomike. Në cilat zonat ekonomike, në cilat komuna, në cilët sektorë të ekonomisë? Asnjë fjalë. Në 2025, po ashtu dy milionë euro, asnjë fjalë se ku do të investohet.

Te Ministria e Mjedisit e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, quhet programi i bashkëfinancimit me kuvende komunale, dy milionë në 2023, 4,8 milionë në 2024, 4,2 milionë në 2025, asnjë fjalë për shpалosjen se ku do të investohet në cilat komuna. E njëjta vlen te shpronësimet e dhjetëra miliona euro, asnjë fjalë shpалosje, zero transparencë se çka do të shpronësohet, ku do të shpronësohet, për çfarë arsye do të shpronësohen.

Ministria e Zhvillimit Rajonal, programi për zhvillim rajonal, në vitin 2023, 1,84 milionë euro. Pra të gjitha zhvillimet, të gjitha rajonet e Kosovës pritet të zhvillohen me 1,84 milionë euro në vitin 2023, dy milionë në 2024 dhe dy milionë në 2025. Po qesh, po kjo është tragjike. Natyrisht as kjo ministri nuk shpалos se në cilat rajone do të investojë dhe në çka do të investojë.

**KRYETARI:** Qetësi ju lutem, se deputeti po flet dhe duhet ta dëgjojmë.

**BESIAN MUSTAFA:** Faleminderit i nderuar kryetar dhe respekt të skajshëm për ju!

Në fund, përkundër këtij buxheti, keni treguar një performansë ekstreme të dobët në dy vitet e kaluara, pra viti 2022 dhe viti 2021 në realizim. Në vitin 2021 është shpenzuar vetëm 35 milionë euro më shumë se në vitin 2020 e viti 2020 ka qenë vit pandemik. Realizimi në 2022, sipas raportit që keni dorëzuar ju vetë në shtator të këtij viti, projekte kapitale vetëm 21 për qind, subvencione dhe transfere vetëm 29 për qind. Imagjino një qeveri e majtë, subvencione e tranfere për nëntë muaj shpenzon vetëm 29 për qind. Pra as të majtën e juaj nuk dini ta ekzekutoni. Mallra dhe shërbime pesëdhjetë për qind, paga dhe shtesa shtatëdhjetë për qind. Bravo, urime! Shtatëdhjetë për qind të buxhetit te pagat e keni realizuar.

Pra, pagat nuk i huqni asnjë cent, investimet kapitale veç 21 për qind. Mund të buxhetoni për këtë vit edhe 32 miliardë euro po të doni, por ekzekutimin e buxhetit, pra puna juaj tregon në dy vitet e kaluara që asnjë punë nuk do ta bëni në 2023. Asnjë punë, asnjë problem nuk do ta zgjidhni nga fillimi në fund.

Kolegë të nderuar,

Veçanërisht deputetë nga partia Lëvizje Vetëvendosje,

Dua të tërheq vëmendjen te neni 9, paragrafi 6 për buxhetin e komunave, ku Ministria e Financave po tenton që të bëjë shkelje kushtetuese dhe të jetë në kundërshti me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe Ligjin për vetëqeverisje lokale. Prandaj, juve ju bëj thirrje t'ia ktheni ministrit këtë ligj.

**KRYETARI:** Kush e paraqet qëndrimin e AAK-së. Këtë e bën deputeti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: Faleminderit kryetar i Kuvendit, i nderuar Konjufca!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të vendit,

Sot është hapur debati mbi buxhetin e vitit 2023 dhe para nesh në njërin anë kemi një gjendje ekonomike e sociale në Kosovë që tani është futur në krizë e në anën tjetër kemi një buxhet që nuk përputhet me nevojat e qytetarëve dhe të ardhmen e shtetit tonë për vitin 2023. Shto këtu edhe ankesën e komunave se Qeveria po e cenon funksionimin e pushtetit lokal me Projektligjin e buxhetit për vitin 2023. Qeveria ka ndërhyrë në pjesën tekstuale të ligjit, duke e shtuar një pjesë. Qeveria e Kosovës gjatë hartimit të Ligjit për buxhetin e vitit 2023 ka ndërhyrë në pjesën tekstuale të ligjit dhe me këtë cenon pavarësinë financiare të komunave. Më saktësisht, te neni 9 i Ligjit të buxhetit të vitit 2023, paragrafi 6, është shtuar heshturazi pasusi i fundit. Madje të gjitha të hyrat vetjake të mbledhura para vitit fiskal 2022 dhe të pashpenzuara bëhen pjesë e fondit të Kosovës në bilancin bankar, thuhet në njoftimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës. Me këtë po tentohet që komunave t'u merren të hyrat vetjake të pashpenzuara.

Ky buxhet nuk reflekton aspak në gjendjen që gjendet sot Kosova. janë disa argumente. Argumenti i parë është deklarata skandaloze e ministrit të Financave. Ai del e i thotë sektorit privat, dilni dhe rritni rrogat se ju është rritur fitimi. Përderisa në këtë buxhet dhe sesion nuk e ka sjellë Ligjin e pagave që e ka në dorë ai vetë. Pra, ministri e ka në dorë ngritjen e pagave në sektorin publik dhe po ashtu e ka buxhetin për këtë punë. As nuk e ka sjellë vijën buxhetore për këtë ligj, mbi të gjitha as nuk ka sjellë koeficientet.

Unë kam shtruar disa pyetje që duhet të preokupojnë ministrin Murati dhe gjithë kabinetin qeveritar në lidhje me këtë buxhet, pasi dihet që përmes këtij buxheti përcaktohet dhe orientimi në mënyrën se si do të jetojnë qytetarët dhe të cilat të mira publike do t'i kemi në Kosovë në vitin 2023.

Qeveria Kurti duhet të jetë e përgjegjshme dhe duhet të dijë se çka të thotë për buxhetin e vitit 2023 qytetarëve, sepse shtrohen pyetjet dhe dilemat si vijnë. Çka t'i thuhet personelit shëndetësor, mjekëve dhe infermierëve pasi në buxhetin 2023 ata nuk do të kenë rritje të pagave, nuk do të kenë sigurime shëndetësore, madje as punë dhe të ardhme e perspektivë në Kosovë. Çka t'u thuhet punëtorëve të sektorit privat, që me buxhetin 2023 ata me pagën minimale të miratuar nuk mund t'ia dalin që të jetojnë dhe nuk do të kenë sigurime shëndetësore, madje as siguri e as kushte për punën që e bëjnë. Çka t'i thuhet rinisë dhe të sapodiplomuarve që me buxhetin 2023 shteti nuk ka parashikuar strategji as plan që të hap vene pune dhe t'u krijojë kushte normale.

Çka t'u thuhet familjeve kosovare që buxhetin për vitin 2023 nuk do të ndikojë pozitivisht në jetën e tyre, pasi ata do të vazhdojnë t'i kenë çmimet shumë të rritura e shportën familjare për jetesë shumë të zvogëluar? Çka t'u thuhet qytetarëve të Kosovës që buxheti për vitin 2023 do t'i gjejë me të ardhura të njëjta në pagë e dyfishim të faturave të energjisë elektrike, derivateve dhe të gjitha produkteve bazë për jetesë? Çka t'u thuhet bizneseve dhe kompanive që buxheti për 2023 do të stimulojë edhe më shumë mbylljen, pasi me këtë gjendje kushtet e operimit do të jenë të pamundura dhe nuk do të kenë mbështetjen e shtetit në asnjë formë.

Çka t'u thuhet komunave që buxheti për vitin 2023 do t'u lë prapë projekte të shumta në gjysmë, në formë gërmadhash dhe për më keq nuk do të kenë as edhe një projekt të ri kapital për investim, përjashtimisht në komunat që udhëheq partia e Lëvizjes Vetëvendosje? Çka t'u thuhet invalidëve, pensionistëve dhe të gjithë atyre të skemave sociale që buxheti për vitin 2023 nuk u ka ndryshuar gjendjen asgjë, sepse nuk u garanton rritje të pensioneve me ligj, por vetëm me vendime të përkohshme në formë lëmoshe? Çka t'u thuhet policëve, ushtarëve të FSK-së dhe të gjithë atyre që janë siguria e vendit që në buxhetin 2023 nuk u rregullon as gjendjen financiare, as sigurimin bazik në vendin e punës.

Pra, ju do të vazhdoni njëjtë me orare të tejzgjatura, me uniforma e veshmbathje të grisura dhe për gjynah. Çka t'u thuhet veteranëve e familjeve të dëshmorëve, që buxheti për vitin 2023 i gjen të nëpërkëmbur e me gjendje të rënduar psiko-sociale, me një pagë minimale shumica nuk mund as të ekzistojnë.

Pra, nuk ka ngritje të pagës së veteranit dhe kjo është për keqardhje. Çka t'u thuhet bujqve që buxheti për vitin 2023 nuk e ka prioritet bujkun dhe bazën e zhvillimit të shtetit. Pra, bujku i Kosovës do të përballet njëjtë me mungesë të subvencioneve qendrore, vonesë të subvencioneve dhe ndalesë të shumë projekteve kapitale në nivel lokal në kuadër të bujqësisë. Çka t'u thuhet personelit arsimor, mësuesve, profesorëve, që buxheti për vitin 2023 nuk ka linjë buxhetore për Ligj të pagave.

Pra, sistemi arsimor do të vazhdojë pa rritje të pagave dhe pa zgjidhje të kërkesave të të drejtave të tyre. Çka t'u thuhet ekonomive familjare dhe bizneseve të vogla që buxheti për vitin 2023 nuk parasheh ndonjë plan konkret dhe përkrahje financiare me qëllim që produktet dhe shërbimet e juaja të kenë tregun më të sigurt brenda dhe jashtë vendit. fatkeqësisht do të vazhdoni të funksiononi pa ndihmën institucionale.

Për fund, çka dhe si t'u thuhet qytetarëve të Kosovës mos e lëshoni vendin, sepse ju jeni prioritet i yni. Përgjigjja se me këtë projektbuxhet i dizajnuar me tendenca politike dhe linjë partiake, nuk mund ta ndalim trendin e ikjes për vitin 2023 në secilin qosh të Kosovës, prandaj edhe nuk mund dhe nuk duhet t'i gënjejnë qytetarët. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Mutlietnik, qëndrimin e jep kryetari i grupit, Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot po e trajtojmë një ndër projektligjet më të rëndësishme për vitin kalendarik, Projektbuxhetin e vitit 2023, projektbuxhet i cili parashihet të jetë buxhet më i lartë në historinë e Kosovës.

Si grup parlamentar kemi analizuar buxhetin dhe mund të theksojmë se buxheti është një buxhet i mirë për Kosovën dhe të gjitha komunitetet të cilat jetojnë në të. Është buxhet i mirëqenies sociale, buxhet i zhvillimit ekonomik, buxhet i sigurisë, i shëndetësisë, kulturës, rinisë e sportit, por edhe arsimit, fushë e cila është shtyllë shumë e rëndësishme për komunitetet joshumicë.

Në buxhet do të ketë rritje edhe në kategoritë e investimeve kapitale dhe infrastrukturore, të cilat janë të rëndësishme edhe për komunitetet joshumicë, të cilat jetojnë nëpër komuna të ndryshme. Natyrisht, edhe se jemi dakorduar edhe me ministrin e Financave dhe atë të Pushtetit Lokal, do të jenë përfitues komunitetet joshumicë, duke krijuar edhe një kod të veçantë për rindërtimin dhe rehabilitimin e shtëpive të komuniteteve joshumicë në komunat ku jetojnë ata.

Ne si grup parlamentar kërkojmë mbështetje dhe përkrahje edhe për bizneset e vogla të komuniteteve joshumicë, me një buxhet në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, duke shtuar buxhetin e ministrisë pikërisht për komunitetet joshumicës. Për të kryer ministria punën e balancuar ashtu si edhe e ka fushëveprimin, për mbështetje të komuniteteve joshumicë në plotësimin e zhvillimit ekonomik të tyre.

Si komunitete joshumicë, ne kërkojmë mbështetje edhe për nevojat e komuniteteve në çështjen e ujësjellësit, natyrisht për akumulimin e ujit, rrjetin dhe ndërmarrjen e ujit, sidomos në komunat ku jetojnë komunitetet turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, si në Komunën e Mamushës, Fushë Kosovë, Lipjan, Gadime, Prizren dhe Lubizhdë. Prandaj si grup parlamentar e mbështesim këtë projektbuxhet dhe amendamentet tona do t'i paraqesim në komision.

KRYETARI: Do të shkoj sipas radhës qysh jeni paraqitur, sepse grupet parlamentare nuk më kanë sjellë renditje të deputetëve, kështu që ashtu si thotë këtu monitori do të vazhdojmë me fjalën e deputetëve.

Fjalën ia japim deputetit Haki Abazi.

HAKI ABAZI: Ka platforma të ndryshme për të folur.

I nderuar zoti kryetar, faleminderit për fjalën!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Sigurisht që dita e diskutimit për buxhetin është ditë e rëndësishme dhe do të duhej që natyrisht të shënoheshin suksese të cilat paraqiten deri në këtë moment dhe prioritetet e vitit të ardhshëm.

Është moment shumë kompleks për vendin tonë. Natyrisht, me të gjitha zhvillimet që i kemi, kërcënimet e sigurisë, sabotimin që ka ndodhur në veri, vazhdon të ndodhë, heqjen prej institucioneve, largimin e Listës serbe. Po këto janë të gjitha të pritshme dhe natyrisht që në anën tjetër në interes të qytetarëve dhe të Republikës, unifikimi politik i spektrit politik është i domosdoshëm. Këtu edhe buxheti shënon pikërisht këtë moment, kjo është arsyeja pse edhe unë sot jam këtu. Realisht, përkundër faktit që edhe publikisht edhe hapur i kam shprehur pakënaqësitë e mia edhe për prioritetet, por edhe të themi sukseset e limituara në dikastere të ndryshme.

Natyrisht që opozita e ka detyrën e vet të kritikojë, po kjo nuk do të thotë që nuk ka hapësirë për diskutim e debat i cili është pjesë e demokracisë edhe i shëndetit të demokracisë. Unë dua në mënyrë të veçantë në këtë ditë disa çështje që do të duhej të ishin prioritet në ditët e muajt e vitet në vazhdim, sigurimi jetësor për policët e Kosovës. Njëzet vjet pas luftës, katërmëdhjetë vjet pas pavarësisë, është e pakuptimtë që shteti ynë të vazhdojë të ketë policë të cilët nuk kanë sigurim jetësor. Sikur të ishin policët e një shteti pa krim të organizuar, pa korrupsion të lartë, ndoshta edhe e kishin pasur komoditetin të besojmë që këta policë, prej atyre që duhet të bëjnë hetimet e deri te ata që duhet ta ruajnë sigurinë tonë, edhe të mos kenë probleme të tilla.

Ka shtete ku policët nuk mbajnë as armë për shkak se siguria e tyre nuk është në rrezik. Por, në një vend ku nëntoka, krimi i organizuar jo vetëm brenda shtetit, por në gjithë rajonin është kaq i madh, rreziku për policin tonë është i përditshëm dhe ne nuk mund ta anashkalojmë si problem, i cili është jashtëzakonisht i madh.

E dyta, janë kategoritë e njerëzve që e kanë bërë themelin e këtij shteti, minatorët të cilët janë futur në zgafelle për ta shkundur njëherë e përgjithmonë e Jugosllavisë, gjë që e kanë bërë, e dihet që shumica prej tyre jetojnë me 170 euro edhe sot kur po flasim.

Është e padrejtë që një minator i cili ka dhënë gjithçka prej vetes së tij për interesin e shtetit të marrë pagë më pak se një “shqiptar i ndershëm” që ka qëndruar në pushtet edhe në kohën e Milosheviqit dhe e ka arritur kushtin për pension të plotë. Atëherë, me ligj e në mënyrë urgjente duhet adresuar çështjen që ata njerëz të cilët kanë bërë më shumë se çdokush tjetër për ta nisur ose për ta vazhduar procesin për shtetbërjen, lirinë e pavarësinë e vendit tonë, të konsiderohen si kategori e veçantë në buxhetet e Kosovës.

E treta, e kam biseduar me ministrin e Financave, janë deputetët e 2 Korrikut, një numër i tyre ka vdekur, një numër i tyre ende është gjallë, një numër i tyre jeton në kushte të vështira, ata duhet

të bëhen kategori me ligj në Buxhetin e Kosovës, sepse janë njerëzit, po ashtu që kanë shënuar momentin më të rëndësishëm të deklarimit dhe artikulimit të qëllimeve të popullit tonë për liri dhe pavarësi.

Gjithashtu, dua të them që është fatkeqësi që po miratojmë buxhetin, nuk kemi strategji të energjisë së miratuar. Keq e ka lënë opozita, 20 vjet janë sjellë në rreth, duke na bërë që të jemi në krizë të përhershme për energjinë, vazhdojmë të jemi në situatë të njëjtë në çështjen e energjisë. Viti i ardhshëm nuk duhet të na gjejë në këtë gjendje. Viti i ardhshëm duhet të ketë qartësi të plotë për masat dhe programin nacional për efikasitet, sepse kemi humbje shumë të mëdha edhe në shfrytëzim edhe në shpërndarje.

Duhet ta kalojmë kornizë ligjore të plotë për diversifikimin e energjisë, sidomos për kapacitetet nga energjitë e ripërtëritshme. Nuk ka kuptim që Kosova të mos ketë panele solare në çdo shtëpi, në çdo zonë komunitare, në çdo vend ku është e mundur që përfitojmë nga energjia e diellit dhe energjia e erës.

Nuk mund të flasim për ndryshime klimatike e të shtyjmë përpara projekte që bëjnë kapacitete të reja nga qymyri. Është hipokrizi nëse flasim për qymyr e në të njëjtën kohë nuk bëjmë asgjë për të marrë energjinë e rinovueshme, e cila është përbrenda Agjendës së Gjelbër, përbrenda ambicieve politike për integrim evropian, përbrenda përkushtimeve dhe zotimeve të vendit tonë.

Dhe e fundit, mendoj që jemi të vonuar, por buxheti duhet të parasheh reformë të thellë të administratës, sepse po vazhdojmë që qytetari të jetë lypsar para institucioneve për çdo shërbim. Kemi një administratë jofunksionale, të mbingarkuar e cila nuk e ka kthyer shërbimin e vet në shërbim të qytetarit, është e kundërta, qytetarët tanë në të gjitha nivelet vazhdojnë të jenë lypsarë nëpër sportele, presin përgjigje me javë e muaj të tërë për të drejtat e tyre, përfshirë edhe dokumentet e identifikimit dhe pasaportat.

Mendoj që ka ardhur koha të mos kemi më justifikime pse nuk kemi tenderë, pse nuk kontrata për prodhimin e dokumenteve dhe ofrimin e shërbimeve të shpejta. As një njëri i administratës nuk duhet lejuar më që ta bëjë qytetarin lypsar, duhet të jetë e kundërta. Duhet ta ndërtojmë kulturën që shteti, institucioni, punëtori i administratës është shërbëtor i qytetarit. Përndryshe, do të vazhdojmë që njerëzit të jenë të dëshpëruar me idenë se si funksionin institucioni për të. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Rashit Qalaj.

**RASHIT QALAJ:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuara media,

Të dashur qytetarë,

Sot, po diskutojmë për projekt-buxhetin e vitit 2023, të cilin e ka sjellë Qeveria, në të cilin është plani i të hyrave dhe shpenzime të buxhetit për vitin ardhshëm. Partia Demokratike e Kosovës dhe në një konferencë për media ka dhënë një qëndrim në lidhje me këtë projekt-buxhet, duke theksuar se projekt-buxheti në asnjë mënyrë nuk tregon se si Qeveria e Kosovës do t'i përgjigjet sfidave të reja në ekonomi, por pasqyron vetëm një vazhdimësi të vitit aktual, vit ky kur qytetarët e Kosovës u varfëruan dhe ekonomia e vendit regjistroi një ngadalësim drastik të rritjes.

Mirëpo, atë që ne e kemi vërejtur në këtë projekt-buxhet, kemi vërejtur edhe tendencën e Qeverisë që të cenojë funksionim e pushteteve lokale. Qeveria e Kosovës gjatë hartimit të Ligjit për buxhetin e vitit 2023, ka ndërhyrë në pjesën tekstuale të ligjit dhe me këtë cenon pavarësinë e financave të komunave. Më saktësisht, te neni 9 i Ligjit të buxhetit 2023, paragrafi 6, është shtuar heshturazi pasuesi i fundit, ku thuhet: “Të gjitha të hyrat vetjake të mbledhura para vitit fiskal 2022, dhe të pashpenzuara bëhen pjesë e Fondit të Kosovës në bilancin bankar”. Me këtë po tentohet që komunave t’iu merren të hyrat vetjake të pashpenzuara.

Të nderuar deputetë,

Unë kam marrë një letër nga Asociacioni i Komunave dhe në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës po kërkoj që të hiqet ky pasues, sepse është në kundërshtim me Ligjin e financave lokale dhe përgjegjësitë, e po ashtu edhe me Ligjin e financave të pushtetit lokal.

Pavarësinë financiar komunitat e kanë të rregulluar dhe kërkojmë që të mos ketë ndërhyrje nga niveli qendror.

Të nderuar deputetë,

Po ashtu në këtë projektligj shihen edhe favorizimet që Qeveria ua bën komunave të cilat udhëhiqen nga kryetarët e subjektit politik të Vetëvendosjes, ndërsa ato të tjerat të cilat udhëhiqen nga kryetarët e subjekteve të tjera, janë mjaft shumë të diskriminuara.

Është në rregull dhe pajtohem plotësisht që edhe komunitat që qytetarët e komunave siç është Shtimja e disa të tjera për shembull, meritojnë dhe duhet të kenë buxhet, absolutisht pajtohem, mirëpo nuk pajtohem që qytetarët të cilët gjatë votave të tyre kanë pasur mendim ndryshe, të diskriminohen me buxhetin e tri viteve të ardhshme.

Nëse e bëjmë një krahasim mes qytetit të Ferizajt me 108 mijë e 610 banorë dhe me 345 km katrorë dhe për shembull, me qytetin e Shtimes me 27 mijë e 324 banorë dhe 134 km katrorë, do të shohim që buxheti i ndarë për tre vitet e ardhshme për Ferizajn me katër herë popullsi më të madhe se Shtimja është më e vogël, nëse këtu nuk e llogarisim buxhetin e ndarë për spitalin

rajonat. Nuk e llogarisim për spitalin rajonal, meqenëse spitali rajonal që përfshinë edhe komunat të tjera. Ndërsa, investimet për Komunën e Shtimes janë më shumë se 20 milionë.

Dhe, po ashtu disa projekte në Komunën e Ferizajt, që po i lexoj disa prej tyre, më duket që ka të ndarë buxhet shumë pak në raport me nevojat që janë. Për shembull, e keni ndërtimin e stadiumit të qytetit në Ferizaj, ku në vitin e parë apo në vitin 2023 parashihen që të investohen 200 mijë euro, ndërsa janë paraparë vetëm 1 mijë për vitin 2024 dhe po ashtu 1 mijë euro për vitin 2025. Kjo është qesharake, dhe çfarë kuptimi ka.

Po ashtu kemi projekte të tjera në Ferizaj, të cilat kanë një rëndësi shumë të madhe, mirëpo është paraparë buxhet shumë i vogël. Për shembull, ndërtimi i nënkalimit për vetura në Ferizaj, vetëm në këtë vit, pra në vitin 2023 janë paraparë 47 mijë e 615 euro, ndërsa në vitin 2024 dhe 2025, zero euro.

Po ashtu kemi disa projekte të tjera të cilat nuk do t'i përmendi, mirëpo mendoj që Ferizaj meriton që të ketë buxhet më shumë, dhe paramendojeni, për këto tri vitet e ardhshme e ka vetëm një projekt të ri, dhe atë për ndërtimin e një rruge që është në fshatin Zllatar të Ferizajt.

Ndërsa, Ferizaj ka shumë nevojë për rregullimin e Tregut të Gjellbër, për shembull, që kërkon një vlerë dikur 1 milion e gjysmë, dhe po ashtu rregullimin e një rruge që lidh disa fshatra dhe zgjerimin e disa rrugëve, siç janë fshatrat: Cërnillë, Mirash, Babush.

Nëse e bëjmë krahasim e njëjtë me Komunën e Lipjanit, dhe të mos harrojmë që Komunën e Lipjanit e udhëheqë kryetari i cili nuk është nga subjekti im, kisha pasur dëshirë shumë që Komunën e Lipjanit ta udhëheqë një kryetar nga Partia Demokratike, mirëpo qytetarët kanë menduar ndryshe, dhe është një kryetar, i cili edhe tri vitet e ardhshme është edhe kryetar im, dhe nëse e bëjmë krahasimin me investime në Komunën e Shtimes, atëherë me të vërtet del që ky krahasim është i tmerrshëm. Pra, Lipjani ka 57 mijë e 605 banorë me 338 km katrorë, ndërsa investimet që i ka paraparë Qeveria në këtë rast, janë më pak se 3 milionë, pra 2 milionë e 930 mijë e 670 euro, ndërsa, prapë po e përsëris, në Komunën e Shtimes mbi 20 milionë.

A thua banorët e Lipjanit nuk paskan nevojë për çerdhe, nuk paskan nevojë për rrugë, nuk paskan nevojë për ndërtimin e një qendre të mjekësisë familjare, e nuk paska nevoja të tjera. Dhe, shtrohet pyetja, pse është kështu? Për mua kisha pasur shumë dëshirë që kryeministër i vendit të jetë dikush nga Partia Demokratike, mirëpo ja që populli i Kosovës ka votuar ndryshe, ka menduar ndryshe, edhe e kemi kryeministër zotin Kurti, i cili përderisa është në këtë detyrë është e kryeministri im, mirëpo kjo nuk do të thotë që ne tash duhet të aprovojmë buxhete, të parashikojmë buxhete në bazë të partive politike.



Të mos harrojmë që Lipjani për tre vjetët e ardhshme ka zero projekte. Pra, asnjë projekt të vetëm, ndërsa nuk ka asnjë projekt për vitin 2025. Njëjtë nuk ka asnjë projekt të ri për Kaçaniku, ndërsa Kaçaniku ka nevoja mjaft të mëdha.

Kërkesat që i ka bërë zyrtarisht kryetari i Kaçanikut, janë kërkesa të cilat mendoj që janë të arsyeshme dhe është dashur të merren parasysh. Ka bërë një kërkesë për një shkollë në Kaçanik, shkollën “Emin Duraku”, dhe po ashtu ndërtimin e fabrikës për trajtimin e ujit të pijes në Dubravë, pastaj ndërtimin e kolektorit kryesor të rrjetit të kanalizimit Gërlicë - Guri i Shpuar, e kështu me radhë. Mirëpo, jo.

Projektet në komunat ku nuk udhëhiqen nga Vetëvendosja janë shumë të vogla apo vetëm sa për të thënë.

Ne kemi kërkesat në Viti. Vitia ka nevojë shumë që të ketë qasje në autostradë në fshatin Gërlicë, mirëpo prapë nuk kemi asgjë. Po ashtu ka nevojë Vitia edhe për një shkollë fillore “Dëshmorët e 5 prillit”, ku i ka mbi 500 nxënës, po prapë nuk janë paraparë në këtë buxhet.

Prandaj, të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Mendoj që hartimi i buxhetit duhet të jetë për të mirën e popullit të Kosovës dhe duhet të shërbejë vetëm për popullin e Kosovës, po jo për partitë politike, jo për teke e partive politike, por duhet të shërbejë njëjtë, kuptohet, varësisht prej madhësive që kanë komunat, varësisht prej numrit të banorëve, ky buxhet duhet të jetë i shpërndarë, mirëpo besoj që në pjesën e dytë do të bëjmë shumë amendamente për shkak se jemi të pakënaqur me shpërndarjen e buxhetit, sidomos për këto komuna.

Po ashtu, kolegu paraprak e përmendi nevojën për çështjen e policisë. Në këtë projektligj nuk është e paraparë fare çështja e pensionimit të parakohshëm të pjesëtarëve të policisë që kemi folur shumë herë nevojat dhe arsyen pse duhet të jetë ky pensionim. Bile sot na u bojkotua nga kolegët e Vetëvendosjes edhe komisioni, nuk erdhi askush, duke thënë që jemi duke u përgatitur për këtë buxhet. Sot, në komision e kishin Ligjin për pensionim të parakohshëm, por mbledhja dështoi për shkak të mungesës së deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje.

Normalisht, që pajtohem që kanë nevojë edhe për sigurim jetësor edhe sigurim shëndetësor. Në këto momente të gjithë, sidomos në këto momente të situatës në veri, të gjithë e kemi gojën plotë polici, të gjithë e kemi gojën plotë se si dhe a duhet t’ua përmbushim kërkesat, nevojat që i kanë, mirëpo në realitet në buxhet, këtu shihet.

Dhe, këto nevoja as që përmenden fare. Janë disa për blerje të disa pajisjeve, mirëpo po flasim për mirëqenien e policëve, të cilët prapë janë anashkaluar sikurse në të kaluarën, sikurse tash dhe nuk po shoh ndonjë ndryshim që besoj që duhet të ketë gjithsesi, për shkak se është koha që të bëhet trajtimi i duhur me anën e Ligjit të buxhetit edhe Ligji për pensionin për parakohshëm, por edhe nevoja për sigurim jetësor e shëndetësor, e kështu me radhë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të vendit,

Sot, kur po e shqyrtojmë në lexim të parë projekt-buxhetin, Projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2023, ajo që na bie në sy, është që ky është buxheti më jotransparent ndonjëherë që ka ardhur në historinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe këtë e them duke e pasur parasysh faktin që plotë 271 milionë euro janë të ndara në Ministrinë e Financave dhe Transfereve, si kontigjenca dhe fonde për ringjallje ekonomike.

Domethënë, plot 271 milionë euro fonde pa projekte, pa plan, vetëm që janë aty në rast se dështojnë ministritë e linjës, atëherë ministri i Financave brena dy minutave mund të marrë vendim për të shpërndarë qindra-miliona euro taksa të qytetarëve pothuajse pa fare kritere, siç e ka bërë gjatë këtij viti.

271 milionë të pa alokuara tregojnë për mungesën e kapaciteteve, mungesën e vizionit dhe planit në secilin sektor të kësaj Qeverie. Si ka mundësi që në disa ministri që në portofolion e tyre kanë sektorë të ekonomisë, dhe të njëjtat nuk e kanë asnjë plan, asnjë projekt, por fondet për ringjallje janë te Ministria e Financave dhe Transfereve. Fondet e ringjalljes janë plotë 144 milionë, ndërsa kontigjencat kapin shumë prej mbi 120 milionë.

Nëse e marrim parasysh këtu edhe kontigjencën për energji, atëherë fondet e pashpërndara për të cilat ne nuk e dimë se do të shpenzohen gjatë vitit 2023, janë plotë 346 milionë euro.

Ky buxhet nuk adreson nevojat e qytetarëve të vendit dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet vendi. Nuk është paraparë buxhet për rritjen e pagave. Kemi vetëm 11%, dhe nëse e shohim vjetor financiar, raportin 9 mujor për këtë vit, ne e shohim se janë plotë 8 mijë pozita në administratën publike, të cilat janë të buxhetuara dhe të paplotësuar. Kështu që, të njëjtat janë përcjellë edhe në vitin tjetër, dhe ky buxhet nuk mjafton për ndonjë rritje eventuale të pagave.

Edhe një herë po jua bëj me dije se pagat në sektorin publik nuk kanë lëvizur që nga viti 2016.

Sot, ju duhet të na tregoni pse nuk e përcillni në Kuvend Ligjin e pagave, meqenëse është kryer konsultimi publik, apo dëshironi që fillimisht ta kaloni buxhetin dhe më vonë ta justifikoni atë nenin e famshëm, i cili thotë që Ligji pagave hyn në fuqi 8 muaj pas publikimit në Gazetë Zyrtare.

A mundeni ju shumica sot, të na informoni neve dhe qytetarët e vendi se çka po ndodhë me Ligjin për pagën minimale? Ai ligj ka kaluar në lexim të parë më 13 maj të këtij viti. Domethënë, më shumë se 6 muaj më parë.

Deklaratat e qeveritareve dhe mazhorancës nuk po u hynë në punë qytetarëve, se ata sot po përballen me çmimet më të larta që nga koha e pasluftës. Sot, mijëra familje janë në varfëri. Pandemia padyshim se ka ndikim, por edhe kriza me çmime po ndikon tej mase.

Ju kur flisni për lulëzim ekonomik, duhet ta dini që situata nuk qëndron ashtu. Unë po e citoj raportin vjetor të UNICEF-it, i cili është publikuar në prill të vitit 2022 dhe flet për vitin 2021, atëherë kur rritja ekonomike në vend ishte 10.75%.

UNICEF thotë se Kosova mbetet një nga vendet më të varfra në Evropë me rreth me 23% të popullsisë që jeton në varfri, bruto produkti i Kosovës për kokë të banorit është vetëm ¼ e mesatares së Bashkimit Evropian. Kosova harxhon vetëm 8.5% për mbrojtje sociale krahasuar me mesataren prej 25% të vendeve të BE-së. Si rezultat qasje e fëmijëve në shërbime shëndetësore, arsim dhe shërbime të tjera sociale mbetet e kufizuar, veçanërisht për grupet e margjinalizuara.

Fëmijët nga komunitetet: rom, ashkalinj dhe egjiptian, në veçanti janë të nënshërbyer, e gjithashtu edhe ata me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në zona rurale. Këtë nuk e themi ne opozita, këtë e thotë raporti vjetor i UNICEF-it.

Dhe, unë e potencova këtë për të treguar se ky buxhet nuk i adreson sfidat e tilla. Duhet ta potencojmë se rritja e çmimeve ka kaluar nivelet 50% për karburantet dhe shportën bazë të konsumatorit dhe kjo është shndërruar në fatbardhësi për Qeverinë, sepse e ka mbushur buxhetin.

Ky buxhet është buxhet politik, u përmend edhe më herët. Shpërndarja e projekteve kapitale nëpër komuna nga ministritë e linjës është komplet politike. Komunitat që Vetëvendosje nuk ka mundur t'i marrë me votë, tani po mundohet që t'i mundë me buxhet.

Po jua jap një shembull, u përmend edhe më herët nga parafolësi; 7.5 milionë janë të ndara nga ministritë e linjës si investime kapitale për Komunën e Shtimes, derisa po nga këto ministri janë vetëm 1,9 milion investime kapitale për Komunën e Lipjanit.

Ne nuk jemi kundër që po investohet në Komunën e Shtimes, por jemi që nga 271 milionë sa rrinë të pa alokuara në Ministrinë e Financave, të alokohen dhe të investohet edhe në komunat e tjera, sepse qytetarët janë taksapagues të këtij vendi, të cilët e mbushin këtë buxhet që Qeveria po e quan më të madhin në histori, e po harron që nga shpallja e pavarësisë ka qenë më i madhi në histori, duke u krahasuar me të gjitha vitet paraprake.

Raste të tilla ka gjithandej. Kryetari i Komunës së Dragashit pohon se për projektin për ujin e pijshëm i ka ndarë 500 mijë euro. Është një projekt që ka filluar nga viti 2012, dhe i ka kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës që edhe ajo t'i ndajë 500 mijë. Sot, fatkeqësisht ato mjete nuk janë të ndara në Projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2023.

Do të thotë, në kohën kur 7.5 milionë i ndahen Komunës së Shtimes, në kohën kur Ministria e Financave dhe Transfere i ka 271 milionë të paspërndara, ne i kemi 15 fshatra në Komunën e Dragashit, të cilat nuk kanë qasje në ujë të pijes. Dhe po, është keq që nuk është bërë deri më tani, por është shumë keq që nuk po bëhet edhe tani, kur siç po thoni, e keni buxhetin më të madhin në histori dhe i keni rreth 300 milionë mjete të paspërndara.

Dua edhe njëherë të potencoj se me këtë ligj, ju e keni kontrabanduar një fjali, e cila është në kundërshtim me dy ligje të tjera, me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Ligjin e financave të pushtetit lokal.

Fjalja e fundit e paragrafit 6, të nenit 9, thotë: “Të hyrat vetjake të mbledhura për vitin fiskal 2022, dhe të paspënzura bëhen pjesë e Fondit të Kosovës në bilancin bankar”, e kjo bëhet në mënyrë që ju pastaj t'i shpërndari ashtu siç dëshironi. Këtë nuk do ta lejojmë.

Në qoftë se ju nuk e pranoni si amendament tonin, ne sapo të votohet ky ligj, do ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese, sepse është në kundërshtim të drejtpërdrejt me këto dy ligje të cilat i potencova.

Kur jemi te energjia, lexova dikur që kryeministri në Forumin Ekonomik të Vjenës ka thënë që pritet që në Kosovë të investohen 4.5 miliardë euro në energji të ripërtëritshme deri në vitin 2030. Zoti kryeministër, nëse e shihni buxhetin nuk ka as edhe 1 euro të parapara për ngritjen e kapaciteteve energjetike, bile për më tepër, u theksua edhe më herët, 75 milionë euro që pritet të vijnë nga IPA janë të alokuara te Ministria e Financave dhe jo te ministria e linjës.

Të nderuar qytetarë,

Mungesa e planifikimit që të zotohen dhe të përfundojnë projekte konkrete, është prezentë në këtë projekt-buxhet, projekte të cilat do të ndikonin në rritjen e kualitetit të jetës së qytetarëve.

Nëse dëshironi të bëni ringjallje ekonomike do të duhej që ministritë e linjës t'i kenë planet dhe t'i paraqesin ato te Ministria e Financave, gjithashtu t'i parashohin buxhetet. Kur flasim për rritje të buxhetit në sektorë të caktuar, unë duhet të ndalem vetëm për pak te buxheti për arsimin. Jua bëj me dije që në terma nominal edhe ka ngritjes, sepse është rritur buxheti i arsimit nga 72 milionë në 82 milionë, por nëse i shohim shifrat korrekt, e shohim se në vitin 2022 ka qenë, nëse përfshimë edhe grantin për arsim që u është shpërndarë komunave, 9,8% e buxhetit ka qenë e ndarë, domethënë në vitin aktual për arsim, ose 3,2% e GDP-së.

Në vitin 2023 kemi rënie, është vetëm 8,8% e buxhetit dhe 2,9 e GDP-së. Andaj, ju lutem shumë të mos manipuloni me numra.

Nëse e shohim vetëm buxhetin e MASHTI-it, atëherë nuk ka rritje. Kjo rritja prej 10 milionëve, e amortizon rritjen e buxhetit në tërësi. Nuk ka buxhet për reforma strukturore në arsim, nuk ka projekt dhe nuk ka buxhet për riorganizimin e rrjetit të shkollave edhe gjithashtu nuk ka buxhet për Fondin shëndetësor.

Sot, unë besoj që edhe çështjen e policëve e të shumë kategorive të tjera, po edhe duke përfshirë të gjithë qytetarët, ne do ta rregullonim sikur të kishte vullnet nga kjo Qeveri që fondet e alokuara të ndaheshin dhe të shkonin në zhvillimin e fondit shëndetësor dhe t'i kemi një herë e përgjithmonë të rregulluara çështjet në shëndetësi...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia shtoni një pjesë të kohës fjalës së deputetes Bajrami.

**HYKMETE BAJRAMI:** Të nderuar kolegë deputetë,

Po, në terma nominalë, në shumicën prej organizatave buxhetore ka rritje të buxhetit, por ne me të vërtetë duhet ta shikojmë në prizmin e asaj se sa keni arritur të realizoni buxhetin e këtij viti. Për shembull, Ministria e Financave në nëntëmujorin e parë ka arritur të realizojë vetëm 6% të investimeve kapitale, Ministria e Bujqësisë 29%, Ministria e Ndërmarrësisë 5%, Ministria e Infrastrukturës 27%, Ministria e Arsimit, Shkencës vetëm 20%, Ministria për Komunitete dhe Kthim qëndron më mirë, është 39%, Ministria e Pushtetit Lokal vetëm 1% dhe nëse e shohim raportin nëntëmujor të shpenzimeve kapitale për vitin 2022, 1 530 projekte janë me zero shpenzime kapitale, kaq për sa mund të...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Ministra të nderuar,

Po e përshëndes në emër të gjithë juve Vasfijen Krasniqi-Goodman, e cila po na viziton, është kthyer nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është pjesë e kësaj seance. Vasfije, faleminderit që ke ardhur!

*(Duartrokitje)*

Gjithmonë je e mirëseardhur në Kosovë, po veçanërisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku shërbeve si deputete deri para kohësh dhe të falënderojmë sinqerisht për aktivizmin tënd shumë të guximshëm që i ka dhënë kaq forcë të madhe morale popullit tonë.

Ia japim fjalën deputetit Bekë Berisha,

**BEKË BERISHA:** Faleminderit, kryetar!

Deputetë të nderuar,

E përshëndes edhe unë Vasfijen,

Lidhur me projektbuxhetin për vitin 2023 po i them disa fjalë për sektorin e sigurisë.

Ne po themi që është rritur buxheti për këtë sektor, por ku është efekti i këtij buxheti.

Pyetni pjesëtarët e FSK-së, të Policisë së Kosovës, zjarrfikësit si i kanë kushtet e shërbimit, transportin, ushqimin dhe pajisjet. Ndër të tjera, plot pjesëtarë të FSK-së, plot pjesëtarë të Policisë e kanë lëshuar vendin e punës për shkak të gjendjes ekonomike.

Pagat e mjeruara dhe tërë këto kanë bërë që shumë pjesëtarë të Policisë së FSK-së të braktisin vendet e punës, po ashtu edhe pjesëtarë të Policisë. Si në shumë projekte e veprime të tjera, të cilat janë premtuara që janë fiktive, edhe ky projektbuxhet po del të jetë ashtu.

Shikoni vendet e rajonit se si veprojnë dhe si i rritin pagat për ushtrinë e vet.

E keni gjetur ilaçin ju Ligji i pagave, jo jem duke u konsultuar, jo ashtu e nuk po ndodh asgjë, as nuk dimë me kë po konsultoheni.

Si është gjendja e policisë? Moshë, pse nuk e keni paraparë pensionimin e pjesëtarëve të Policisë, e cila sot ka një numër të madh të zyrtarëve që pamundëson kryerjen efektive të punës. Sot pjesëtarët apo deputetët të pushtetit, pos Fatmir Humollit, na e kanë bojkotuar mbledhjen e komisionit pikërisht për këtë çështje.

Po tashmë është e qartë se do të vijoni me skema sociale duke shpërndarë disa ndihma pa efekt që sigurisht se Ligjin e pagave, pensionet e policisë, sigurimet shëndetësore do t'i projektoni për vitin 2024 për efekt ndoshta elektoral.

Tash, të flasim kështu krejt shqip, Ministria e Punëve të Brendshme apo Policia diferencën e ka 4,7 të buxhetit, domethënë nuk ka rritje fare apo ka më pak se herën e kaluar, domethënë është zbritje.

Rritja për Ministrinë e Mbrojtjes që po trumbetohet që është një rritje kush e di se çfarë e madhe, kemi të bëjmë me 20 milionë, e që në kushte të inflacionit, edhe këtu nuk ka asgjë hiç, është ajo që ka qenë edhe atëherë.

Veriu momentalisht është në kaos, në vakum institucional, tani që po flasim tek është sulmuar një gazetar, i cili ka qenë duke incizuar disa kriminelë duke kidnapuar një qytetar tjetër shqiptar, domethënë kjo është gjendja e sigurisë atje. Kur të flasim për sigurinë, për Mitrovicën, nuk duhet harruar se ne kufizohemi 360 kilometra me Serbinë.

Edhe integriteti territorial shkelet për çdo ditë me kilometra nga xhandarmëria serbe. Po t'u dëgjohen fjalët juve, ta merr mendja kush e di çfarë doni të bëni. Qëndrimet e kryeministrit që iku, qëndrimet e tij kryeforta, ndoshta i kishte arsyetuar një buxhet prej një miliardëve ta kishte ndarë tash. Unë e di që s'vjen puna të bëhem kryeministër, se duhet pasur do elemente qysh i keni ju do të tjerë këtu, mirëpo unë i kisha ndarë në këtë situatë një miliard për sigurinë e për ushtrinë. Kështu që të mos na mbani pallavra shumë as për ngritje, as për sigurinë, as për sovranitetin, as për integritetin, as për kurrgjë.

Ti që po qesh ndoshta do të bëhesh kryeministër shpejt. Faleminderit.

**KRYETARI:** Kurrë mos u dorëzo, Bekë, se e keni pasur kryeministrin dy herë.

Fjalën ia japim deputetit Jahja Kokaj.

**JAHJA KOKAJ:** Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Kolegë,

Qytetarë të nderuar,

Me kënaqësi do të votoj projektbuxhetin, të cilin e kemi përpara, por dua t'i them disa fjalë, të cilat ndoshta tingëllojnë si të reja, ndoshta tingëllojnë pak më ndryshe.

Dua të filloj pikërisht nga komentet e zotit Enis Kervan, të cilat i përcolla me shumë respekt dhe më gëzoi fakti që ekziston një investim buxhetor, planifikim buxhetor për pjesën e pakicave joshumicë për qytetarët e Kosovës.

Në këtë kontest konsideroj që duhet të ekzistojë edhe një tjetër diskriminim pozitiv ndoshta me qëllim të zhvillimit harmonik të regjioneve të Kosovës, që të jem më i qartë, të mos jetë vetëm zhvillimi në Prishtinë, të cilin e dua shumë, por të jetë edhe në regjionet e pazhvilluara.

Unë vij nga Gjakova, kjo ka qenë domethënë, pse të mos e themi që me mija hektarë plantazhe të vreshtave, fabrika e pijeve ka qenë e njohur me produkte të saj jo vetëm në tërë Jugosllavinë e atëhershme, por edhe në Evropë. Ka pasur diku rreth ashtu 11 industri, fabrika të ndryshme, të cilat kanë absorbuar, kanë punësuar jo vetëm të gjithë qytetarët e Gjakovës, por edhe të regjioneve të tjera të Kosovës dhe më larg.

Kurse sot, meqë për çdo ditë udhëtoj prej atje, shoh një varfëri të tejskajshme, shoh një zbehje, një tkurrje të qytetit jo vetëm në kuptimin vizual e ekonomik, por edhe në kuptimin shumë të veçantë emocional.

Qytetarët kanë një krenari të çuditshme dhe ata nuk qajnë e nuk ankohen, po me të vërtetë jetojnë në një gjendje shumë të vështirë ekonomike, gjendje shumë të vështirë ekonomike, të cilën si duket në 30 vjet e kaluara ata të cilët i kanë përfaqësuar nuk e kanë ngritur zërin ashtu siç duhet këtu në këtë Parlament ose në këto ambiente, ku vendoset për buxhet apo ku vendoset për fatin e qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, unë sot kam ardhur këtu duke lexuar këtë buxhet dhe ta ngre zërin e atyre të cilët flasin me zë të heshtur, por këta që kanë krenari shumë të thellë, të cilët shesin shtëpi dhe në qoftë se shkoni në Gjakovë në çdo 10-15 metra shihni ‘shtëpitë në shitje’. A e dini pse i shesin? I shesin për të blerë një banesë shumë të vogël dhe me pjesën e mbetur të mbijetojnë aq sa jetojnë deri në momentin e fundit të jetës së tyre.

Duke mos vazhduar vajtimin edhe duke mos vazhduar kritikën, në radhë të parë, në radhë të parë përfaqësuesve gjakovarë që 30 vjet kanë qenë në këto banka, kanë qenë nëpër vendet udhëheqëse edhe në Gjakovë, edhe këtu, po Gjakova ka gjeneruar, domethënë në Gjakovë është krijuar një realitet i cili me plot gojën e them në kuptimin ekonomik, jetësor, emocional është i shumë i dobët, që mos të them i mjerueshëm.

Në qoftë se shohim, bie fjala Universitetin “Fehmi Agani”, i cili ishte vazhdimësi e aktivitetit apo çerdhes intelektuale shkencore, arsimore, e cila ndriçonte jo vetëm Kosovën, po edhe më larg, sot aty tkurren, sikurse edhe në tërë territorin e Gjakovës, tkurren departamentet, tkurret potenciali shkencor, i cili po thuajse nuk ekziston fare në kuptimin e meteorologjisë apo laboratorëve, tkurret çdo gjë dhe shkon kah thjeshtimi apo eliminimi.

Kërkoj apo propozoj që në frymën e drejtësisë apo në frymën e parlamentarizmit, fundi i fundit, që të ekzistojë një iniciativë për zhvillimin harmonik regjional të Kosovës, pra për komunat të



cilat nuk janë të zhvilluara të jetë një injeksion i caktuar, me qëllim që të bëhet një zhvillim harmonik.

Dhe, në fund të mendimit tim lidhur me buxhetin, për të cilën mora guximin të flas, ndonëse nuk kam kompetencë ekonomike profesionale financiare që të flas, por dua ta them edhe një fakt, i cili është i lidhur me investimet për inovacion dhe teknologji.

Kam dëshirë që të shoh një përqindje të caktuar, e cila dedikohet pikërisht në zhvillimin e inovacionit dhe mendimit kreativ shkencor, për të cilin kanë shkruar tetë qytetarë, të cilët merren me hulumtime, që ta ngre zërin e tyre këtu në Parlament dhe të mendohet për investime pak më të avancuara, pra investime buxhetore për inovacionet dhe për hulumtimet shkencore që të formohen qendra për ekselencë, ku do të gjenerohen mundësitë meteorologjike, laboratorike, meqenëse nuk ekzistojnë fare, po thuajse fare në territorin e Kosovës.

Me kënaqësi të veçantë do ta votoj këtë buxhet, sipas mendimit tim për ndryshe është shumë qëllimplotë, shumë i mençur e profesional, por që shpresoj që këto brengosje të qytetarëve të heshtur, por krenarë të Gjakovës, do të respektohen dhe do të realizohen. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash fjalën ia japim deputetit Hajdar Beqa.

**HAJDAR BEQA:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kabinet qeveritar,

Dita kur diskutohet për buxhetin e Republikës së Kosovës, e aq më shumë për kohën të cilën po kalojnë qytetarët, sfidat të cilat po i përballojnë sa i përket rritjes së çmimit, përballimit me një ekonomi të tkurrur, me një varfëri të madhe, është shumë e rëndësishme dhe mendoj që ne këtu duhet të jemi të qartë çka ndryshon jeta e qytetarëve me këtë buxhet për vitin 2023.

Nëse kthehem retroaktivisht, një vit më herët kryeministri aktual, zoti Kurti, ka qenë shumë entuziast në atë prezantimin e atij buxheti dhe një farë forme ka qenë një premtim shumë ambicioz, po nëse shikojmë tani pas një viti dhe e krahasojmë buxhetin e vitit 2023 me buxhetin e vitit të kaluar, i bie që Qeveria e Republikës së Kosovës e ka përsëritur vitin, nuk ka arritur të avancoj asgjë në vend, nuk ka arritur ta përcjellë inflacionin, nuk ka arritur të rritë pagat apo të kalojë Ligjin e pagave dhe në raport me ato premtime që kanë qenë, nuk ka arritur të instalojë ndonjë zhvillim ekonomik, po as fondin sovran, të cilin e kishte premtuar gjatë gjithë fushatës, nuk ka arritur të kemi as sigurime shëndetësore, nuk kemi premtime që do të kemi as për vitin e ardhshëm sigurime shëndetësore.

Projektet të cilat janë duke u zhvilluar nga parapandemia në Republikën e Kosovës pothuajse janë aty ku kanë qenë, për shembull kemi probleme edhe pse disa nga projektet që janë me

donacion a janë me kredi, kemi probleme ende lidhjen e Prishtinës me Gjilanin, qytetarët e asaj treve e kanë merituar që kjo rrugë të shkojë me një efikasitet më të shpejtë.

Kemi problem lidhja Prishtinë me Mitrovicë, lidhjen e Prishtinës me Podujevës, e kemi lidhjen e Prishtinës me Pejë dhe me Gjakovën, rruga Dollc - Klinë - Gjakovë dhe të gjitha këto projekte njëfarë forme janë të neglizhuar. Nëse shikojmë edhe analizën e buxhetit, e cila u bë nga Zyra e Kuvendit, kemi diku mbi 90% apo respektivisht 91,38% i kemi projektet kapitale për vitin e ardhshëm nga niveli qendror janë të përsëritura që i bie 8,62% janë projekte të reja. Ku kemi mundësi për zhvillim ekonomik, nga gjithsej projektet kapitale, për shembull, nëse i marrim vlerë monetare janë 594,4 milionë euro janë gjithsej, kurse 543,2 milionë janë borxhe ose projekte të bartura.

Unë kam parë për secilën komunë veç e veç, u tha edhe nga disa parafolës, ndoshta Qeveria në njëfarë forme në ato 2-3 komunat që i ka, që realisht meritojnë edhe ata qytetarë të përkrahen, ka mundur ta reflektojë përmes buxhetit njëfarë lloj simpatie, po unë jam ndalur edhe në komunën të cilës i përkas, edhe pse me amendamentin në buxhetin paraprak edhe në rishikim kemi parë se ura e Rugovës, ku lidhet pjesa e Hasit me Rahovecin dhe Gjakovën, po edhe me Prizrenin, ende nuk ka arritur aty të bëhet asnjë veprim dhe tani me prishjen e kohës, me të reshurat atmosferike, ata qytetarë e kanë të pamundshme ta shfrytëzojnë atë urë.

S'po flas për projekte të tjera që kanë nisur ndoshta pra 3-4 qeverive, ende s'kanë arritur të përfundojnë, si Pallati i Kulturës në Rugovë, po ndalem në atë pjesë. E kemi edhe problemin që është ndalur shkolla në Demjan është mbetur në gjysmë, nuk e dimë edhe arsyen pse. Është vendosur një gurthemel te shkolla e Ponashecit, e cila është një shkollë që është më e vjetra në rajon dhe është e rrezikshme që nxënësit të vazhdojnë mësimet atje, po megjithatë nuk kemi parë avancim.

Nuk kemi parë buxhet të mjaftueshëm për çerdhet. Ne kemi folur shumë dhe duhet ta përcjellim trendin e kohës që duhet të kemi çerdhe të paktën nëpër bashkësi lokale, jo vetëm në Gjakovë, po edhe në qytete të tjera, sepse nuk mund të kemi avancim apo zhvillim pa pasur një edukim të mirëfilltë nga parashkollorët dhe më tutje.

Unë e them edhe një sfidë, të cilën ma kanë thënë, që e kemi thënë edhe në të kaluarën, edhe para dy vjetëve. Në Gjakovë është spitali regional "Isa Grezda", i cili nuk ka rezonancë magnetike, nuk funksionon rezonanca magnetike me vite të tëra dhe ne themi kemi prioritet shëndetësinë, po nuk kemi parë ndonjë veprim konkret.

Të njëjtën kohë kemi kërkesa edhe të komunave të tjera, por po e marrë vetëm një komunë, e cila në njëfarë forme është përjashtuar nga buxheti, për shembull, komuna e Drenasit, nuk ka najë

avancim te rruga që e lidh komunën e Drenasit me komunën e Skenderajt që ka qenë në projekt dhe besoj e meriton ajo trevë që ta ketë këtë rrugë funksionale në shërbim të qytetarëve.

Kemi edhe probleme të tjera, për shembull, kemi pasur plot gojën për Stadiumin Nacional, i cili është paraparë të bëhet në komunën e Drenasit, nuk kemi parë ndonjë veprim apo reflektim në këtë buxhet.

Te komuna e Drenasit ka pasur kërkesë ndërtimi i QKMF-së, nuk e kemi parë as aty që kemi ndonjë veprim nga Qeveri dhe shumë projekte të tjera, të cilat janë të përjashtuara dhe mendoj që ne do t'i ngremë përmes amendamenteve.

Ky projektbuxhet në asnjë mënyrë nuk po tregon se si Qeveria e Kosovës do t'u përgjigjet sfidave të reja në ekonomi, por po pasqyron vetëm një vazhdimësi të vitit aktual, vit ky kur qytetarët e Kosovës u varfëruan dhe ekonomia e vendit regjistroi një ngadalësim drastik në rritje.

Projektbuxheti i propozuar në asnjë mënyrë nuk reflekton një strategji të karakterit zhvillimor për vendin, po kryesisht është i bazuar në shpenzime sot për sot, ndonjë pako për të kaluar nga muaji në muaj, po nuk kemi ndonjë buxhet solvent apo të qëndrueshëm për të krijuar një bazë të qëndrueshme ekonomike.

Kjo Qeveri assesi nuk po mund të dalë me një vizion konkret që tregon se ku synon ta çojë vendi në vitet që i kanë mbetur.

Nga ajo që po shihet, kjo Qeveri do të mbahet në mend vetëm për shpenzime enorme, për nisma të pamenduar mirë me efekte shumë afatshkurtra.

Është evidente një tendencë e Qeverisë për t'u krenuar me shifra të paraqitura në këtë projektbuxhet, me arsyen se qenka buxheti më i madh apo historik.

Qytetarët po jetojnë dhe po ballafaqohen me këtë sfidë çdo ditë. Ne kemi një rritje enorme të çmimeve, kemi inflacion mbi 20%, baza e çmimit rritet, kur rritet akciza, rritet indirekt edhe TVSH-ja, të hyrat rriten, po ne e shohim se qytetarët me të njëjta mjete që i kanë pasur në vitin 2021 nuk kanë mundur të blejnë produkte të njëjta në vitin 2022, e aq ma shumë nuk mund të blejnë në vitin 2023.

Unë do të ndalem edhe te disa çështje të tjera, për shembull, zgjidhja më e qëndrueshme dhe më e drejtë në këto kushte do të ishte rritja e pagave, e pensioneve, të ketë edhe ndihma sociale, po të njëjtën kohë ne kemi parë që nuk është paraparë as Ligji i pagave në një formë apo tjetër të mbulohet me kosto buxhetore.

Për të mos ju marrë kohë, do të ndalem, po e shoh që është edhe ministrja e Drejtësisë këtu. Në fushën e drejtësisë përkundër zotimeve të kamotshme apo ditore që i bën Qeveria në nivel të ministres, zëvendësministrit, kryeministrit, nuk ka buxhet apo nuk po shihet që ka mjete për procesin e vetingut, i cili mendoj që duhet të ketë edhe konsensus, sepse duhet të ketë edhe ndryshime kushtetuese, po të njëjtën kohë duhet të ketë edhe buxhet.

Nuk kemi parë ndonjë buxhet apo një rritje buxhetore për Byronë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, apo nuk kemi pa ndonjë buxhet të rritur për modernizimin e funksionimin as në arsim, po as në drejtësi, e në veçanti te rritja e pagave, te bashkëpunëtorë profesionalë, të cilët bartin me veti punën më të madhe gati baras me gjyqtarë dhe me prokurorë.

Në fund krejt, për të mos hap diçka tjetër, ky buxhet nuk reflekton kërkesat e qytetarëve në ekonomi dhe krijimin e vendeve të punës, nuk reflekton ngritjen e kualitetit të jetës për qytetarët tanë, mungojnë projektet e mëdha, qoftë në fushën e infrastrukturës, ndërmarrësisë, shëndetësisë, sigurisë, arsimit dhe shkencës dhe mendoj se Qeveria duhet të reflektojë në harmonizim me rrethanat e reja dhe me kërkesat e qytetarëve dhe në ballafaqimin me varfërinë që bëjnë çdo ditë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Replikë, po urdhëro! Çka është përmendur aty?

Po e lëmë që këto të mos i japim për komunat këto replika, por e keni të drejtën e fjalës, e nderuar. Kur t'ju vijë radha këtë reagim mund ta integrosh në fjalimin tuaj.

Tash fjalën ia japim ministrit të Financave, Hekuran Murati.

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Buxheti që keni para jush, ose projektbuxheti, në fakt, siç edhe u tha, përbën një hap tutje drejt realizimit të programit tonë qeverisës, por edhe elektoral me të cilin kemi garuar.

U tha edhe për të hyrat që janë në nivel rekord, por edhe te shpenzimet, gjë që si rrjedhojë e këtyre të hyrave të rritura na mundësohet që të përshtatim edhe shpenzimet, përkundër faktit që duhet të kthehemi në rregullën fiskale, në kufizimin e deficitit prej 2% për vitin e ardhshëm, por do të isha ndalur edhe tek disa çështje që u ngritën.

Po filloj nga këto të fundit, pra që ishte buxheti për vetingun, apo për Byronë e Konfiskimit të Pasurisë së Pajustificueshme.

Të nderuar deputetë,

Veç a jeni që i kaloni këto ligje dhe vetingun, se buxheti s'mungon, buxheti është. Të njëjtën gjë, jua kujtoj, më lejoni t'ju kujtoj, që të njëjtën gjë e keni thënë për Gjykatën Komerciale pikërisht

në këtë Kuvend. E njëjta gjë është thënë që s'ka buxhet, s'ka kapacitete, s'është paraparë dhe do të zvarritet krijimi i Gjykatës Komerciale, por ja që e kemi një Gjykatë Komerciale funksionale tashmë. Domethënë, nuk është çështja te buxheti. Veç kalojeni ju si Kuvend vetingun dhe na e mundësoni që të lëvizet përpara me reformat në drejtësi, por edhe me konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme.

Çështja tjetër që u ngrit ka të bëjë edhe me disa prej çështjeve, apo dezinformatave që u thanë këtu, që ka të bëjë fillimisht me Ligjin e pagave. Më lejoni vetëm, pra, të krahasoj që kur është bërë Ligji i pagave në vitin 2019 nga AAK-ja, për vitin pasues pra pagat dhe shtesat kanë qenë të buxhetuara me 650 milionë euro. 650 milionë euro kanë qenë të buxhetuara, kurse tani e kemi buxhetin 745 milionë euro. Domethënë, 95 milionë euro më shumë sesa ka planifikuar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, bashkë me PAN-in asokohe, pra PDK, AAK, NISMA, për të mbuluar Ligjin e pagave. Domethënë, kapërcimi nga viti paraprak ka qenë 620 milionë, në vitin kur do të zbatohet Ligji i pagave 650 milionë. 30 milionë euro shtesë, por edhe ato 30 milionë euro shtesë kanë qenë 100 milionë euro më pak se që kemi buxhetuar ne. Prandaj, kur thoni që nuk ka buxhetim të Ligjit të pagave, po thoni të pavërteta.

Çështja tjetër që u ngrit kishte të bënte edhe me çmimet e rritura dhe sektorin privat, të cilat jo domosdo mund të gjenden në zëra specifike buxhetorë, por sa i përket kësaj çështjeje, ne kemi kaluar një ligj për çmime tavan, të cilin ju nuk e votuat dhe madje e keni çuar në Gjykatë Kushtetuese.

Tash, vetëm dikush hipokrit dhe që mund të ketë interesa të përbashkëta me supermarketet e çon një ligj të tillë në Gjykatë Kushtetuese. Pra, ky është fakti. Përndryshe, kot e keni nëse qaheni këtu se si qytetarëve u është vështirësuar jeta, kurse në anën tjetër, tentoni të bllokoni çdo tentativë për ta lehtësuar jetën e qytetarëve.

U fol edhe për thirrjen që i është bërë sektorit privat për t'i rritur pagat. Ne e kemi sjellë Ligjin për pagën minimale në këtë Kuvend dhe në momentin që kalon Projektligji për pagën minimale, përveçse do të rritet paga minimale, do të rriten pagat në sektorin publik, edhe privat, për shkak se lirohet nga tatimi pjesa prej 250 eurove të para, ashtu siç edhe kemi premtuar.

U përmendën edhe çështjet e pensioneve, apo transferove sociale. Pra, më lejoni edhe këtu ta jap një evolim të shpenzimeve në këtë kategori. Në vitin 2018 pagesat për pensione dhe skema sociale kanë qenë 392 milionë euro të buxhetuara. Në vitin 2019 kanë qenë 444 milionë euro, në vitin 2020 - 458, në vitin 2021 - 481, në vitin 2022 kemi rritjen më të madhe, pra është 568 milionë euro dhe në vitin e ardhshëm është 610 milionë euro.

Pra, nëse e krahasojmë me kohën kur keni qeverisur ju, mund të flasim për më tepër se 50% rritje të pagesave për skemat pensionale dhe sociale. Normalisht, që këtu ka pasur shtim të skemave të reja, të cilat duhet të mbulohen, por ato para, ato mjete shkojnë tek qytetari.

Çështja tjetër që u ngrit, ishte edhe disa dezinformata, apo besoj edhe keqlexim i tabelave, se u tha që ekzekutimi i subvencioneve dhe transferove ka qenë... sa, 29 a 30% thatë, e keni përzier, i nderuar deputet, ajo është rritja krahasuar me vitin paraprak, por jo ekzekutimi i shpenzimit këtë vit.

Kështu që, ju lutem, lexojini saktë tabelat, se të njëjtat gabime po i bëni, edhe kur po e lexoni Buxhetin dhe kontingjencat. Nëse thuhet që Qeveria ka kontingjenca, duhet të shpjegohet pse janë ato kontingjenca. 75 milionë euro janë kontingjencë për energjinë elektrike, pra për mbështetjen e qytetarëve dhe bizneseve për ta tejkaluar krizën energjetike, që janë mbështetje nga fondet IPA të Bashkimit Evropian. Normalisht, që e kemi shtuar si kontingjencë, sepse mjetet ende nuk i kemi pranuar. Në momentin që pranohen mjetet, ndahen edhe në resorin përkatës.

Kemi shtuar kontingjencë pra mbi rritjen e buxhetit të pagat edhe 65 milionë euro në kategorinë e pagave. Pra, nuk mund të thuash që pse ke lënë kontingjencë e ta injorosh faktin që ato janë për paga dhe për zbatimin e Ligjit të pagave në momentin që hyn në fuqi.

Ka edhe kontingjenca të tjera për masa që janë në vijim, por është edhe kontingjenca për ligjet e reja që hyjnë në fuqi. Pra, këtu vjen ajo çështja që e përmenda me Gjykatën Komerciale, me Byronë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, por edhe me procesin e vetingut. Në momentin që Kuvendi miraton një ligj të ri, i cili hyn në fuqi dhe ka nevojë për mbështetje buxhetore, prandaj është kontingjenca që ndahet dhe mundësohet funksionalizimi i atij mekanizmi, apo funksioni shtetëror.

Pra, u thanë shumë gjëra që si opozitë normalisht keni të drejtë t'i thoni, por ne po ashtu kemi të drejtë si Qeveri tani ta kthejmë pasqyrën tek ju dhe t'ju tregojmë se çka keni bërë kur keni qenë në pushtet, se tash si opozitë po i kërkoni, por çka keni bërë kur keni qenë në pushtet. Ju keni premtuar pagë mesatare 1 mijë euro, në qeverinë e PAN-it. Ky ka qenë premtimi, por kur erdhët në pushtet vetë i rritët pagat 100%. Tash paradoksi tjetër është që para dy ditësh, nëse s'gaboju, u takuat edhe me sindikatat dhe u kishit premtuar 30% rritje të pagave, e kjo tregon që edhe me rrena kur vjen puna për të tjerët jeni dorështrënguar. D.m.th. për veti 100%, rrenën tjetrit 30%, së paku rreni mirë bile, është dashur t'u thoni 50%, t'i rreni, jo 30.

Kur keni garuar para pandemisë keni thënë 100 euro për secilin qytetar. Çka ndodhi kur erdhët në pushtet? U shpërndatë para supermarketeve 70 milionë euro. Supermarketet kanë fituar shumicën e parave, apo mbështetjes suaj. Keni premtuar edhe shtesa për fëmijë. Çka keni bërë

është, keni ndarë 53 milionë euro për kontrata për asfalt, të cilat nuk kanë qenë punë të kryera, kanë qenë si ndëshkime apo ku di unë me çfarë arsytimi i keni paguar. E këto i keni llogaritur si investim kapital dhe mbështetje për zhvillim ekonomik. Domethënë, këto janë paradokset e juaja.

Prandaj, edhe një herë, nëse kthehemi tek buxheti dhe e krahasojmë po ashtu e kemi edhe mundësinë ta shohim cili ka qenë plani juaj, kur keni bërë projeksionin për vitin 2023. Tash po hyjmë në vitin 2023, ne e kemi bërë një buxhet në vitin 2023, por nëse e krahasojmë me kornizën afatmesme të shpenzimeve, që e keni bërë ju kur keni qenë në Qeveri, atëherë mund të shohim që për vitin 2023 të hyrat e parapara nga ju kanë qenë 2 097 milionë euro. Kurse, ne kemi paraparë 2 884 milionë euro. Pra, dallimi për vetëm një vit është 787 milionë euro.

Qytetarë të nderuar, kjo është diferenca. Pra, kur qeveriset ndershëm, mirë dhe kur ndalohet hajnia e korrupsioni. 787 milionë euro për vetëm një vit është dallimi. Nëse merren që të tria vitet, pra prej 2021, 2022 dhe 2023, sa është dallimi? Vetëm në të hyra është shifra 1,6 miliard euro. Domethënë, taksapaguesve të këtij vendi u janë shpëtuar 1,6 miliard euro, të cilat u kthehen në një formë apo tjetër, qoftë përmes mbështetjes në pensione, skema sociale, subvencione, transfere apo edhe investime të tjera për mirëqenien e qytetarëve.

Nëse shohim në fillim të qeverisjes, kur e kemi marrë keni thënë që do ta bankrotoni shtetin me politikat sociale që keni, s'i keni paratë, s'e keni buxhetin për shtesa për fëmijë. Ja që edhe i bëmë shtesat për fëmijë e për lehonat e rritjen e pensioneve dhe borxhi publik, ju keni planifikuar që të jetë 35% i GDP-së në vitin 2023, kurse ne do ta mbyllim me 22%. Domethënë, 13 pikë përqindje, apo 600 milionë euro më pak borxh, më pak barrë për gjeneratat e reja.

*(Debat në sallë)*

**KRYETARI:** Ministri ju dëgjoi edhe ju duhet ta dëgjoni atë, ju lutem! Ai priti, deri tash s'ka folur, ju ka dëgjuar. Një orë e gjysmë keni folur, kështu që, mos i ndërhyri njëri-tjetrit, ju lutem! Pse, Besian? Replikë, a? Mirë. Replikë me ministrin? S'ia ka përmendur emrin, po ia ka përmendur partinë. Urdhëro, Besian. Për komuna nuk po lejojme replika, po për parti, po.

**BESIAN MUSTAFA:** Faleminderit, kryetar!

Ministër, faleminderit për një rezymë të shkurtër që e bëre, po prej atyre minutave nja 80% fole për të kaluarën e shumë pak për të ardhmen.

Po ta rikujtoj, sot e kemi në diskutim Projektligjin për të ardhmen, për buxhetin e vitit 2023, se ndoshta s'të kanë njoftuar cila është tema e sotme. Po, të sugjeroj, ministër, kthehu në histori, ndoshta ia gjen ndonjë gabim edhe Ismail Qemalit, Skënderbeut e ku ta di unë deri kur do të kthehesh ti.

Ministër, edhe një herë po të them, jemi duke folur për buxhetin e 2023-tës, e jo për të kaluarën. S'jemi në lëndë të historisë këtu, jemi në Kuvend, ministër.

Ministër, sa i përket asaj që e kemi dërguar në Gjykatë Kushtetuese Ligjin për çmime tavan, që po e quajmë në gjuhën e përditshme. Ministër, me atë ligj shkatërrohet secili market i vogël dhe i mesëm në Republikën e Kosovës dhe mbizotërojnë, pra po doni ta shndërroni atë sektor në oligarki, ku vetëm një numër shumë i vogël i supermarketeve dhe zinxhirëve mbizotërojnë. Pra, sipas logjikës suaj, ministër, jo simes, po suajës, me këtë logjikë i bie që nëse dikush këtu është i lidhur ngushtë me marketet e mëdha jeni ju, e jo ne, se ne po duam t'i mbrojmë edhe të vegjlit e të mesmit. Ju po doni t'i shkatërroni ata dhe t'i lejoni vetëm të mëdhenjtë.

Dhe, mbi të gjitha, ministër, edhe nëse qëllimet i keni pasur të mira, që po besoj, hajde që, nuk po dyshoj që qëllimet i keni pasur të mira, edhe qëllimet nëse i keni pasur të mira, ligjin e keni antikushtetues dhe ky Kuvend e ka obligim ta dërgojë në Gjykatë Kushtetuese. Le të vendosë pastaj Gjykata Kushtetuese nëse e keni ju mirë, apo ne. Por, nëse ne mendojmë që Kushtetuta po shkelet me atë ligj, e kemi dërguar. Vendimin final e jep Gjykata Kushtetuese, ministër.

**KRYETARI:** Ka një kundër-replikë ministri.

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Tash unë prita që për dallim ju të flisnit për buxhetin, por prapë nuk folët për buxhetin.

Po ashtu, prita që si subjekt politik, meqenëse ishim mbledhur që të gjithë ta analizoni buxhetin, do të kishte më shumë substancë, por po shihet që as që e keni kuptuar buxhetin. Mund ta keni lexuar, por kur thoni që s'ka rritje aty, mungon kjo, mungon kjo, i bie që s'e keni kuptuar. Pra, keni problem që t'i lexoi tabelat e buxhetit.

Për më tepër, nëse u intereson kaq shumë kushtetutshmëria dhe tregu i lirë në këtë vend, pse nuk e dërguat edhe monopolin e homologimit në Gjykatë Kushtetuese, por përkundrazi, kur e kemi sjellë ne ligjin për ta ndaluar atë monopol, ju keni votuar kundër.

**KRYETARI:** Hajdar, replikë edhe ju, a? Urdhëro!

**HAJDAR BEQAJ:** Faleminderit, kryetar!

Realisht, me ministrin që iu referua tekstit, kur unë thashë që sa i përket vetingut dhe byrosë, në këtë rast nuk ka paraparë buxhet Qeveria. Një politikë që nuk mbështetet me buxhet është joserioze. Prandaj, ministër, po shihet që nuk jeni seriozë në këto tema, vetëm i keni për konsum të brendshëm, por jo për t'i realizuar.



Është e pavërtetë ajo që tha ministri, “keni qenë kundër Gjykatës Komerciale”. Përkundrazi, Gjykata Komerciale, Ligji për Gjykatën Komerciale është promovuar në kohën kur ishte ministri i Drejtësisë zoti Abelard Tahiri dhe në atë kohë ishte kryetar i partisë zoti Kadri Veseli që e kanë promovuar dhe të njëjtin ligj e kemi votuar. Ne e kemi përkrahur Gjykatën Komerciale, kemi kërkuar të rritet numri i gjyqtarëve, përveç kësaj kemi kërkuar të rritet edhe buxheti për Gjykatën Komerciale, se kemi konsideruar që është diçka e domosdoshme.

Të njëjtën kohë, kemi ulje në këtë rast të buxhetit në drejtësi. Për shembull, nuk e di pse ministre, ju keni premtuar që do ta rrisni buxhetin në sistem të drejtësisë, kurse kemi ulje të buxhetit te Këshilli Prokurorial. A është problemi që keni ndonjë kontest me Këshillin Prokurorial apo çka s’po shkon këtu, apo është bërë ndonjë gabim teknik në buxhet. Edhe, ministër, është mirë të jesh seriozë, sepse qytetarët e dinë më së mirë çka ka ndryshuar jeta e tyre prej se ke ardhur ti ministër, sidomos në aspektin financiar, se në energji e të tjera s’po flas.

**KRYETARI:** Po, një kundër replikë e ministrit Murati dhe pastaj vazhdojmë me diskutuesit e tjerë, sepse ka shumë. Rreth njëzet janë paraqitur ende për të folur.

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Ju që e keni kundërshtuar Gjykatën Komerciale thashë, keni thënë që s’ka buxhet, prandaj do të dështojë. Dhe, unë ju tregova që ne kemi ndarë buxhet, njësoj siç do të ndajmë për byronë, njësoj siç do të ndajmë për procesin e vetingut.

Sa i përket Këshillit Prokurorial të Kosovës, arsyeja pse po thonë që ka buxhet më pak është te investimet kapitale. Ka qenë një projekt kapital, të cilin ata e kanë përfunduar në vitin aktual dhe ai projekt kapital nuk vazhdon përherë. Por, te kategoritë e tjera ka rritje. Faleminderit!

**KRYETARI:** Armend Zemaj e ka fjalën.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit!

Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Media,

Kryetar i Kuvendit,

Ministra të pranishëm,

Faleminderit shumë!

E para, është shumë e vërtetë se buxheti u takon të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, edhe projeksionet bëhen në bazë të të hyrave që planifikohen dhe sigurisht, prapë janë taksat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Po mbetet menaxhimi, mbi të gjitha mbeten premtime dhe ato që janë të vendosura në letër, këtë që ne e themi “E zeza në të bardhë.”.

Kështu që, besoj që edhe ministri i Financave, por edhe kryeministrit, kur t’ia japin informacionet bazohen në të njëjtat letra që i ka deputeti i Kuvendit të Kosovës dhe sigurisht, se edhe këto që i shpërndan Qeveria e Republikës së Kosovës.

Unë po flas gjithmonë, por edhe duhet t’i kemi të bazuara fjalimet, jo vetëm në aspektin dëshiror ose opozitar, por të interesimit në fushat që po mendojmë mund të japim kontribut dhe të kërkojmë buxhet shtesë, në kuptimin e përmirësimit të jetës së qytetarëve, ose ofrimit të shërbimeve. Po flas tash për Ministrinë e Shëndetësisë dhe për shëndetësinë në përgjithësi.

Ky është plani i Qeverisë i paraqitur tre vjet më parë. Ky është viti i tretë buxhetor i premtimeve, por edhe i planifikimit, ose i realizimit të buxhetit në shëndetësi. Unë po flas me ato që i kemi të ofruara këtu si shifra, mbi të gjitha edhe me gjendjen nëpër të cilën po kalon shëndetësia kosovare.

Sipas indikatorëve Kosova ka rezultatin më të dobët për shëndetësinë në Ballkan. Nuk po e themi ne, janë matësit, janë ndërkombëtarët, janë OJQ-të kredibile, që e kanë paraqitur edhe sipas raporteve të fundit të këtij nëntëmujori të këtij viti. Çdo indikator është më negativ sesa tjetri, kur flasim për shërbime, flasim për investimet kapitale, flasim për pajisjet, për produktet medicinale, por edhe për furnizimin me barna.

Por, a e di ku ka mbetur financimi më i madh i shpenzimeve në shëndetësi në këtë Qeveri, domethënë që është jashtë buxhetit dhe në formë të pagesave është nga xhepi i qytetarëve të varfër. Dhe, kjo është trefishi, ose pesëfishi më shumë sesa ndan buxheti i Republikës së Kosovës, ose sa është i ndarë për vitin 2023.

Qeveria e Republikës së Kosovës në planin e saj për shëndetësi, prapë flas para dy vjetësh, por që është plan katërvjeçar për përmbushje, ja çfarë thotë... dhe të cilat a janë të paraqitura në këtë projektbuxhet?”

E para, reformimi i sektorit të shëndetësisë nuk ka filluar, nuk është asnjë cent i ndarë.

Riorganizimi i sektorit të shëndetësisë nuk është paraparë fare në buxhet, as i planifikuar, as i buxhetuar. Nëse ju e gjeni diku në tabelat e juaja, urdhëroni, ne prapë po debatojmë.

Korniza ligjore e sektorit të shëndetësisë, me theks të veçantë Ligji për shëndetësinë, nuk është paraparë në buxhet asnjë cent, asnjë veprim.

Ministri i Financave tha: “Pse s’po e mbështesni një ligj të caktuar në sektorin e drejtësisë, sepse ne do të sigurojmë buxhet.”

Ka qenë këtu ligji i ri për shëndetësi, nuk është mbështetur, është thënë se do të vijë në shtator, sot po hyjmë në fundin e vitit 2023 dhe fare nuk e dimë a ka kaluar as nivelin e grupeve punuese.

Prioriteti tjetër që flet dhe që thotë, se ka të bëjë me kujdesin paliativ, fuqizimin e kapaciteteve të inspektimit dhe monitorimit, fare pak, të mos them hiç, bile me deklaratat në tërësi për mbështetjen buxhetore, për rritjen e numrit, kishte të bënte në tërësi për sistemin shëndetësor, duke e futur edhe atë të kujdesit parësor dhe që është në kundërshtim edhe me atë që e tha vetë kryeministri i Republikës së Kosovës. Domethënë, është minimal, fare minimal.

Pjesa tjetër, që ka të bëjë, gjithmonë po flas me planin dhe programin e Qeverisë Kurti, cilësia e shërbimeve shëndetësore.

E njëjta gjendje, e njëjta financë. Janë 15% më shumë buxhet në tërësi, por këtu në planin e Qeverisë keni thënë se shëndetësia është prioritet. Është prioritet i prioriteteve. Ndërsa te trendi i ndarjes së buxhetit, sipas organizatave buxhetore nuk është prioritet. Është Ministria e Financave, është Ministria e Mbrojtjes, është Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë e Tregtisë, është Ministria e Kulturës, sepse aty tash po ka subvencione, po ka paga marramendëse për ekspertë të ndryshëm përmbi 5 500 euro, dhe tek atëherë vjen Ministria e Shëndetësisë me 16.6 milionë shtesë, që i bie në këtë përqindjen, ose nëse llogarisim me bruto-produktin vendor, i nderuari ministër, në vitin 2009, në vitin e parë të Pavarësisë ka qenë 3,8% për shëndetësi. Sot e ke 3,1%, as 3,1% bile në total.

E tash, për çka po flasim? Për çfarë përkrahje po flasim, për çfarë buxheti shtesë po flasim? Dy elemente të tjera, që do të ishin shumë të rëndësishme: Shtrirja dhe funksionalizimi i sistemit unik të integruar të informimit shëndetësor, që do të përfshinte rregullimin e sistemit të referimit të pacientëve në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, kjo është një përkrahje minimale me buxhet, është vetëm sa për të thënë që është aty një kod buxhetor.

Ndërsa, ajo kryesorja që është për fondin për sigurime shëndetësore, ose si parakusht për fillimin e grumbullimit të kontributit, nuk është paraparë asgjë, as në paga të sektorit publik, as të planifikimit të fondi i sigurimit, por as te ligji i ri, i cili do të duhej të ishte në Kuvendin e Kosovës, ose si premtim ligjor dhe elektoral.

Andaj, me këto parametra nuk përforcohet asnjë standard, sidomos këtë që e ke kërkuar te çmimet e referimit të barnave. Faleminderit për rritjen prej 15%, por çdo bar në Kosovë është rritur 10-15% në vitin e fundit. Ata që e dinë edhe e njohin këtë pjesë, e shohin cila është mundësia e kapacitetit në total e sigurimit të barnave me shumën e njëjtë, ose me shumën e ndryshme buxhetore.

Këto mosveprime, ose të mos qenë kredibile në raport me buxhetin edhe që do të kishte avancim të shërbimeve shëndetësore, mbi të gjitha përkrahje për të varfrit. Është në diametër të ndryshëm me programime ditore të kësaj Qeverie.

Kolegë të nderuar deputetë,

Për hir të transparencës, jo për shkak të rolit opozitar, fuqizim enorm ka në sektorin privat gjatë kësaj qeverisjeje, privat shëndetësor, edhe atë me interferime të njerëzve që e kanë udhëhequr Ministrinë e Shëndetësisë dhe që janë udhëheqës tash të spitaleve në këtë sektor. Shikoni sa spitale private janë licencuar prej se ka ardhur Qeveria Kurti 2. Me statistikë, me kosto, me kosto të shpenzimit, edhe sa paguajnë atje në Administratën Tatimore të Republikës së Kosovës. Kjo bile ishte në planin ekzekutiv të ministrit të ri të vetëmëruar, zoti Kurti, që do të bëjmë një analizë dhe një definim të ndarjes dhe të bashkëpunimit në atë publik-privat që ndërli dhej, e thashë, po e përsëris, me zhvillimin e SISH-it, ose me reformimin e shërbimit spitalor klinik universitar të Kosovës, që nuk ka ndodhur fare. Bile, bile interferimet janë të dëmshme, janë edhe me kosto financiare, janë edhe me kosto njerëzore, me ikje dhe largim të mjekëve.

Kolegë të nderuar deputetë,

Ministra të pranishëm,

191 mjekë janë larguar nga Kosova vetëm në vitin 2022, 159 janë larguar në vitin 2021. Po flasim për nëntëmujorin, ose deri sot kur po raportohet, kur po bisedojmë për këtë buxhet. Domethënë, 350 mjekë e kanë lëshuar Kosovën. 362 janë të papunë. Paramendoni, angazhimi në reformim në plotësim të nevojave të qytetarëve, në marrje të shërbimeve, në planifikim të buxhetit, ku është sot Ministria e Shëndetësisë dhe ku planifikoni ta keni për vitin e ardhshëm. Me një fjalë, më vjen keq që gjendja është kështu. Do të ishte ndoshta më e udhës, që të mos përcillen partitë politike, se a mbajnë tryeza për buxhetin, por të punohet, të marrin këshilla. Këtu jemi ndonjëherë edhe për të ndihmuar, nuk jemi vetëm për të kritikuar, por jemi për të dhënë edhe më të mirën e mundshme që të plotësojmë nevojat e qytetarëve me këtë buxhet çfarë e ofron Republika e Kosovës dhe me këtë kapacitet çfarë e kemi si shtet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash po ia japim fjalën kryetarit të Grupit të AAK-së, Besnik Tahiri.

**BESNIK TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar zv.kryeministër,

Ministër,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë e kuptoj plotësisht ministrin Murati i cili ka arritur realisht jo vetëm të mashtrojë, po edhe të jetë njeriu më i dobët në kabinet të Qeverisë, po nuk po kuptoj se si një ministër i Financave del këtu dhe e reflekton dhe e mbështet një buxhet i cili në esencë e rrezikon funksionimin e shtetit

të së drejtës, sigurinë kombëtare, e rrezikon funksionimin e secilit sektor vital të shtetit dhe del na flet për rritje të buxhetit.

Të nderuar deputetë,

Ky buxhet, secili njeri që e merr e bën një refleksion konkret e sheh se ky buxhet reflekton në një rën të pazotësi dhe në anën tjetër tendencë të kontrabandimit të politikave që e çojnë shtetin në dështim. Tani më lejoni t'i argumentojë këto fjalë të cilat në esencë tingëllojnë të rënda, po më lejoni të argumentojë pse.

Po e fillojmë fillimisht me aty ku bëhet jeta, në komunat e Kosovës. Neni 9.6 thotë që: përmes këtij buxheti, e drejta e të hyrave vetjake, që është e drejtë e garantuar me ligj dhe me Kushtetutë për menaxhimin që komuna e ka në dorë të vet, i merret për herë të parë në histori të funksionimit të administratës shtetërore dhe i kthehet në menaxhim të centralizuar. Ligji për financa publike zotëria e ka pasur gati, ku kanë qenë të përcaktuara kriteret e financimit të projekteve kapitale, si dhe granti i katërt. E ka hequr prej agjendës legjislative. E ka transferuar buxhetin në formë totalisht politike, duke mos e trajtuar as brenda partisë së vet kriterin për kapita, apo kriterin e madhësisë së komunës.

Shiheni Shtimen, shiheni Podujevën! Shihe madhësinë e Podujevës me kilometra e popullatë, shihe atë të Shtimes! Edhe aty e ka bërë e lëre më që e ka goditur secilën komunë ky buxhet. Po e marr veç një shembull 45 për qind është rritur buxheti për kulturë. Pesë projekte që i ka dorëzuar Smajl Latifi prej Rahovecit, të pestat janë hequr pasi që Ministria e Kulturës i ka çuar, i ka hequr Ministria e Financave. Pra sot rrezikohet rendi kushtetues edhe siç themi një shkallësh i qeverisjes së Kosovës në nivel komunal. Ky rrezikim vjen prej këtij buxheti.

Çështja e dytë lidhet me sigurinë. Vendi është në krizë serioze. Globi është në krizë serioze. E tha deputeti Bekë Berisha, 4,7 për qind rritje për Ministrinë e Punëve të Brendshme me krejt atë mekanizëm që e ka, që nënkupton jo rritje, po dëmtim në esencë të funksionimit të rendit publik në Kosovë. njëzet milionë për ushtri. Ju lutem, ky vendim, ky buxhet e reflekton mosvullnetin politik të forcohet një element i shtetit. Për këtë arsye kjo rrezikohet.

Shkojmë tutje. Po e nisim me rrezikimin e sektorit publik. Le ta shohë ministri, le t'i marrë të dhënat sa njerëz janë duke e lëshuar punën prej sektorit publik. Tri herë e ka sjellë Ligjin e pagave në agjendë legjislative. Xhelal Sveçla e ka çuar gjashtë muaj përpara, gjashtë muaj ka ndenjur në ministri. Qe pesë javë është kryer dëgjimi publik dhe ligji nuk vjen se vjen si rrjedhojë që mos të jetë ligj i miratuar që detyrimisht të dihet edhe vlera e koeficientit edhe të dihet buxheti i një ligji. 140 milionë shtesë i vyen këtij ligji. Në qoftë se mendon me shtatëdhjetë milionë, atëherë është duke e kalkuluar koeficientin me 100 euro edhe atë jo për këtë vit, për 2023. Çka t'i them kësaj? Qe po ju pyes unë, a e kam vendosur unë, a e ka vendosur Aleanca në

agjendën legislative me zor atë ligj? Jo. Sektori publik është i rrezikuar prej këtij ligji, njëkohësisht prej ligjit tjetër që po vjen këtu. 1 600 udhëheqës kontratën e kanë të rrezikuar.

Shkojmë te sektori privat pak. Ministri del e thotë: sektori privat, fabrikat duhet t'ua rrisin pagat njerëzve të vet se u është rritur fitimi. Këtu thotë unë e kam buxhetin më të madh në Kosovë që ka qenë ndonjëherë. Pse bre zotëri, ti po u thua atyre që s'janë paratë tua, rriti pagat, që në fakt ua kanë rritur, dikush dhjetë e dikush njëzet e ti e ke rritur buxhetin e ke bërë 3,3 miliardë, e ti po thua unë nuk po rrit, nuk po e sjell Ligjin e pagave. A e kuptoni standardin e dyfishtë? Këtë gjuhë mund ta transferojë te ju, po jo te njerëzit që lexojnë në formë kritike buxhetin. S'ka logjikë të kërkohet rritje e pagave në sektorin privat, e ti po thua e kam buxhetin më të madh, të mos rrisësh pagat.

Shkojmë tutje. Te arsimit, trumbetojnë intelektualë, profesorë, doktorë, Akademisë së Shkencës ia ka rritur pesë për qind. Është totalisht e anashkaluar. Universiteteve publike rritje minimale. Qysh po do ti ta mbash arsimin cilësor. Me përralla e kanë mbajtur para luftës prindërit tanë e prindërit e juaj, tash nuk e mbajnë. Asnjëherë nuk e mbajnë.

Ndalem te një momenti, shikojeni me kujdes, ia ka lënë një përqindje të madhe buxhetore Ministrisë së Financave për kontingjenca. Unë e kisha pranuar si dikush që ka qenë në Qeveri kontingjencat të cilat lidhen me kontingjencat rrjedhëse, që dikush i bie që e ndihmon ndonjë pension, ndonjë social, ndonjë invalid, ndonjë njeri në nevojë. Pra, këto janë kontingjencat rrjedhëse. Ky e ka lënë buxhetin te kontingjencat për investimet kapitale. Pra, rrjedhimisht ia ka lënë vetes në dorë si ministër të ketë vendimmarrje në ligj ku të duash për investime kapitale t'i lëvizë kontingjencat. Po të kishte kontingjenca për pensionistë, krejt në rregull jemi, është politikë e majtë, e ka reformën sociale që s'po i kalon, për shkak që edhe ne këtu s'po e votojmë, po e kisha pranuar. Po kontingjencat për investime kapitale janë detyrimisht instrument politik në një moment të caktuar a para zgjedhjeve a pas zgjedhjeve, a në komuna të veta a në Qeveri t'i fusë si investime.

Po ndalem vetëm edhe në dy momente dhe po e përmbyll. Shikojeni ku është rritur buxheti. Shikoje Kryeministrisë sa ia ka rritur buxhetin. Për çfarë arsye? Le të dalë të na tregojë pse i është rritur Kryeministrisë për 35 për qind e pse nuk ia ka rritur kaq Policisë, sigurisë dhe këtyre? Për çfarë arsye, mbi çfarë baze? Unë propozoj që ne të nderuar deputetë të opozitës me çdo formë demokratike ta ndalim kalimin e këtij buxheti deri te barrikadimi për të mos kaluar ky buxhet.

Në qoftë se nuk buxhetohet, nuk largohet fillimisht neni 9,6 për komunat që i vidhen paratë njerëzve që e paguajnë tatimin në pronë, ai e paguan për të pasur investimin në komunë të veten, jo ky të vendosë prej qendrës, se është detyrë e ndarë me ligj. Në qoftë se nuk rritet buxheti për siguri dhe në qoftë se premtimet elektorale që kanë qenë publike nuk hyjnë në këtë buxhet, ne

duhet ta pengojmë kalimin e këtij buxheti, për shkak se ky buxhet e rrezikon funksionimin e rendit ligjor, e pengon dhe e rrezikon sigurinë kombëtare dhe mbi të gjitha e varfëron secilin qytetar, si në privat si në publik.

KRYETARI: Fjalën ia japim deputetit Fridon Lala.

FRIDON LALA: I nderuar kryetar i Kuvendit, Konjufca!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot po diskutojmë njërin prej projektligjeve më imperative për vitin e ardhshëm kalendarik, Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës, mbi të cilin orientojmë punën dhe projektet konkrete të cilat synojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës. Mbi këtë premisë, përtej problemeve të shumta ekonomike e sociale, po besoj që Projektligji inkorporon interesat e qytetarëve. Si përfaqësues i komunitetit egjiptian mund të them dhe nevojat të cilat janë më imediate të komunitetit që përfaqësoj, mirëpo edhe të grupeve të tjera në nevojë.

Normalisht, përderisa diskutojmë ndarjet buxhetore për vitin që po vjen, reflektojmë edhe në praktika, politikat dhe projektet konkrete të cilat janë realizuar në vitin që po lëmë pas. Komuniteti egjiptian në kushte të rënduara ekonomike si pasojë e eventeve të ndryshme globale, ka qenë përfituese në masë të kënaqshme të projekteve apo pakove fiskale të dizajnuara t'u dalin në ndihmë grupeve të ndryshme shoqërore në Kosovë.

Po ashtu, çka është tepër e rëndësishme për ne, është që kemi arritur të inkorporojmë në buxhetin e vitit 2023 dy projekte tepër vitale për komunitetin, që përtej rëndësisë dhe nevojës për investime, pasqyrojnë edhe të drejtën bazike të tyre për të pasur qasje në ujë të pijes dhe po ashtu për të jetuar në ambient të pastër. Në “Ali Ibra” në Gjakovë po vazhdojnë punimet për rregullimin dhe rehabilitimin e deponisë ilegale për largimin e mbeturinave. Ne jemi të kënaqur që në buxhetin e vitit 2023 është ndarë shumë po ashtu që pas pastrimit të lagjes të kemi edhe ambiente rekreative për qytetarët të cilët jetojnë në atë zonë.

Po ashtu pas kalkulimeve të gabuara komunale për vitin e kaluar, në buxhetin e vitit 2023 kemi arritur t'i ndajmë tre milionë euro për shtrirjen e rrjetit të ujit të pijes në lagjet 28 dhe 20 të komunitetit në Fushë Kosovë dhe po ashtu në fshatrat përreth. Këto janë dy prej projekteve kryesore për të cilat kemi qenë të zëshëm edhe gjatë vitit të kaluar, mirëpo edhe gjatë këtij viti.

Po ashtu, përtej këtyre dy projekteve, vlen të theksohet se në buxhetin e vitit 2023 kemi po ashtu ndarje apo buxhetime edhe për dy fusha të tjera të rëndësishme. Njëra prej tyre është edhe arsimi.

Për herë të parë në histori kemi planifikim buxhetor për përkrahje të studentëve nga radhët e komunitetit egjiptian, ashkali dhe romë për t'i përkrahur me bursa për ndjekjen e arsimit të lartë.

Po ashtu në fushën e banimit, në koordinim me ministrat e linjës, tre milionë euro janë ndarë për rregullimin e shtëpive të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë dhe po ashtu dy milionë euro të tjera janë ndarë për projekte të banimit social.

Së fundmi, ne jemi po ashtu të lumtur që vazhdon kjo përkrahja e projektit për investime infrastrukturore për lagjet ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve joshumicë në komuna të ndryshme të Kosovës, përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për shkak se vitin që po e lëmë pas e kemi adresuar një gamë të gjerë të problemeve infrastrukturore të cilat kanë qenë të grumbulluara ndër vite në ato lagje ku komunitetet joshumicë janë më të koncentruara dhe po besoj që me ndarjet e reja buxhetore në vitin që po vjen, do të kemi po ashtu rregullim të një pjese shumë të madhe të problemeve infrastrukturore të cilat kanë mbetur në këto lagje. Ju faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)*

**KRYESUESJA:** Tani në radhë është deputeti Fatmir Humolli nga Lëvizja Vetëvendosje.

**FATMIR HUMOLLI:** Përshëndetje e nderuar!

Duke parë Projektbuxhetin për vitin 2023, kam parë që ky buxhet apo më mirë të them nuk kam mundur ta vërej a është i majtë a është i djathtë, as nuk e mbron kategorinë e majtë, as kategorinë e djathtë. Për shkak se jam pjesë e Komisionit të Mbrojtjes e Sigurisë, po ndalem direkt në këtë sektor, ku ky projektbuxhet për vitin 2023 e dëmton sigurinë e vendit tonë, për arsye se motivimin për mbrojtje të vendit tonë e pengon duke anashkaluar çështjen e veteranëve të luftës, duke anashkaluar sigurimin e policisë, duke anashkaluar sigurimin e FSK-së. Në qoftë se ne nuk i sigurojmë pjesëtarët e FSK-së, nëse nuk e sigurojmë Policinë, atëherë me çfarë motivi ata kanë mundësinë të ballafaqohen me vështirësitë, në kohën kur Serbia për çdo ditë na kërcënohet me ushtri, na kërcënohet me polici, na kërcënohet me grupe mafioze të cilat i organizon në pjesën veriore të Kosovës.

Një shtet i orientuar armiqësisht kundër Kosovës, që ka angazhuar një diplomaci serioze në mënyrë ofensive të punojë kundër vendit tonë, po ne duke krijuar këso ndasi brenda edhe shoqërisë sonë, ne i krijojmë një situatë të disfavorshme për neve, kurse e favorshme për Serbinë. Për këtë, unë jam deklaruar edhe para pjesëtarëve të Vetëvendosjes se nuk do ta votojë këtë buxhet, për arsye të thjeshtë se nuk ka askush të drejtë t'i anashkalojë këto vlera, kur ne shohim që Serbia, vlerën e luftës së humbur të vitit 1400 i motivon përmes asaj lufte të humbur popullsinë e vet të qëndrojë në Kosovë, të luftojë kundër Kosovës, kurse ne njerëzit e gjallë, familjet e gjalla të cilat janë, ne i injorojmë. Ky injorim duhet ndërprerë, e besoj që në leximin e



dytë duhet ndryshuar kjo çështje në raport me këtë kategori. Uroj që të reflektojë kjo Qeveri, të reflektojë edhe deputetët e Vetëvendosjes, ta shohin se e kanë marrë një mision politik që ta kthejnë shpresën e popullit tonë e jo ta mbysim shpresën tonë.

**KRYESUESJA:** Tani në radhë është deputeti Isak Shabani nga PDK.

**ISAK SHABANI:** E nderuar kryesuese e Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të dashur qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Sa i përket Projektbuxhetit për vitin 2023, për lëvdata kujdeset Kryeministri dhe ministrat, po gjithashtu edhe deputetët e pozitës, kurse unë do të jem i mendimit tim për këtë projektbuxhet që për disa çështje kemi mendime të njëjta edhe me deputetët e opozitës. Kjo Qeveri për çdo gjë akuzon të kaluarën. Nuk do të çuditem për një ditë kur një ditë do të thonë se edhe liria nuk është e mirë. dhe atë vetëm pse pjesë e libërjes janë edhe anëtarët e opozitës. Andaj, boll me luajtjen e rolit të viktimizimit.

Qytetarët dita-ditës janë duke kuptuar se kjo Qeveri është qeveri e mashtrimit. Që në fillim të fjalës sime këtë do ta dëshmojë. Ky projektbuxhet në asnjë mënyrë nuk reflekton një strategji të karakterit zhvillimor për vendin, por kryesisht është e bazuar në shpenzime sot për sot, të cilat nuk krijojnë kushte për zhvillim afatgjatë. Ky buxhet më së shumti mund të quhet një kopje e dobët e vitit 2022. Sepse në shumicën e rasteve është një përsëritje e vitit 2022. Këtij buxheti i mungon ambicia zhvillimore, i mungon orientimi që ku do të jetë Kosova në fund të vitit 2023 dhe çfarë Kosova do të ketë në fund të vitit 2023 do të shihet.

Buxheti total për projekte kapitale në nivel qendror është 594 milionë, ku prej tyre 543 milionë janë projekte në vazhdim nga viti 2022. D.m.th. 91,38 për qind, ndërsa 51,2 milionë janë projekte të reja. d.m.th. 8,62 për qind.

Kosova konsideroj se do të ketë një vit të humbur, sepse Qeverisë po i nevojitet dy vite për të kryer punët që do të duhej përfunduar brenda një viti. I vetmi dallim është se punët që nuk janë përfunduar në vitin 2022, në vitin 2023 do të duhet të përfundojnë me një kosto shumë më të lartë për buxhetin e shtetit, për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore, gjë e cila nënkupton humbje të parasë publike.

Se a është qeveri e mashtrimeve, do të përmend disa shembuj konkretë. Vetëvendosje në Podujevë ka marrë mbi njëzet mijë vota me premtime. Ka premtuar se do të rregullojë rrugën magjistrale Podujevë-Prishtinë në vitin 2022. Jo që nuk e ka rregulluar, por nuk e ka filluar fare këtë rrugë, sepse është duke u marrë me të kaluarën, duke u marrë me elaborate, auditime, hetime, të cilat askush nga ne nuk po ia ndal të vazhdojë edhe më tutje.

Por, premtimet që keni dhënë për këtë rrugë duhet mbajtur. Dhe jo vetëm të ndahen gjashtë milionë për vitin 2023 e në vazhdim të vazhdohet deri në vitin 2025. Nuk di që ka ndonjë rrugë në Kosovë që do të duhej dhënë prioritet më të madh se kësaj rruge. Do ta përmend këtë rrugë në çdo rast që më jepet, sepse është rrugë jetike për Llapin dhe Kosovën. 120 qytetarë të vdekur pas luftës, 800 të lënduar, me qindra invalidë kanë mbetur nga aksidentet e komunikacionit.

Miliona dëme nga dëmet materiale për shkak të këtyre aksidenteve. Miliona makina qarkullojnë gjatë një viti. Krejt diaspora jonë e dashur kur hyn dhe kur del nga Kosova kalon nëpër këtë rrugë. E ne çfarë sigurie po u ofrojmë? Koha e humbur në pritje të kolonave të gjata që krijohen në këtë rrugë është e paimagjinueshme. Këtu në projektbuxhet përmendet edhe autostrada Besi - Merdar. Qeveria ka ndarë vetëm treqind mijë euro për vitin 2023. D.m.th. autostrada është e pavërtetë ajo që do të realizohet. Kështu që edhe premtimi se do të ndërtohet edhe kjo autostradë e se do të ndalet frekuentimi i të gjitha atyre makinave, kjo nuk është duk u realizuar.

Është premtuar ndërtimi i zonës industriale në Livadicë. Është premtuar se do të bëhet shpejt. Në projektbuxhet është paraparë për tre vjet. 250 mijë në vitin 2023, 250 në 2024 dhe 300 mijë në vitin 2025. Bizneset llapjane kanë ikur dhe po ikin nga komuna e Podujevës, sepse nuk po ofrojnë kushte për të bërë biznes.

Sa i përket shëndetësisë, nesër është debati, do të mundohem të jem më i shkurtër. Në këtë projektbuxhet nuk është gjetur vend as për ndërtimin e depos qendrore të barnave, të cilin projekt e kam propozuar vitin e kaluar.

Të nderur deputetë,

Sidomos këta që janë në profesione mjekësore, shiheni në çfarë gjendje është depo sot qendrore, ku ruhen barnat edhe shpërndahen në nivelin primar kryesisht. Kemi rritje të buxhetit për shëndetësi. Kjo është për t'u përshëndetur, por kur merret parasysh inflacioni, rritja e çmimeve të barnave, kjo na bën të kuptojmë se nuk ka fare rritje dhe se me këtë buxhet nuk do të kemi shërbime të shpejta, të sigurta dhe cilësore.

Kemi rritje 27 për qind rritje të buxhetit në shëndetësi, kurse Zyra e Kryeministrit e rrit buxhetin e vet 35 për qind, apo me shifra afër gjashtë milionë më tepër. Qeveria nuk e ka prioritet shëndetësinë.

Sa i përket Komisionit të Administratës, ku është raportuar anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për kushtet ku janë duke punuar ai këshill. Na kanë thënë se dymbëdhjetë vetë punojnë në zyrë, kurse në buxhet janë ndarë vetëm tre mijë euro. Shuma e ndarë sipas projektbuxhetit 2023 për shëndetësinë, si përqindje e bruto-produktit vendor është 3,1 për qind, krahasuar me atë në regjion është më e ulët.

Partia Demokratike e Kosovës në vazhdimësi ka kërkuar që Qeveria t'u dalë në ndihmë qytetarëve për t'u përballur me krizën e rritjes së çmimeve. Buxheti i këtij viti po rezulton më i lartë në krahasim me vitet paraprake, kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve në ekonomi, por jo edhe për shkak të rritjes së aktivitetit ekonomik. Zgjidhja më e qëndrueshme dhe më e drejtë, në këto kushte do të ishte rritja e pagave e pensioneve dhe e ndihmave sociale, për të paktën aq sa është rritur niveli i përgjithshëm i çmimeve. Me këtë, Qeveria ose ka vendosur të pajtohet me varfërinë e qytetarëve nga rritja e çmimeve, ose ndoshta po planifikon që të vazhdojë praktikën e pakove të njehershme të ndihmave për kategori të caktuar të qytetarëve, të cilat nuk janë treguar efektive në adresimin e nevojave të tyre.

Ku mbeti Ligji i pagave që nuk po sillet në Kuvend? Në këtë Kuvend, ne kemi aprovuar edhe një rezolutë që do të sillet deri në muajin tetor, edhe pse tash kuptova se kostoja e këtij ligji është paraparë në buxhet, sipas ministrit. Por, me siguri ju mendoni që ky ligj do të mund të fillonte implementimin në vitin 2023? Çka është kjo? Unë mendoj që është vetëm mashtrim. Po, çka? Mashtrim i radhës.

Po i përmendi edhe nja dy projekte nga vij unë; ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në fshatin Orllan, për vitin 2023 janë ndarë 100 mijë euro, ka tre vjet që ka filluar ky projekt dhe ende nuk është përfunduar. Të më besoni që gypat edhe ora matëse më kanë ardhur që 1 vit te shtëpia ime. Kush nuk e di se ku është ky projekt, kisha pasur dëshirë ta di.

Gjithashtu, në projekt, ndërtimi i palestrës sportive në Podujevë, qendra rinore në Podujevë, janë para paraparë për 3 vite. Po jua tërheq vërejtjen, në tabela e ka parë një diçka që për mua ka qenë befasuese, asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Pakashticë. Po e përsëris, asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Pakashticë, 30 mijë euro; në Bajçinë, 30 mijë; Lladovc, 20 mijë euro; Pollatë, 20 mijë euro; Batllavë, 40 mijë euro; Peran, 30 mijë euro.

Sa rrugë do të mund të shtrohen me 20 mijë euro, po pyes? Mos-ndarja e mjeteve për asnjë çerdhe në Podujevë, kjo nuk ka arsyeshmëri.

Ky buxhet nuk rrefekton kërkesat e qytetarëve të Kosovës në ekonomi, në krijimin e vendeve të punës dhe në ngritjen e kualitetit të jetës. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Tani në radhë është deputetja Doarsa Kica-Xhelili.

**DOARSA KICA-XHELILI:** Faleminderit, nënkryetare!

Projektligji e analizova, dhe realisht objektiva kryesore në fushën e drejtësisë, ndër të tjera listohen: vetingu, luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në kuptim të luftimit dhe parandalimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, Ministria e Drejtësisë në vazhdimësi ka

theksuar që kryenismat e këtyre objektivave janë vetingu në sistemin gjyqësor dhe prokurorial dhe byroja.

Unë, dëgjova tashmë edhe deputetë të tjerë, të cilët përmenden që për këto projekte nuk ka linjë buxhetore, dhe ministri Murati u mjaftua me një përgjigje. Ju thatë që edhe për Gjykatën Komerciale s'kishte linjë të veçantë, por ne prapë ndamë buxhet.

Me këtë rast, unë dua t'ia kujtoj ministrit një gjë meqë edhe nuk i takon dikasterit të tij. Gjykata Komerciale është paralelja e fundit që mund ta ngresh për byronë dhe vetingun në kuptim përmbajtjesor, reformues, e madje edhe politik, simbolik.

Vetingu ka qenë pjesa më e zhurmshme e fushatës për drejtësi, e nuk e di që ndonjë qytetar i Republikës së Kosovës, reformat në drejtësi ndonjëherë i ka menduar si ristrukturim apo krijim të Gjykatës Komerciale. E kur na e kërkon votën për cilindo ligj si ministër i kësaj Republike, kërkoje edhe kushtetutshmërinë e ligjeve që i sillni.

Pa referencë në të kaluarën, derisa ju thirreni në ndryshëm, pakrahasim me të kaluarën, derisa thirreni në sundim të ligjit, sepse njëra pa tjetrën do të ishte ajo që ju po e quani hipokrizi.

Vetëm në Ministri të Financave, u përmend tashmë, që keni kontingjencë milionëshe. Në mënyrë plotësisht abstrakte referoheni në kontingjencë si diçka që mbulon gjithçka, kudo, kudo e sido. Por, këto dy projektligje që ne po i përmendim, pra, vetingu dhe byroja meritojnë që më së paku të kenë transparencë dhe reduktimi i rëndësisë që po ia bëni me referencë në rastin e Gjykatës Komerciale nuk është vetëm mostransparencë, në fakt, po e përcakton se si ju sot po e konceptoni reformën në drejtësi, në kuptim të buxhetimit, dhe nuk po flas për mbështetjen operative që i bëni institucioneve ekzistuese, sepse kjo duhet të jetë e natyrshme.

Prandaj, pyetjet tona janë legjitime. Pse nuk ka linjë buxhetore të veçantë nëse mund të ketë? A nuk po besoni që këto ligje do të kalojnë këtë vit apo gjatë tërë viti 2023, marrë parasysh që ju keni shumicën parlamentare edhe pa votën e opozitës, apo thjesht, kanë qenë të pamjaftueshme në pikën që ju të ndani linjë buxhetore të veçantë për to.

Nëse ju e reduktoni paralelen e këtyre dy nismave me Gjykatën Komerciale, atëherë ndoshta përgjigja ime për pyetjen e dytë tashmë u dha. Përndryshe, nuk mendoj që një seriozitet maksimal karshi këtyre nismave do të lihej plotësisht e pa reflektuar në projekt-buxhetin e vitit 2023.

Është edhe një objektiv tjetër në pjesën e drejtësisë në buxhetim që flet për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Një buxhetim të së njëjtës natyrë sikurse e bëni për arsim, për shëndetësi, nuk do të ishte ndonjë pengesë të bëhej për strehimore dhe qendrat për punë sociale.

Kjo nuk do të duhej të lihej në diskrecion të komunave, e as partive politike në pushtet, por të krijohen politika ku do të parashihej një buxhet fleksibil, analog me grantin për arsim apo grantin e shëndetësisë. Përndryshe, nuk mund të flasim për mbrojtje të viktimave derisa ato vazhdojnë të mos kenë as vend për t'u strehuar, e kur strehon, nuk dua as të flas për kushtet e padinjiteshme në cilat ato qëndrojnë për ato pak gjashtë muaj që mund të rrinë në këto strehimore.

Një çështje tjetër. Raporti i Progresit për herë të parë në Kosovë flet për një proces plotësisht transparent për përzgjedhjen e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës. Tani, ata që janë brenda institucioneve publike, përfshirë edhe juve, e kuptoni se sa kohë e vështirësi marrin reformat dhe sa me rezistencë takohen ato.

Dhe, ju e dini saktësisht se sa rezistencë e zhurmë u bë kur RTK anuloi me të drejtë për herë të parë në historikun e saj, kontratat e kundërligjshme mbi vepër. RTK tashmë ka anuluar 260 kontrata të kundërligjshme, pra në kundërshtim me Ligjin për prokurim publik. Megjithatë, është fatkeqësi dhe më duhet ta pranoj që një pjesë e madhe e kontratave të anuluar u kanë takuar edhe njerëzve që kanë punuar ndoshta shumë më shumë se këta punëtorë që sot janë të rregullt, jo të gjithë, por disa nga ta.

Derisa sot kemi diku rreth 40 milionë euro investime kapitale për kompani publike, të cilat as potencialisht nuk e kanë rifilluar as filluar ristrukturimin korporativ, RTK që për herë të parë po e dëshmon kursimin e parasë publike, po i përgjigjeni me buxhet të reduktuar karshi buxhetit që e kishte bordi i kaluar, i cili la aq shumë borxhe, borxhe të cilat sot po e ngufatin bordin e ri.

Nëse ju vlerësoni që RTK duhet të mbyllet, atëherë ta thoni publikisht, por ta thoni që ta dëgjojnë të gjithë, sepse me këtë buxhet të cilin ju sot ia keni lënë RTK-së me të gjitha borxhet që ata i kanë, i bie që kjo si ju tërthorazi e shihni RTK-në, si diçka që ju duhet ta mbyllni në mënyrë tërthore me reduktim të buxhetit.

Dhe, për fund, por absolutisht jo më pak e rëndësishme, Kosova mbetet ndër vendet e pakta demokratike, ku Linja e Jetës financohet vullnetarisht, e ku organizatat joqeveritare, iniciojnë nisma apo ligje për shëndetin mendor, ndër të tjera, për ta përfshirë linjën e jetës në buxhet të Qeverisë.

Nga data 8 gusht e këtij viti, Linja e Jetës shërben vetëm nga ora 2 e ditës në orën 2 të mbrëmjes, dhe po flas për Linjën e Jetës që vepron në kuadër të vullnetarizmit pikërisht për shkak të vështirësive me buxhet. Pra, nëse sot një i afërm juaji apo një qytetar i këtij vendi ballafaqohet me emocione sociologjike, e psikikisht të vështira e të papërballueshme, nuk ka adresë shtetërore që do ta ruante anonimitetin e tyre, teksa t'i ndihmonte ta tejkalojnë këtë moment të vështirë.

Pra, shteti ynë tentativave për vetëvrasje që janë shumëfish më të mëdha sesa vetëvrasjet, dhe familjeve të viktimave të vetëvrasjeve po vazhdon t'u thotë që ishin dhe fatkeqësisht vazhdojnë të mbesin vet.

Nëse s'më besoni, shikojini raportet e vetëvrasjeve, sidomos tentativave të vetëvrasjeve që po rriten çdo vit, dhe e kuptoni nevojën për alarmim, e të më besoni që me probleme të shumta shoqërore që i kemi, e të mos flas për ndikimin sociologjik që pandemia e kishte, jo vetëm te ne, por kudo në botë, e kriza financiare që po vazhdon të rritet për shkak të inflacionit dhe shumë shkaqeve të tera, ky nuk është fenomen që e meriton neglizhencën tonë.

Ata që ndjehen se janë vet, përfshirë nganjëherë nga familjet e tyre, e nganjëherë edhe vet familjet e tyre, së paku nuk duhet të ndjehet që nuk na kanë as neve. Prandaj, me mirëkuptimin tim maksimal, ju lus të reflektoni në këtë drejtim, sepse Linja e Jetës nuk duhet më të vazhdojë çështje e vullnetarizmit, por duhet të ketë buxhet dhe mbështetje nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Ne e falënderojmë zotin Kurti që na e prezantoi buxhetin edhe pse ministri ishte këtu prezent. Por, duke e ditur se sa i mirë ky buxhet, sigurisht s'ka dashur t'i lë vlerë dhe meritë ministrit, po që nuk është ashtu. Megjithatë, unë jam që zoti Kurti shkoi, sepse ka detyra edhe më të mëdha të bëj dhe nuk e di se si mund të vijë dhe të rehatohet aty dhe të meditojë në atë karrige, duke e ditur se sa lëmsh e ka bërë këtë shtet edhe qysh është gjendja e sigurisë në këtë shtet.

Folën parafolësit shumë për të gjitha kategoritë. Nëse asnjë kategori s'po e afekton ky buxhet, as s'po i afekton mjekët, as profesorët, as shërbyesit civilë, as pensionistët, as veteranët, kategoritë e luftës, as policinë, as ushtrinë, asnjë kategori, atëherë për kë e kemi bërë, ministër, këtë buxhet? Kë po e afekton? As rastet sociale.

A e dini ju si Qeveri se kur keni blerë pajisje për policinë e Kosovës? Kur keni blerë uniforma? Kur keni blerë mbathje për policinë e Kosovës, dhe kur do t'i blini, ose për ushtrinë e Kosovës? Ushtarëve të ushtrisë së Kosovës ua keni marrë çantat dhe i keni bartur prej Mitrovicës ua keni çuar në Gjilan regrutëve të rinj, edhe ajo çantë është individuale dhe personale dhe bartet prej një personi në një person tjetër.

Nëse është rritur numri i regrutëve dhe duhet të rritet edhe infrastruktura, dhe kjo nuk është e drejtë.

Folën shumë për padrejtësitë që po ua bëni komunave. Vërtet është padrejtësi që po ua bëni, dhe unë këtu, ministër, e kam një shembull ekzakt se çka u keni bërë komunave, sidomos komunave që nuk udhëhiqen nga ju, dhe sa buxhet keni ndarë për komunat.

Unë e kam një rast që mund ta dorëzoj, ministër. Është rasti i buxhetit që e keni ndarë për Komunën e Deçanit. Kjo çfarë keni bërë është turp, turp është. Dhe, po e lexoj, asnjë projekt i ri. Krejt këto projekte që janë, janë bartje e buxhetit prej vitit në vit dhe çka keni ndarë? Unë po i lexoj se cilat janë bartje dhe të shohim se çfarë jeni ndarë për Komunën e Deçanit, cili është një projekt i ri që e keni ndarë për Komunën e Deçanit.

Për bjeshkë, Deçan-kufiri i Malit të Zi, është vazhdimi i projektit dhe paratë e bartura prej këtij viti. Ndërtimi i rrugës qendrore në Deçan, bartje. Rruga në Bjeshkën e Strellcit-Deçan, bartje. Renovimi i sallës së Shtëpisë së Kulturës “Jusuf Gërvalla” në Deçan, bartje. Bile Donika Gërvalla është dashur të intervenojë këtu, se kjo shtëpi e kulturës e bartë emrin e babait të saj. Është dashur të intervenojë së paku bile për këtë vijë buxhetore, të ndajë buxhet. Por, s’po ka kohë as ajo të këqyre se çka duhet të ndajë dhe çka nuk duhet ndarë.

Shtëpia e Kulturës në Drenoc, bartje. Qendra Rinore në Deçan, bartje. Kompleksi Memorial “Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Zona Operative e Dukagjinit”, asnjë cent, bartje. Ndërtimi i shkollës së mesme të ulët “Lidhja e Prizrenit”, bartje. Ndërtimi i sallës së edukatës fizike për shkollën teknike, bartje. Ndërtimi i objektit të trashëgimisë kulturore, bartje.

Krejt çka keni ndarë, ministër, për Deçan, është ndërtimi i çerdhes në Deçan, ku i ndarë 75 mijë euro dhe ky projekt është për vitin 2024. Domethënë, asnjë lek nuk e keni ndarë për Deçanin.

Po flasim për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe po flasim edhe diasporën, të cilën e keni mashtruar dhe i keni marrë votat e tyre. Ju keni premtuar se do të hapni shkolla në gjuhën shqipe. Ju keni premtuar se do të hapni qendra kulturore. Dhe, çfarë keni bërë për diasporën? I keni mbyll edhe ato qendra kulturore ekzistuese dhe s’keni investim.

Gjatë vizitave që i kemi pasur si deputetë dhe me Komisionin për Punë të Jashtme, ambasadat dhe konsullatat janë ankuar për numër të vogël të stafit dhe për nënfinancim. Ne si komision u kemi premtuar se do të kërkojmë që ambasadorët dhe konsujt dhe gjithë stafi diplomatik të paguhet sipas vendit ku jeton dhe vepron, sepse nuk është e drejtë një ambasador të paguhet njëjtë sikurse ata ambasadorët në rajon dhe ambasadorët të cilët jetojnë në shtetet e tjera në të cilat inflacioni është tepër më i madh.

Dhe, merreni mend, për shembull, Ambasadën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e keni lënë me një ambasador dhe 2 të tjerë si staf. Aty ku duhet të zhvillohet diplomacia e vendit, ju e keni lënë pa përkrahje dhe pa individë. Dhe, çfarë keni bërë? Në vend që t’i plotësoni këto vende, në

vend që stafi diplomatik të shkojë atje, ju keni dhe po vazhdoni të shkarkoni pa paralajmërim staf diplomatik me një e-mail, dhe afati i lëshimit të punës, sot e merr e-mail-in është me automatizëm.

Po a po mendoni more që ata kanë familje? Ata kanë fëmijë nëpër shkolla dhe nuk guxon askush në atë formë ta trajtojë një diplomat, i cili i ka shërbyer shtetit të Kosovës në cilindo vend qoftë, bash në cilindo vend qoftë.

Ju supermenët e kësaj Qeverie që keni ardhur në Qeveri me shkopin magjik, keni ardhur me shkopin magjik, edhe Vjosa Osmani edhe Albin Kurti, edhe ti Hekuran Murati, edhe ministrja e Punëve të Jashtme, edhe Besnik Bislmi, a po e shihni se ku e keni sjellë këtë vend?

Dhe, unë mund ta quaj këtë buxhet, buxheti i gënjeshtrove. Dhe, ruaju ministër, se po ju rritet hunda si pinokëve dhe s'kemi çka kemi të tregojmë për këtë buxhet. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Ministri Murati e ka fjalën për t'i adresuar temat që u shtruan nga deputetët.

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Edhe njëherë vetëm për disa prej çështjeve që u ngritën e që mendoj që duhet të ketë replikë. U tha që është rritur buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nëse s'gabaj u përmend nga dy deputetë. Nuk është rritur, sepse kemi dashur t'i japim trajtim preferencial, por ka kaluar Agjencia e Statistikave në Zyrën e Kryeministrit, të nderuar deputetë, dhe është procesi i regjistrimit të popullsisë.

Andaj, edhe njëherë ju lus që ta lexoni buxhetin para se të jepni komente apo vlerësime për specifika të tilla.

U tha për nenin 9.6, që gjoja po ndërhyhet në kompetencën apo pavarësinë e komunave. Përkundrazi, ne kemi shtuar buxhetin e komunave, është 660 milionë euro për komunat. Ky nen çfarë bën, është sqarim i asaj që ka pasur keqkuptim në të kaluarën. Prapë do të vazhdojnë t'i bartin, ashti siç e parasheh Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Pra, të hyrat vetjake të vitit aktual, siç thotë ligji LMFPP-ja, barten në vitin tjetër, ato që janë të pashpenzuara. Dhe, nëse e lexoni me kujdes, thotë: "Të hyrat e vitit 2022 barten në vitin e ardhshëm fiskal".

Por, nuk mund të barten pafundësisht. Ta zëmë, mund të jenë 10 centë që kanë tepruar prej vitit 2018, ajo nuk llogaritet më bartje, sepse është bartur njëherë. Ky është dallimi. Pra, nuk kemi të bëjmë me ndërhyrje, është vetëm sqarim dhe rregullim, në mënyrë që të qartësohet çështja sa i përket të hyrave të bartura, do të vazhdojnë të barten për çdo vit fiskal siç edhe ka ndodhur.

Edhe një çështje tjetër. Prapë edhe këtu kemi të bëjmë me keqlexim të buxhetit. Pra, po u referoheni disa projekteve të cilat financohen ose parashihet të financohen me kredi. Tani, një



pjesë mund të kenë qenë edhe për çështje të studimit të fizibilitetit apo dizajnit që mund të jetë 200 mijë, 300 mijë apo 500 mijë euro, por pjesa tjetër është kredi. Kreditë zakonisht në buxhet reflektohen te klauzola e investimeve kapitale.

Prandaj, edhe njëherë ju lus, lexojeni buxhetin të tërin, të mos kapeni vetëm për kode individuale.

Normalisht, që ka sfida, ka projekte që nuk ka arritur të përfshihen në buxhet, ka funksione apo mekanizma që duhet të shtohen në buxhet, por të gjitha këto pra, po i bëjmë dhe do të bëhen në vazhdimësi. Kemi pasur edhe prioritete të tjera që keni thënë s'janë në buxhet, s'do të bëhen kurrë, por ja që i kemi bërë.

Patjetër që po duhet të merremi edhe me problemet që janë shkaktuar edhe me borxhet që na janë lënë edhe me obligimet që na janë lënë. Për shembull, është dashur të buxhetojmë edhe fillimin e rimbursimit të mjeteve të tërhequra nga Trusti në vitin 2020. Domethënë, ne po e paguajmë atë obligim, ju jo.

Sepse, e keni paraparë qëllimshëm që obligimi të bie te dikush tjetër, te Qeveria tjetër. Domethënë, me rëndësi ju ta merrni meritën, kurse obligimin ta marrë për bazë dikush tjetër. Domethënë, ka edhe shumë e shumë çështje e probleme të tjera.

Ta zëmë, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është dashur të rritet buxheti në mënyrë enorme, vetëm e vetëm për të mbuluar shpenzime për projektet ekzistuese, të cilat kanë qenë të buxhetuara kësisoj, 100 mijë euro, projekti 2 milionë, 500 mijë euro, projekti 5 milionë. Dhe për ato projekte normal që ka pasur zvarritje, ka pasur probleme dhe vonesa dhe tash ju po e dini që i keni shkaktuar ato vonesa dhe ato probleme.

Dëgjova këtu që dikush tha që Komuna e Dragashit, harrova cili deputet apo cila deputete ishte, tha që Komuna e Dragashit ka planifikuar bashkë-financim prej vitit 2013 për një projekt, tha po ju s'ia keni bërë. Tash, nëse e ka pasur bashkë-financimin prej vitit 2013, po i bie që nja 5-6 qeveri janë ndërruar, e asnjëra qeveri s'ia paska bërë, për më tepër ku ka qenë, patjetër ka qenë edhe njëjta në pushtet në nivel qendror dhe lokal, dhe tash po kritikohemi ne që nuk e paskemi bërë.

Unë mund të flas për projekte individuale, këto janë ministrat e linjës që mbulojnë, mirëpo si tërësi mund t'ju them që është buxheti më i mirë që kemi pasur ndonjëherë. Nuk është perfekt, do të ketë përmirësime gjatë viteve, sepse ende na kanë mbetur obligime dhe barra dhe probleme që na i keni shkaktuar në të kaluarën, të cilat me kohë po i rregullojmë, por si tërësi është buxheti më i mirë që shteti ka pasur ndonjëherë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputetja Time Kadrijaj ka replikë.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetare! Ju a jeni të vetëdijshëm për dëmin që po ia bëni Qeverisë edhe shtetit edhe qytetarëve të Kosovës me këtë qasje me buxhetin. Pse s'e keni sjellë Ligjin e pagave që do t'i rregullonte plot çështje?

A dini se veç brenda këtij viti, 187 mjekë i kanë braktisur institucionet shëndetësore publike? A di që kemi edhe migrim të brendshëm edhe migrim të jashtëm? A di që rrezikohet të mbyllet Klinika e Anesteziologjisë? Po rrezikohet të mbyllet Klinika e ORL-së, se po mbesin çdo ditë pa mjekë.

A e di sa janë listat e gjata të pritjes së pacientëve që po presin nëpër klinikat tona? Dhe, kjo për shkak të qasjes suaj të gabuar. Unë nuk e di se për çfarë politike po flisni. A e di se asnjë mjek më do të rri nëpër klinikat universitare e as nëpër spitalet rajonale me 500 apo 600 euro pagë. Askush.

Ju e keni tendencën e mbylljes edhe të institucioneve shëndetësore publike me këtë qasje. A e di se nëse një familjar shkon, në mungesë të anesteziologëve, janë listat e gjata të pritjes edhe nga 1 vit edhe nga 1 vit e gjysmë, se derisa t'iu vijë radha për t'u operuar në cilindo klinikë, ata ndoshta do të vdesin. Kjo është qasja juaj. Kjo është qasja e kësaj Qeverie që me mashtrime ka ardhur në pushtet, edhe me mashtrime po vazhdon ta gënjejë qytetarin edhe për buxhetin edhe plot çështje të tjera.

KRYESUESJA: Deputeti nga Lëvizja Vetëvendosje që është në radhë nuk e kemi këtu për momentin, kështu që po vazhdojmë me deputetin nga Partia Demokratike e Kosovës, Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur po shqyrtojmë Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, prezenca në sallë e Qeverisë, prezenca në sallë e deputetëve është dëshpëruese. Sa herë që është shqyrtuar Buxheti i Kosovës ka pasur entuziazëm, ka pasur shpresë se disa nga problemet e qytetarëve do të zgjidhen, ose thënë më drejtë, problemet e tyre do të adresohen me kërkesat e tyre, të cilat do të duhej të ishin pjesë e buxhetit, sepse ata janë kontribuuesit e këtij buxheti.

Kështu, me kaq dëshpërim, ku ministrat kanë planifikuar buxhetin për dikasteret e tyre dhe nuk vijnë këtu që ta mbrojnë dhe ta arsyetojnë, pra, është njëfarëlloj tërheqje totale edhe nga ajo që ata vet e kanë planifikuar, dhe kanë lënë, për fat të keq këtu, një ministër të paaftë që ka dëshirë

të bëjë pak politike me propaganda se si në të kaluarën kanë ardhur në pushtet, por pa adresuar problemet kryesore.

Në të kaluarën janë planifikuar e realizuar projekte infrastrukturore më të mirat në rajon. Në të kaluarën është adresuar me buxhet rritje e pagave, e pensioneve e asistencës sociale. Janë trajtuar kategoritë e luftës, e të burgosurit politikë, e çdo pjesë e shoqërisë tonë.

Për herë të parë ndodhë që Buxheti i Kosovës të arrijë në 3.2 miliardë dhe varfërie të jetë në shkallën më të lartë pasluftës, sepse inflacioni është i lartë, e Qeveria nuk e ka idenë se si ta ndalojë inflacionin, e as si ta nxisë zhvillimin ekonomik.

Nga viti 2007, kur Buxheti i Kosovës ka qenë 794 milionë, e deri te ky buxhet që është propozuar sot në 3,2 miliardë mesatarisht rritja e buxhetit për çdo vit në projeksion i bie të ketë qenë 24%. Po nëse e krahasojmë buxhetin e vitit 2020 me buxhetin e vitit 2023, na del që kemi një rritje të buxhetit për 9,1%.

Dhe, kur inflacioni është 19,2 e rritja e buxhetit është 9,1%, me çka po mburremi, me cilat shifra po mburremi, me shifra të varfërisë, kjo është e papranueshme.

Për herë të parë po ndodh që Qeveria vjen këtu edhe mburret me shifrat e varfërisë, me shifra të asistencës sociale. Jo vetëm raste sociale, por edhe studentët i kthen në lëmoshtarë, në vend se t'i mbështeste për studime, për projekte, për të pasur qasje në librari botërore, i mashtron me nga 100 euro për të përpjekur që t'ua merr votën, ndërsa me mega-premtimin për të siguruar punësim dhe zhvillim, ka dështuar, ka dështuar që edhe çifteve t'u sigurohen banesat që ua ka premtuar me program qeverisës dhe një gjë e tillë nuk është e planifikuar as pas vitit 2025.

Të nderuar kolegë,

Kam qenë pjesë e Kuvendit edhe kur është miratuar buxheti me rritje të pagave, e pensioneve e të gjitha kategorive të tjera. Derisa opozita atëherë kundërshtonte rritjen e pagave, sepse po e kundërshtonte një gjë të tillë FMN-ja. Ndërsa sot kemi ardhur në një situatë ku opozita po kërkon rritjen e pagave, edhe FMN-ja po kërkon rritje të pagave, vetëm Qeveria mrizon dhe nuk vepron. Ndërsa çdo ditë kemi ikje të mjekëve, profesionistëve të tjerë shëndetësorë, policët po braktisin vendin e punës, ushtarët gjithashtu e shërbyesit civilë.

280 kërkesa janë në vitin 2022 për demobilizim me FSK. 191 mjekë kanë ikur këtë vit nga Kosova deri më tani, kësi dëmi Kosovës nuk i është bërë as në kohën e okupimit. Kur bota shënoi 8 miliardë banorë, kur bota po shtohet, Kosova po zvogëlohet për shkak të dëshpërimit dhe mosmbështetjes së Qeverisë, edhe për shkak të korrupsionit e nepotizmit si dukuri që vazhdojnë të lulëzojnë në këtë Qeveri.

Të nderuar kolegë,

Nëse krahasojmë buxhetin për shëndetësi me buxhetin total të Kosovës dhe krahasojmë edhe me vite të tjera, shohim se në pjesëmarrje, në përqindje, ky buxhet është më i vogël. Në vitin 2020 buxheti i Kosovës ishte 2,6 miliardë, ndërsa buxheti për shëndetësi në total ishte 272 milionë, apo 11% pjesëmarrje totale në buxhet. Këtë vit kemi 296 milionë buxhet për shëndetësi e 3,2 miliardë buxhet apo përkthye në përqindje, 9,2% e buxhetit total. Nëse e krahasojmë me bruto produktin vendor të vitit 2020 dhe viti 2023, atëherë na del që kemi 3,1% e bruto produktit vendor krahasuar me 2020, kur ishte 3,4%, pra edhe këtu kemi ulje të buxhetit dhe Qeveria as kërkesat, të cilat kanë dalë nga Raporti i progresit nuk i adreson.

Në vitin 2020 është shpenzuar 54% e buxhetit për shëndetësi, këtë vit, më 2022, edhe më pak, ndërsa janë rritur keqpërdorimet, janë rritur abuzimet, janë rritur vjedhjet dhe këtë po e thotë Bekim Haxhiu, ky është konstatim i auditorit, i Zyrës Kombëtare të Auditorit, i cili prezanton keqpërdorime të mëdha në sektorin e shëndetësisë dhe Qeveria hesht dhe nuk i shkarkon përgjegjësit.

Pra, edhe nëse do të kishte një rritje 100% të buxhetit për barna, nuk do të plotësohej nevoja për të plotësuar listën esenciale, sepse barnat janë shtrenjtuar deri në 100%. Dhe nganjëherë vjen një situatë ku themi ndoshta edhe më mirë që nuk kanë investuar ose nuk kanë shpenzuar më shumë, pasi që kanë vjedhur shumë më shumë.

Buxheti i tretë që e propozon kjo qeveri dhe nuk ka planifikuar t'u rriten pagat mjekëve, profesionistëve të tjerë shëndetësorë, policëve, ushtarëve, zjarrfikësve, mësimdhënëse, shërbimit korrektues, shërbyesve civilë, e të tjerëve. Në këtë buxhet mungon kalkulimi i Ligjit të pagave, s'ka reformë pensionale, s'ka rritje të pensioneve, as asistencë sociale, as rritje për kategoritë e luftës. Investimet kapitale janë zero, shumë fjalë për inovacion, Departamenti i inovacionit ka zero investime kapitale. A ka më katastrofë se të shpenzosh në këtë kohë krize vetëm 5% të buxhetit në investimet kapitale për shëndetësi, e vetëm 2% të buxhetit është shpenzuar për sport, te investimet kapitale.

Stadiumi nacional ka ngecur, stadiumi "Adem Jashari" ka mbetur gërmadhë, e Qeveria mburret se ka rritur tash buxhetin. 57 milionë, ato mjete të cilat i ka pasur të planifikuara që t'i zbatojë gjatë vitit 2021 e 2022 nuk ka arritur t'i realizojë dhe stadiumi "Adem Jashari" do të duhej të përfundonte këtë vit, ka qenë i planifikuar buxheti, e keni prolonguar deri në vitin 2024 dhe nuk gjasa as atëherë të përfundojë.

Njëjtë ka ndodhur edhe me planifikimet e tjera infrastrukturore, në rrugën Mitrovicë-Prishtinë, në rrugën për Pejë, me rrugën për Podujevë, me rrugën Skenderaj-Komoran, buxheti i cili ka qenë vitin e kaluar, e keni transferuar për vitin e ardhshëm dhe këto projekte duhet të përfundojnë në vitin 2024 e 2025.

Zero investime në veri, për herë të tretë në buxhetin e tretë, zero investime në veri. Kjo Qeveri duhet të na tregojë a ka hequr dorë nga veriu, pse zero investime në veri?

Derisa shpenzimet për subvencione e për shpenzime të kabinetit janë rritur, besoni apo jo, numrat e të punësuarve në kabinetin e kryeministrit janë rritur. 109 të punësuar janë në zyrën e kryeministrit, shumë e keni kritikuar Ramush Haradinajn për kabinet megaloman, po jua kujtoj, 75 të punësuar kanë qenë në kabinetin e kryeministrit Haradinaj, kabineti i kryeministrit Kurti është 35% më i madh se i Haradinajt e 44% më i madh se i Hashim Thaçit në vitin 2014 që i numëronte 65 të punësuar. Dhe duhet të ketë një përgjigje, qytetarët duhen të dinë, kush janë këta njerëz 109 persona në kabinetin e kryeministrit dhe çfarë bëjnë ata, a po përdoren këta për të shantazhuar sindikalistët apo për të plotësuar nevojat në rrjetet sociale, çfarë bëjnë këta njerëz...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESJA:** Regjia ia mundësoni ta përfundojë fjalën deputetit.

**BEKIM HAXHIU:** Apo janë njerëz që përdoren për të shantazhuar të tjerët në rrjetet sociale.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk udhëhiqet shteti me logjikën e rrenave të Nasradinit, për shkak të lakmisë të këtyre qeveritarëve, për shkak të ambicieve të tyre për pushtet, këta vërtet janë shndërruar në Nasradina. Po ruajeni dinjitetin e deputetit, mos e votoni këtë buxhet që e shpërngul Kosovën jashtë, që qytetarët tonë e kërkojnë zgjidhjen jashtë Kosovës, mos e votoni një buxhet që nuk premtion zhvillim ekonomik, që nuk i rrit pagat për profesionistët shëndetësorë, as për policët e as për kategori të tjera, e as për ushtarët, mos votoni një buxhet të tillë, sepse vetëm sa do t'ua zgjatni jetën këtyre nasradinave.

**KRYESUESJA:** Ministri Murati ka kërkuar fjalën të sqarojë rreth diskutimit të deputetit Bekim Haxhiu.

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Megjithëse e sqarova në fjalimin paraparak, me gjasë deputeti Haxhiu nuk ka qenë duke dëgjuar, numri dhe buxheti tek Zyra e kryeministrit është shtuar, sepse është Agjencia e Statistikave aty, s'ka punësime, është Agjencia e Statistikave dhe ka të bëjë me procesin e regjistrimit të popullsisë vitin e ardhshëm, ky është sqarimi. Nëse kërkon reformën sociale të skemave sociale dhe pensionale, unë ju kam ftuar tashmë disa kohë, do ta falënderoj bashkëpunimi nga Grupi Parlamentar i AAK-së që e kanë mbështetur në vazhdimësi, mirëpo nevojiten 2/3 e votave për të kaluar marrëveshja për reformën e skemave sociale dhe pensionale. Ju ftoj edhe një njuhë, do ta sjell përsëri, jam i gatshëm të ulem me ju të diskutoj për çfarëdo sqarimi që ka nevojë që të kalojë ai projekt dhe të mundësohet reforma e skemave sociale dhe pensionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Haxhiu ka kërkuar replikë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetare!

Të jesh ministër i Financave dhe të mos dish të dallosh Zyrën e kryeministrit dhe Kabinetin e kryeministrit, kjo është huqje e madhe, nuk thashë të punësuar në Zyrën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, ku planifikohen në vitin 2023 të jenë 536 persona, vetëm Kabineti i kryeministrit, i nderuar ministër, mercenar edhe Nasradin, janë 109 të punësuar në Kabinetin e kryeministrit. Me këtë logjikën e Nasradinit, mos eja këtu të na arsyetohesh. E përmende Trustin, 100 milionë euro obligime atje, 200 milionë euro janë humbje të Trustit. Sille reformën pensionale këtu, sille Ligjin për reformën pensionale, mos sill marrëveshje ndërkombëtare për t'i mbuluar humbjet e vitit 2021.

KRYETARI: Ju kisha lutur që të keni kujdes në gjuhë, të lutem, jemi në Parlament, kemi qytetarë që na shohin, kështu që duhet të jemi shembull.

Tani radhën e deputetja Rezarta Krasniqi.

REZARTA KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

I nderuar ministër,

Po më vjen keq që ministra të tjerë të linjës nuk janë këtu.

Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 në aspektin e përgjithshëm është i varfër, nga që ka mungesë të theksuar të projekteve të reja në kuadër të investimeve kapitale. Kjo është evidentuar pothuajse në barë vendin, por unë sot dua të flas më tepër për vendin prej nga vij, komuna e Vushtrrisë, e cila është lënë anash nga Qeveria e Kosovës për sa i përket planifikimit si investime kapitale.

Merrni me mend, projektet që kanë qenë të planifikuara të realizohen gjatë këtij viti kanë qenë edhe në planifikimin e buxhetit të vitit të kaluar.

Bëhet fjalë për ndërtimin e rrugës Skenderaj-Vushtrri, përkatësisht në fshatin Krasmiroc, rregullimi i shtratit lumi Sitnica, ndërtimi i sallës së sportit dhe ndërtimi i Qendrës Komunale të Regjistrimit të Automjeteve.

Që të gjitha këto projekte që kanë qenë të planifikuara të përfundohen gjatë këtij viti, por nuk janë të realizuara, si rrjedhojë janë riplanifikuar të realizohen në kuadër të buxhetit për vitin e ardhshëm.

I vetmi projekt i ri që është planifikuar të realizohet në kuadër të investimeve kapitale në buxhetin e 2023, është ndërtimi vetëm i një çerdheje.

Tani është e panevojshme një investim i tillë, por i pamjaftueshëm, nga që komuna e Vushtrrisë po mbahet peng nga disa projekte që është dashur të përfundojnë tashmë.

Andaj unë sot, duke shprehur mospajtimet e mia me Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, kërkoj nga Qeveria që në kuadër të investimeve kapitale për vitin e ardhshëm të jenë: Renovimi i palestrës “Jeton Tërstena”, përmirësimi i infrastrukturës në stadiumin “Ferki Aliu”, një projekt me shumë rëndësi për zhvillimin e sportit, rikonstruktimi i urës së gurit, si aset i çmuar i trashëgimisë kulturore, i cili shërben për zhvillimin e turizmit. Ndarjen e mjeteve për Muzeun e qytetit, si dhe pranimin teknik të objektit me qëllim të funksionalizimit të tij, ku rreth 36 mijë euro kanë mbetur pa u paguar nga Ministria e Kulturës.

Po ashtu, meqenëse Ministria e Kulturës e ka futur në mbrojtje ish-objektin e gjykatës, është e nevojshme ndarja e mjeteve financiare për renovimin e atij objekti me qëllim të përdorimit për aktivitete të ndryshme.

Është e nevojshme ndarja e mjeteve shtesë në ndërtimin e lumit Sitnica, sepse është zonë e cila gjatë stinës së dimrit preken nga shumë vërshime pothuajse çdo vit.

Në kuadër të investimeve kapitale disa projekte të tjera që duhen me domosdoshmëri të përfundohen gjatë vitit të ardhshëm për çka unë kërkoj të ndahet buxheti i nevojshëm është edhe ndërtimi i rrethrotullimit në fshatin Pestovë, i cili ka qenë si amendament në vitin 2019, ndërsa sot ajo është hequr nga buxheti, po në këtë rast duhet të bëhet një nënkalim, në të cilën mund të kenë qasje të gjitha automjete, përfshirë edhe ato transportuese e bujqësore.

Një projekt tjetër infrastrukturor në të cilin janë stërzgatur punimet është edhe ndërtimi i autostradës Prishtinë - Mitrovicë, i cili është dashur që gjatë këtij viti të përfundonte, por siç duket me ardhjen e stinës së dimrit, edhe ky projekt do të ndalet ashtu si shumë edhe projekte të tjera.

Rasti konkret është edhe funksionalizimi i Spitalit të Pediatriisë në komunën e Mitrovicës, për të cilën e kam bërë edhe një amendament në vitin e kaluar dhe i cili ende nuk është përfunduar.

Për neve është e paqartë se ku ka ngecur ky proces në mungesë të ministrit të Shëndetësisë. Theksoj nevojën se objekti i ri i pediatriisë në qytetin e Mitrovicës duhet të funksionalizohet sa më parë, sepse është ambient ku aktualisht marrin trajtime të porsalindurit dhe fëmijët, ku nuk i plotësojnë kushtet minimale.

Ndërkohë ajo që dihet edhe është më se e qartë është fakti se Qeveria mban të bllokuara 700 milionë euro në Thesarin e shtetit, të cilat devaluuar pas shkallës së lartë të inflacionit që kanë goditur qytetarët tanë. Mjete këto që janë mbledhur në mungesë të investimeve kapitale, në mungesë të investimeve, nuk mund të llogarisin as në zhvillim ekonomik të vendit, e duke mos pasur zhvillim ekonomik rrezikojmë të mbesin pa profesionistë e punëtorë të kualifikuar, sepse si rrjedhojë nuk mund të ketë as rritje të pagave pa qarkullim financiar.

Në buxhetin e vitit 2023 nuk është reflektuar as Ligji i pagave, nuk ka buxhet për rritjen e pagave për sektorin publik, ndodh se parashikimet financiare flasin për inflacionin për vitin e ardhshëm që do të ngritët më shumë.

Prandaj, që nga fillimi theksova se ky buxhet për vitin 2023 është shumë i varfër. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani radhën e ka deputeti Shemsedin Dreshaj.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të vendit,

Sot debatojmë njëren prej pikave më të rëndësishme, buxhetin e Kosovës.

Unë si përfaqësues i një regjioni, i cili është anashkaluar komplet, do të fokusohem kryesisht në dy segmente të cilat kanë qenë në agjendën prioritare të partisë në pushtet dhe të qeverisjes aktuale. Pra, do të fokusohem më tepër në shëndetësi dhe në arsim.

Buxheti për shëndetësi merr pjesë me 9,2% në rang të buxhetit të propozuar nga ana e qeverisë sonë. Ka qenë prioritet qeveritar, por a është prioritet kur buxheti rritet për shëndetësi vetëm për 4,4% krahasuar me vitin paraprak, kur kemi pasur një situatë jo fort të mirë shëndetësore që të gjithë e kemi ditur.

Pra, shumë probleme si në aspektin e furnizimit në barna, si në aspektin e listës së pritjes, si në aspektin e ikjes së mjekëve nga institucionet publike.

Ajo çka është për t'u brengosur është që krejt investimet kapitale, të cilat nuk janë investuar në këtë vit, kalojnë në vitin tjetër, pra do të thotë në investime kapitale kanë qenë 0% të realizuara në segmentin e shëndetësisë.

A thua, me një buxhet të këtillë a mund të zgjidhen brengat e qytetarëve në Republikën e Kosovës, a thua a ka vend që mes këtyre dy leximeve shëndetësia të jetë vend debati dhe të kthehet në prioritet, pra ta bindim qytetarin që jemi duke menduar për shëndetin e tyre.



Përkujtoj që Ministria e Shëndetësisë ka rritje në totalitet, në përgjithësi të buxhetit diku rreth 13%. Por në aspektin e pagave kanë qenë 11 milionë dhe ngelin prapë 11 milionë. Pra, mjekët të cilët ishin deri dje heronj të vendit në luftë me pandeminë, a thua sot u lanë jashtë loje dhe u shndërruan në heronj në letër, e jo në vepër për shkak se pandemia veç ka rënie, të mos harrojmë, Kina ka filluar të mbyllet për shkak të rishfaqjes së koronavirusit.

Vërtet kemi bërë mjaft fjalë dhe premtime lidhur me Fondin e Sigurimeve, ju përkujtoj që zero është fondi për sigurime shëndetësore në këtë projektbuxhet.

Edhe arsimit nuk është më mirë, pra 73 milionë kanë qenë buxheti total, është rritur për 11%, kurse e dini që inflacionin e kemi 20%, pra do të thotë situata nuk pritët të përmirësohet.

Pagat fare nuk janë edhe pse sindikata ka qenë në greve dhe i është premtuar që pagat do të rriten, pra as s'e kemi Ligjin e pagave, po as s'e kemi buxhetin për rritje të pagave.

Fatkeqësisht edhe realizimi i investimeve kapitale në Ministrinë e Arsimit nuk ka shkuar mirë, diku rreth 20% për 9 muaj janë realizuar investimet kapitale, ndërsa mallra dhe shërbime diku rreth 52%.

Po ashtu dua t' ju përkujtoj që në këtë projektbuxhet nuk figuron fare Universiteti i Mitrovicës së Veriut, ai financohet nga këtu.

T'i kthehem pak Pejës, ku është rruga e vdekjes, Kijevë - Zahaq, janë diku rreth 30 kilometra rrugë që s'ka ditë të Zotit që nuk ndodh një aksident me lëndime, e besa- besë shpesh edhe me vdekje.

Për këtë rrugë keni paraparë diku prej Prishtine deri në Pejë rreth 4 milionë në buxhetin e ardhshëm, këto nuk mjaftojnë as për mirëmbajtje, le më për atë pjesë të riparohet. Të mos harrojmë se në atë pjesë gravitojnë rreth 600 mijë qytetarë të Republikës së Kosovës përditë.

Ku është rruga Pejë - Çakor? Nuk figuron fare, janë ndarë diku rreth 1 milion euro për mirëmbajtje, realisht ajo rrugë s'ka nevojë për mirëmbajtje, ajo rrugë ka nevojë për renovim komplet ose rrugë të re komplet.

I keni më shumë se 75 hotele dhe 230 firma që po funksionojnë në regjionin e Rugovës. Rrugova është ndarë nga Peja me këtë projektbuxhet.

Uroj që këto vërejtjet e mia që ju dhashë këtu sot për të mirën e qytetarëve të vendit që të futen mes këtyre dy leximeve dhe pastaj të kemi shansin që qytetarët tanë të kenë shëndetësi më të mirë, të kenë arsim më të mirë dhe të kemi siguri më të madhe në rrugë. Faleminderit.

KRYESUESJA: Tani radhën e ka deputeti Driton Hyseni.

DRITON HYSENI: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Si deputet i Kuvendit të Kosovës vlerësoj jashtëzakonisht shumë Projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2023 të prezantuar nga kryeministri i Kosovës, pra janë mbi 3.2 miliardë euro, të cilat do të jenë në dispozicion të përmbushjes së nevojave që qytetarët e vendit kanë nevojë.

Në mes të dy leximeve ne si deputetë do të trajtojmë aspekte të ndryshme të projektligjit, por sot dua të vë theksin te projekti i infrastrukturës rrugore, pra te projekti i rrugës Podujevë-Prishtinë, i cili ka nisur të zgjerohet në vitin 2016.

Të nderuar kolegë deputetë,

Sipas buxhetit të propozuar deri më tani në këtë projekt janë investuar 8 milionë euro, ndërsa për vitin 2023 janë planifikuar 6 milionë, për vitin 2024, 5 milionë euro ndërsa 2025, mbi 11 milionë euro.

Shpreh opinionin tim se kjo shtrirje ndër vite e vonon realizimin e projektit. Andaj dhe kërkoj që të kemi qasje ndryshe ndaj këtij projekti.

Të nderuar kolegë,

Konsideroj që projekti i kësaj rruge duhet të trajtohet me prioritet në buxhetin e planifikuar për vitin 2023 dhe për rrjedhojë, buxhetit të planifikuar prej 6 milionëve t'i shtohet buxhet i mjaftueshëm që mundëson kryerjen e punëve në këtë rrugë brenda vitit 2023.

Impakti negativ që ka mospërfundimi i shpejtë i zgjerimit të kësaj rruge është shumë i madh. Ajo ndikon në banorët e komunës së Podujevës, fshatrat përreth, por edhe shfrytëzuesit të tjerë të këtij segmenti rrugor, sidomos bashkatdhetarët tanë.

Dua gjithashtu të shpreh kënaqësinë që për shumicën e projekteve të infrastrukturës rrugore në vend është planifikuar buxhet i konsiderueshëm dhe uroj që këto të përfundohen sa më parë, por projekti i rrugës Podujevë-Prishtinë është nisur shumë më herët se sa disa prej projekteve për të cilat është alokuar buxhet disa herë më i madh. Andaj, kërkoj që për këtë projekt të shtohet buxhet dhe së bashku me projekte të tjera, edhe ky projekt të ketë mundësi, progresi substancial në vitin që vjen, e jo të mbetet si një projekt i zvarritur.

E njëjta vlen edhe për projektin që sa e përmendi kolegu Dreshaj, pra segmentin Kijevë-Zahaq, për të cilin janë ndarë vetëm 4 milionë euro. Uroj që në mes të dy leximeve të kem fokusin te

nevoja e shtimit të buxhetit në projektet, të cilat kanë nevojë më të madhe dhe të kenë një prioritet të projekteve të cilat janë nisur më herët ndër vite, e ato të mos anashkalohen prej projekteve që janë nisur shumë më vonë ndër vite. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Hisen Berisha.

HISEN BERISHA: E nderuar kryesuese,

Ministra në detyrë,

Të nderuar deputetë,

Për pompozitetin e prezantimit të Ligjit për buxhetin që e kemi dëgjuar çdo vit prejse jeni në pushtet, një përkufizim të mrekullueshëm e ka bërë deputeti Mustafa, kurse për retë e zeza po zinë sociale që vjen pas këtij buxheti e elaboroi në mënyrë perfekte dhe shumë të kuptueshme, edhe pse e veshi me atë fasadën e fajësisë 20-vjeçare deputeti i mazhorancës zoti Abazi dhe profesori i nderuar zoti Jahja Kokaj, para të cilit përulem me respekt.

Kurse fokusimi im është kryesisht aty ku jam më i ndjeshëm, pra në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, pra në Forcat e Armatosura dhe ato të Policisë që e cenojnë drejtpërdrejt sistemin e mbrojtjes dhe të sigurisë.

Pastaj në kategoritë e dala nga lufta që janë të diskriminuar dhe pothuajse tërësisht të përjashtuar nga sistemi financiar, përfshirë edhe veteranët, edhe invalidët, po edhe familjet e dëshmorëve me atë sistemin e pagesës sikur çmime tregu dhe sigurimet shëndetësore apo shtesat për rrezikshmëri, që po ashtu janë jetike për funksionimin e njësive që përballen me këso sfida. Por, në krejt këtë inkurajuese mbetet vazhdimi i mbajtjes në fuqi të buxhetit për infrastrukturën rrugore, kryesisht ashtu siç ka qenë në kohën kur ato janë tenderuar, por me një specifikë se tash përgjegjësia është bartur tek kompanitë ndërtuese, të cilat janë të hendikepuara me inflacionin, me çmimet e larta, me ikjen e krahut të punës, braktisjen e vendit nga rinia, po besa, edhe me çështje të korrupsionit gjatë këtyre kohëve sa kanë qëndruar “stend baj”, edhe pse kemi provuar t’i mbështesim me 20% të shpenzimeve për investime, e që është nën nivelin e inflacionit në shkallë vendi.

Rritja e buxhetit që u proklamua nga kjo qeveri është shumë e vogël krahasuar me nevojat që ka Forca për ngritjen e kapaciteteve bazuar në projektin për zhvillimin e këtyre kapaciteteve.

Ne jemi në vitin e parë të fazës së dytë të këtij projekti, ku duhet të krijohen kapacitet e para full operacionale, domethënë të plota operacionale për misionin kryesor që është mbrojtja e integritetit territorial të vendit, e jemi duke u përballur me hiç më pak se 15 projekte që janë bartur nga faza e parë. Pra, realizimi i këtij projekti ka mbetur shumë mbrapa.

Ka një rritje simbolike në çështje të investimeve kapitale, por që s'janë as për afërmi të përmbushen projektet e mbetura të fazës së parë, e lere më parashikimet apo planifikimin sipas topit, top do të thotë tabela organizative e pajisjeve, e cila po të analizonim mirë, nuk dua të flas në detaje për shkak të kodit të komunikimit për Forcën, po ikin atje brenda dhe do të shihni se i nevojitet, nëse flasim për kornizë afatmesme të shpenzimeve, hiç më pak se mbi gjysma e buxhetit që është ofruar.

Pse nuk ka rritje buxheti, dua ta ilustroj. Kjo është tabela nga rishikimi strategjik dhe plani kur është hartuar dhe është mbyllur në vitin '15. Nuk ka rritje buxheti nëse e marrim, për shembull, paga dhe shtesa janë ofruar 32 milionë e 103 mijë e 815 euro, këtu kanë qenë në vitin 2023, 40 milionë e 107 mijë e 162 euro.

Nëse e marrim edhe një shpenzimet kapitale i kemi sipas këtij buxheti tash, domethënë 47 milionë e 938 mijë e diçka, e kemi pasur në 42 milionë e 195 mijë e 356 që do të thotë po t'i shtojmë kësaj inflacionin dhe vitin indeks kur është planifikuar kjo ka qenë viti 2014, çmimet sot, avancimin e teknologjisë e tjera që imponojnë, ambienti i sigurisë siç ka ndryshuar, atëherë kjo është tejet e pamjaftueshme.

Po t'i shohim vetëm në aspektin e KASH-it, atëherë në vitin e parë të planifikuar të plantit gjithëpërfshirës të tranzicionit, po marrim veç personalin, ta zëmë. Në qoftë se këtë vit keni ofruar 37 milionë, viti i parë i ka pas 40 milionë, pa i përmendur këto shifra mbrapa. Kurse viti i dytë i ka pasur sipas projektit gjithëpërfshirës të tranzicionit 42 milionë, ky vit i ka 41 milionë.

Kurse viti i tretë sipas KASH-it të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit i ka pasur 44 milionë, kësaj here ja keni qëlluar, po më pak, 44 milionë edhe ju. Pra, po flasim jo më për rritje të buxhetit, po për një situatë që nëse i referohemi këtij buxheti që keni ofruar, në kontekst personelit konstatojmë se buxheti i ndarë nuk parasheh rritje, nuk e mbështet procesin e rekrutimit dhe nuk ka buxhet shtesë. Prandaj, mbajtja e stafit ekzistues ka mungesa në buxhet.

Unë dua të theksoj se ne duhet ta kemi parasysh se nga FSK-ja gjatë këtij viti ka pasur demobilizim pjesëtarëve dhe nga informatat e brendshme, çdo muaj janë larguar nga 16 pjesëtarë, shlyqyr Zotit që s'ka pasaporta, se s'ishin mbetur as qytetarët, as ushtarët, dhe pagat e ushtarëve dhe ushtarakëve në përgjithësi, ashtu si të gjithë qytetarëve kanë mbetur të parritura, ushtari i merr 422 euro bruto, kurse në neto i dalin në llogari 382 euro.

Prandaj, unë kërkoj dhe pres nga kjo Qeveri që ta kthejë buxhetin, edhe një herë ta shqyrtojë dhe kërkesën për rritje prej 5 milionë e 158 mijë e 483 euro që është propozuar dhe është kërkuar nga ministria dhe Forca, ta miratojë, për shkak se duhen 612 rekrutë të rekrutohen dhe për mbajtjen e personelit ekzistues në Forcë.

Ligji i pagave është ende i pafunksionalizuar, prandaj rritja e pagave për ta tejkaluar krizën deri atëherë dhe për të mbajtur personelin duhet së paku të përfshijë 25 deri 30%, përndryshe ky buxhet nuk e stimulon qëndrimin në Forcë, as aplikimin në Forcë. Ju jeni dëshmitarë që e kemi shkelur standardin dhe e kemi rritur edhe vitin e aplikimit për të qenë pjesëtarë i Forcës, sepse nuk ka mjaftueshëm kandidatë.

Tjetër temë që ishte e nevojshme gjithashtu të trajtohet, janë edhe sigurimet shëndetësore dhe shtesat për rrezikshmëri, që janë të domosdoshme për tërë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë, me theks tek Policia, edhe që shifra gjithsej e tyre do të jetë në 2 milionë e 500 mijë euro dhe bashkë me rrezikshmërinë kapin tërësisht 5 milionë.

Pra, edhe një herë dua të theksoj se një buxhet që e keni sjellë me vërejtjet e Fondit Monetar Ndërkombëtar se duhet t'i rritni pagat, ka qenë lajm medial, po i referohem, sjellja e atij në formën e ngutshme siç e keni bërë ju, besoj se nuk e mbështet zhvillimin e Kosovës, mbetet me të vërtetë buxhet, ashtu siç u përmend këtu, për supermarketet, apo mund të jetë një zhashkë për të mbuluar situatën politike në të cilën jemi, qoftë situatën e presidentes që ka ardhur në knap pozicion dhe ka mbetur figurë shahu në shahun politik të kryeministrit që shumë shpejt do ta djegë, sepse atë policin, oficerin që e çoi në Bruksel, veç po më duket do ta shpëtojë me propozimin e Lajçakut, apo të vetë kryeministrit që e ka situatën shumë të komplikuar në veri. Unë i kisha sugjeruar ministrit këtu që të miratojë edhe një linjë buxhetore për mercenarët, se përndryshe veriu prej dje veç është kthyer në Rezolutën 1244, atje patrullon EULEX-i e shumë shpejt mund të ketë edhe ndonjë zyrë të UNMIK-ut, a ku ta di unë. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Tani në radhë është deputeti Anton Quni.

**ANTON QUNI:** Faleminderit, zonja kryesuese!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ju kujtohet, kur para do kohësh këtu në Kuvend u fol për strategjinë e sigurisë së Kosovës, i pata listuar me arsytetime disa vërejtje dhe sugjerime, për të cilat kërkova që autoritetet e Qeverisë do të duhej t'i merrnin në konsideratë. Për fat të keq, nuk pati vullnet dhe gatishmëri që strategjia të rishikohej dhe ridizajnohej në një afat shtesë.

Si pasojë e një strategjie të dobët, natyrshëm edhe veprimet e radhës janë të dobëta. Kështu po ndodh edhe tani me planifikimin e buxhetit për vitin 2023 në sektorin e sigurisë. Në një ambient të ri të sigurisë, atë global dhe regjional, ndryshimin e formave dhe metodave të veprimeve kriminale dhe armiqësore, inovacioneve teknologjike, influencimeve nga superfuqitë jomike, është e pakuptimtë t'u përgjigjemi situatave të tilla në forma konvencionale, statike, të ngadalshme dhe joefektive. Thjesht, janë forma të tejkaluara.

Po jetojmë në kohën e bombardimeve nga propagandat dhe dezinformatat, në kohën e operacioneve inteligjente, sulmeve kibernetike, kontrollit të grupeve kriminele nga politika dhe regjimet, veprimeve të formacioneve paramilitare, kërcënimeve dhe shantazheve, grumbullimit të forcave policore ushtarake të Serbisë në kufirin me Kosovën, e tjera. Prandaj, kërkohet nga institucionet dhe organizatat e sigurisë të jenë me kapacitete të plota, me personel profesional dhe teknikë adekuate, mobile dhe të shpejta, të stërvitura mirë, të qëndrueshme, të motivuara dhe me moral të lartë, të mbrojtura nga politika ditore dhe ndikimet partiake, transparente dhe llogaridhënëse, bashkëpunuese dhe të besueshme për partnerët strategjikë, nën kontrollin dhe mbikëqyrjen civile dhe demokratike.

Të nderuar,

Po të merren të gjitha këto parasysht, në vitin 2023 do të duhej të shohim makinerinë e ndërtimeve, vinça e dozerë, armatë të tërë të ndërtuesve, duke ngritur komanda, qendra komunikimi, vëzhgimi, alarmimi, remonte, e të tjera, kabinete, poligone, pista, depo, rezervuarë, e të tjera. Do të siguroheshin burime të qëndrueshme të blerjeve, furnizimeve, mirëmbajtjes, ripërtëritjes, e të tjera. Do të ngriheshin kuadro profesionale, do të certifikoheshin njësitë deri tek tërësia e organizatës. Do të bëheshin marrëveshjet me partnerët e rajonit për konceptet “smart difence”. Do të ngriheshin qendra të lobimit për anëtarësim në NATO dhe Interpol.

Viti 2022, sipas raporteve për gjashtëmujorin e parë, ishte dëshpërues. Ministria e Mbrojtjes i shpenzoi vetëm 9% të dedikuara për projektet kapitale, kurse Ministria e Punëve të Brendshme vetëm 12%. Për këto dy ministri ky vit ishte inekzistent, apo vit i vjedhur. Për vitin e radhës Ministria e Mbrojtjes, zero projekte të reja. Të gjitha projektet po barten nga viti i kaluar, kurse për Policinë e Kosovës po ndahen vetëm 12 milionë për projekte të reja kapitale, që unë do t'i quaja më shumë projekte të mbijetesës.

Të nderuar,

U tha edhe më herët, në tetëmujorin e parë nga FSK-ja janë demobilizuar shtatëdhjetë ushtarakë, tani ndoshta numri është edhe më i madh. Kurse, nga Policia e Kosovës rreth 150 zyrtarë të Policisë. Politikat, strategjitë, objektivat, planifikime buxhetore po i demotivojnë zyrtarët në uniformë dhe, në të kundërtën, po i motivojnë të gjithë ata që nuk e duan sundimin e rendit dhe ligjit dhe një ambient të sigurt.

Është koha që Qeveria të mos kënaqet, apo vetëkënaqet, me fjalor, deklarime dhe postime populliste, por të rishikojë qasjen ndaj sektorit të sigurisë dhe të ndërmarrë vendime të duhura, racionale dhe të pranueshme. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)*

KRYETARI: Fjalën e ka Enver Dugolli.

ENVER DUGOLLI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të dashur deputetë,

Projektbuxheti total i Ministrisë së Mbrojtjes për 2023, ashtu siç u tha, është 123 milionë euro. Pra, është një rritje që nuk ka ndodhur më herët. Është rritja më e madhe prejse ekziston Forca e Sigurisë së Kosovës.

Rritja e buxhetit vjen në një situatë të re të sigurisë, që e ka krijuar lufta në Ukrainë dhe pretendimet e vazhdueshme që i ka shteti i Serbisë ndaj Kosovës. Republika e Kosovës është vend aspirant për të qenë anëtar i NATO-s dhe politika e jashtme e saj e sigurisë është tërësisht në harmoni me vendet trans-atlantike. Në këtë drejtim, me buxhetin prej 123 milionë Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes do të jenë në gjendje të blejnë armatime, të kenë furnizime, të zhvillojnë trajnime dhe shkollime për stafin e tyre dhe çdo planifikim tjetër në fushën e mbrojtjes.

Pra, për t'u lidhur me parafolësin, kolegun tim, që tha Ministria e Mbrojtjes ka zero projekte për vitin 2023, unë i kisha thënë kolegut se projekti i ushtrisë është ai që është duke vazhduar dhe vetëm mbështetja e Qeverisë është shtuar, për shkak se plani gjithëpërfshirës i tranzicionit i ka paraparë të gjitha mjetet, armatimet, infrastrukturën, resurset humane e të gjitha që i parasheh formimi i një ushtrie të mirëfilltë. Prandaj, është e pakuptimtë të thuhet që nuk ka projekte të reja.

Ky buxhet po krijon kushte për infrastrukturë më të mirë ushtarake dhe do të përshpejtojë procesin e përmbushjes sa më të shpejtë të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit, që ishte dhjetëvjeçar.

Për shkak të rrethanave të reja globale në fushën e sigurisë në të gjitha vendet e regjionit e përtej saj, kanë shënuar rritje të mëdha buxhetore të gjitha vendet për mbrojtje. Sigurisht, që vendi ynë në krahasim me vendet fqinje ka buxhet më të vogël, megjithatë kjo rritje është domethënëse marrë parasysh se me çfarë buxheti e kemi trashëguar Forcën e Sigurisë së Kosovës. Për rikujtim, sepse kolegët e mi nga fusha që mbulojnë e dinë, mirëpo plani gjithëpërfshirës i tranzicionit ka paraparë që vazhdimisht, gradualisht të rritet nga 5 milionë, jo më shumë, pesë milionë çdo vit.

Dhe, çka kemi bërë ne? Këtë rritje e kemi shumëfishuar, pra jemi shumë më herët sesa që është paraparë në vitin 2022 ky buxhet, të cilin ne sot po e shqyrtojmë.

Po flasim pak edhe për Ministrinë e Punëve të Brendshme. Projektbuxheti për Ministrinë e Punëve të Brendshme e kemi marrë dhe po e shqyrtojmë së bashku. Është më i larti gjithashtu që

është sjellë ndonjëherë në këtë Kuvend. Janë plot 179 milionë euro për shfrytëzim për realizimin e prioriteteve e për të arritur shkallën e efikasitetit në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike.

Mbi 115 milionë janë të destinuara për Policinë e Kosovës, e me këtë parashihet ngritje e kapaciteteve infrastrukturore, furnizim me municion e armatim, blerje e automjeteve të blinduara e mjeteve të veçanta, armë dhe pajisje speciale, softuerë, pajisje logjistike e pajisje të tjera për kontrollin e kufirit.

Pra, Qeveria Kurti i ka kushtuar rëndësi të veçantë sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë dhe kur flasin deputetët, kolegët e mi, që kanë qenë edhe pjesë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, por edhe kolegët e tjerë deputetë që kanë pasur rastin qeveritë e tyre të tregojnë që e mbështesin Forcën e Sigurisë së Kosovës, ushtrinë tonë, nuk e kanë bërë këtë. Prandaj, kur është në pyetje siguria e vendit, ushtria e Kosovës, këtu duhet ta pranoni që keni dështuar. Ndoshta, qëllimin e keni pasur të mirë, por nuk e keni mbështetur me financa. Me buxhet nuk e keni mbështetur.

*(Ndërhyrje)*

Ushtri në letër nuk ka. Ushtria kërkon buxhet, ushtria kërkon mbështetje. Prandaj, kur flitet për ushtrinë, ju kisha lutur që këtu bile të heshtni, sepse nuk keni të drejtë të flisni.

Edhe diçka krejt në fund, sepse u tha nga kryetari i komisionit, që nuk qenka këtu, po edhe një koleg deputet, që gjoja sot e kemi bojkotuar mbledhjen e Komisionit të Sigurisë. Nuk qëndron, është e pavërtetë, për shkak se ne nuk i bojkotojmë sikur i bojkotoni ju, por thjesht kryetari ka qenë i paralajmëruar paraprakisht për mungesën time për shkak të angazhimeve që kam pasur rreth kësaj seance. Faleminderit!

**KRYETARI:** Replikë, zoti Çuni. Edhe Hyseni, a? Mirëpo, le të fillojmë me zotin Çuni, se këtij iu ka referuar drejtpërdrejtë. Ti për shkak të temës po reagon më shumë. Urdhëro, zoti Quni!

**ANTON QUNI:** Zoti kryetar,

Ju lus vetëm për pak vëmendje, sepse kolegu Dugolli e ngriti një dilemë rreth asaj që unë deklarova më herët, se në projekte kapitale nuk ka projekte të reja, por janë bartur projektet nga viti i kaluar. Unë i jam referuar projektligjit që është hartuar nga Qeveria dhe nëse ka dilema tek unë, në atë që unë e kam deklaruar, janë dilema tek Qeveria që ashtu e kanë prezantuar në tabelë. Dhe, nëse Qeveria ka gënjyer, ju kam gënjyer edhe unë. Unë kërkoj falje, nëse një gjë e tillë ka ndodhur, por ashtu është e pasqyruar.

Do të thotë, të gjitha projektet kapitale nga viti 2022 barten në vitin 2023, ku nuk figuron asnjë projekt i ri kapital, apo ne e kemi ndonjë dokument tjetër që nuk përkon me atë që ju vetë e keni prodhuar! Faleminderit!



KRYETARI: Zoti Berisha. Në formë të replikës e keni kërkuar reagimin, a po?

HISEN BERISHA: E vërtetë që Forca nuk mund të ketë vit zero, sa u përket projekteve, domethënë zero projekte. Sepse, është një plan gjithëpërfshirës i tranzicionit, që e parasheh saktë se cilat objektiva do të arrihen, në cilin vit dhe në çfarë forme. Por, kemi të bëjmë me dështim në përmbushjen e objektivave të fazave, tri fazave kryesore, për realizimin e projektit të Forcave të Armatosura. Dhe, i kemi të bartura pesëmbëdhjetë projekte nga faza e parë. Kur them projekte, janë projekte që determinojnë krijimin e kapaciteteve që janë parashikuar në fazën e dytë, domethënë e bllokujnë, plus e rëndojnë në aspektin buxhetor.

Prandaj, nuk është e ndershme të spekulohet. Jemi dakord, se ashtu duhet të trumbetohet. Edhe një tjetër çështje çfarë ishte. U mundua të na faturojë “keni qenë”, “keni bërë, s’keni bërë...”. kur kam qenë unë në Forcë ti, zoti shoku im Enver, ke qenë edhe ti në Forcë dhe ti ke qenë përkrah dhe eksponent i ekspozuar i Partisë Demokratike. Pastaj, unë s’kam qenë fare përkrahës i partive, se kam mbajtur statusin e ushtarakut. Dhe e dyta, kur kam filluar unë të punoj në strategji të sigurisë e në projekt, e ku ta di unë, ti ke gëzuar pozita të tjera, që i ke përfituar po ashtu, nga Partia Demokratike, si ambasador, e ku ta di unë. Mos u mundo të hedhësh faj në njerëz, sepse këtu s’ka fajtor, por ka dështim në projekte. E dështimi në projekte fajet janë te Qeveria dhe mosmbështetja politike e buxhetore e këtyre projekteve.

Nuk na arsyeton asgjë në Forcë, aty nuk ka mundësi me u ndalë asgjë, se jemi duke punuar në partneritet me aleatin tonë kryesor, që janë SHBA-ja. Kështu që, lëre temën e spekulimit rreth ushtrisë, mundohuni me e përkrah buxhetin ashtu siç ka Forca.

Sa i përket investimeve në projekte, po ta them, gjysma e buxhetit të sotëm nuk e mbështet topin, pajisjet që janë planifikuar të blihen tash, si CASH po flas.

KRYETARI: Pse ke dalë prej PDK-së, Enver? Enver Dugolli e ka fjalën. Me siguri ka me thënë “Të kishte qenë mirë, kisha qëndruar aty”.

ENVER DUGOLLI: Faleminderit, kryetar!

Edhe një herë po e rikonfirmoj, se plani gjithëpërfshirës i tranzicionit e ka paraparë këtë ngritjen graduale, që thashë, e tash e mora më saktësisht, në 2018 ka qenë 54 milionë, ndërsa në 2027, kur parashihej të përfundonte ky plan, 109 milionë. Pra, ne e kemi rritur shumëfish më shumë.

Ndërsa, sa u përket shpifjeve që po bën ky kolegu, po dua t’i them veç një fjalë, unë kam qenë oficer i Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe ligjërisht asnjë oficerit nuk i lejohet të aderojë në një parti. Sikur unë të kisha pasur aderime, apo dëshirë që të shkoj në PDK, do ta kisha bërë, por unë nuk e kam zgjedhur, sepse s’e kam parë opsion dhe po shihet që zoti Berisha, pasi që nuk e mori LDK-ja, shkoi në PDK për inat të LDK-së. Kjo është e vërteta.

KRYETARI: Jo, Blerta Deliu tash e ka fjalën. A replikë? Veç pak, Blertë. Replikë pati Enveri, po ky ka kundër-replikë. Në cilin diskutim, për çfarë replike? Për Enverin, a? Po, Enveri e ka pasur kundër replikën me Hisenin.

*(Ndërprerje e incizimit)*

Kështu është fort e ndërlikuar të kërkohet. Ndërlikohet shumë dhe as Rregullorja nuk e parasheh këtë punë, por po e bëjmë një përjashtim, se ai ka pasur kundër- replikë. Tash në kundër-replikën e tij ti po kërkon replikë, a po kupton? Urdhëro, urdhëro! Veç, referoju saktë cilës pjesë për çka të ka thënë.

RASHIT QALAJ: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, është vetëm një e vërtetë, që sot kemi pasur takim të Komisionit për Siguri dhe Mbrojtje dhe temë ka qenë Ligji për pensionimin e parakohshëm të Policisë së Kosovës.

Është e vërtetë që të gjithë ne si deputetë kemi pasur angazhime për këtë ligj dhe buxhet, bile-bile ne si opozitë ndoshta edhe pak më shumë. Por, të njëjtën kohë është e vërtetë që përveç zotit Humolli, asnjë nga deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje nuk kanë marrë pjesë në takim.

Kryetar, po e them këtë sepse në atë komision e kemi një unitet mjaft të mirë dhe të gjitha ligjet gjithmonë i kemi votuar dhe i kemi proceduar në Kuvend me një, sikur me qenë një trup. Dhe, është hera e parë që deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje të organizuar e bojkotojnë një ligj, i cili besoj se në rrethanat aktuale është njëri ndër projektligjet më të rëndësishme për momentin në këtë vend, meqenëse po flasim për sigurinë tonë, po flasim për policët, të cilët edhe në këto kushte, siç e dinë të gjithë, janë duke u angazhuar orar e pa orar, me dymbëdhjetë orësh, me sakrificë e shumë punë, në pjesë të ndryshme të vendit, që me krenari shërbejnë.

Por, ne si institucione nuk jemi duke bërë mjaftueshëm që së paku të kujdesemi për mirëqenien e tyre. Është jokorrekte që zoti Dugolli, kolegu im, që kemi raporte të shkëlqyeshme në komision, tash mundohet ta hedhë topin dhe të mos e tregojë të vërtetën. E vërteta është që në komision sot jemi bojkotuar nga deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje për këtë projektligj, i cili, prapë po them, është i një rëndësie shumë të madhe duke iu referuar kohëve që po jetojmë, po edhe sfidave që Policia e Kosovës po përballlet për çdo ditë.

Kjo ishte, në fakt, një replikë ndaj kolegut, edhe pse s'i kam fort merak replikat. Faleminderit!

KRYETARI: Hisen, s'ke të drejtë t'i reagosh Rashitit, çka... po tash, si t'i kthehemi prapë Enverit atje? Shiko, Hisen, kërkoje fjalën me kohë, se kalon e pastaj edhe nuk mund t'i kthehesh. Jo, këtu s'je hiç. Këtu... dëgjo, kërkoje fjalën me kohë edhe bëma me shenjë me dorë,

mundësisht. Qe, Ganja e di këtë procedurë shumë më mirë. Më tregon diqysh me shenja që është...

Urdhëro, një minutë!

HISEN BERISHA: Unë nuk kam dëshirë të lëshohem në fyerje, sepse fundja ne kemi qenë shokë bashkë në ushtri. Edhe kur e përdorim ndonjë fjalë sa për sarkazëm, nuk është se e kam me tendencë ta fyej, por nëse flasim se unë kam “shpifur” për buxhetin çfarë ka qenë, po ua lexoj për dhjetëvjeçarin, që nga viti i parë.

Në dokumentin e rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë e keni: viti i parë 74 673 000; 79 269 000 i dyti; i treti 85 800; 105 237 është këtë vit, që krahasuar me 2015-ën është 18 milionë më shumë i propozuar e me vitin e kaluar e kap 23 milionë. 98 milionë është viti i gjashtë, 112 257 000 i shtati, 123 milionë i teti; 124 milionë i nënti; 136 i dhjeti. Pra, unë nuk flas përmendësh, Enver! Kam punuar tre vjet në projektin për Forcat e Armatosura dhe gjithçka e kam të saktë.

KRYETARI: Valentina Bunjaku-Rexhepi e ka fjalën.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat!

Për ju kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në projektbuxhetin jam fokusuar në tri gjëra të buxhetit, domethënë në komunën e Gjilanit, prej nga vij unë, në fushën e Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri dhe Tregti, si dhe krahasuar buxhetin sa është rritur dhe zvogëluar, krahasuar me buxhetin e vitit 2022 e sidomos, kur Qeveria vetëfalënderohej për rritjen e buxhetit e të shohim se si është orientuar ky buxhet për zhvillimin e vendit për investimet kapitale dhe shumë fusha tjera të rëndësishme, si energjia e kështu me radhë.

Në parim jam shumë e zhgënjyer me projektbuxhetin. Do të filloj me zhgënjimin për buxhetin në komunën e Gjilanit, e më pas në fushat që mbulon komisioni im.

Totali për buxhetin e vitit 2023 për komunën e Gjilanit është 29 075 278 euro, pa planifikuar financimin e jashtëm dhe huamarrjen. Pra, komuna e Gjilanit, edhe pas inflacionit dhe pas lavdërimit se ka rritje të madhe të buxhetit nga Qeveria e Kosovës në projektbuxhetin e vitit 2023, vjen me rritje vetëm tre milionë euro. Çka janë tre milionë euro për një komunë kaq të madhe si komuna e Gjilanit, si dhe tatimpaguesit të dytë në Kosovë për nga rëndësia dhe për nga popullsia në komunën e Gjilanit. Kjo rritje tregon se është false dhe është zvogëluar buxheti në shumë fusha të tjera, sikurse edhe në projekte kapitale.

Për çështje administrative për këtë vit buxhet prej 894 453 eurosh i bie dukshëm ka rënë buxheti në këtë nënprogram. Inspektimet ishin me buxhet 308 193 euro, kurse tash më pak kanë vlerë, 306 800 euro. Zyra e Kuvendit Komunal është 199 500 euro, kurse tash ka rënë në 201 000 euro, domethënë 1 500 euro rritje, shumë paka për vitin rritja e zyrës së Kuvendit Komunal.

Zyra komunale për komunitete dhe kthim kishte 55 576, kurse tash ka më pak 3 500 euro për projektbuxhetin e vitit 2023. Personat me aftësi të kufizuar kanë vështirësi të ngjiten shkallëve të këtyre zyrave, e lëre më t'i eliminohet dhe zbritet buxheti këtyre personave. Planifikimi urban dhe inspektorati është 727 177 euro, duke rënë buxheti në 577 500 euro për vitin 2023. Shërbimet e shëndetësisë primare me një rritje të lehtë dhe larg nga nevojat që kanë këto shërbime shëndetësore.

Shërbimet sociale në Gjilan - edhe këtu ka një rritje të vogël, por nuk është e mjaftueshme. Teatri i Gjilanit është ndër teatrot më aktivë në Kosovë, me suksese edhe jashtë vendit, ia keni shkurtuar gjatë këtij viti 349 euro. Pse nuk ua keni shkurtuar bile 400 euro, po veç 349 euro. Stadiumi i qytetit ka mbetur nën hije dhe në fatin e kësaj Qeverie dhe absolutisht nuk dimë gjë për fatin e stadiumit të qytetit, edhe pse e dimë qartë dhe të gjithë opinionin dhe Kosova dhe përtej Kosovës janë të njoftuar për derbin e madh Drita dhe Gjilani, që zhvillohet në këtë stadium, është prishur kontrata e nënshkruar më herët dhe tani nuk kemi asnjë datë të specifikuar se kur do të përfundojë ky stadium në qytetin e Gjilanit, edhe pse ka pasur premtime se do të caktohet data se kur do të përfundojë ky stadium.

Dhe, e dini që sinqerisht të dy klubet dhe shumë klube të tjera jeni duke i dëmtuar në komunën e Gjilanit, që nuk po përfundon puna në stadiumin e Gjilanit. Fusha në Zhegër ende nuk ka përfunduar. Arsimit parashkollor në Gjilan është zvogëluar dhe prandaj kundërshtoj ashpër që ia keni zvogëluar buxhetin arsimit të mesëm dhe të lartë në komunën e Gjilanit. Është e papranueshme dhe e dëmshme. E në anën tjetër, kërkoni cilësi në arsim dhe investimet janë shumë të vogla.

Universitetit të Gjilanit ia keni zvogëluar buxhetin në 2 312 204 euro. Si është e mundur që për arsim në Gjilan e keni zvogëluar buxhetin? Ia keni gërryer buxhetin Universitetit Publik të Gjilanit, e kinse e keni rritur buxhetin për 20 mijë euro për arsimin në përgjithësi dhe ia keni zvogëluar buxhetin arsimit të mesëm të lartë.

Universitetit të Gjilanit rritjani buxhetin, është ndër universitetet më të ndërkombëtarizuara në Kosovë. Ka projekte të panumërta me programe si Erasmus-Plus, vizita e studentëve në Zvicër dhe shumë vizita të tjera. Buxheti duhet të rritet edhe në bazë të performansës. Gjeneroj një universitet tjetër që ka më shumë përfshirje në projekte ndërkombëtare, se sa Universiteti i Gjilanit dhe ende nuk keni bërë asgjë për Kampusin Universitar. Nuk po them veç kjo qeveri, po

të gjitha qeveritë, asnjë lëvizje nuk e kanë bërë rreth Kampusit Universitar dhe kjo është më se e domosdoshme.

Te projektet kapitale në nivel qendror, ndërtimi i Kampusit Universitar “Kadri Zeka” parashihet të ndahen 100 mijë euro. Pse e zvogëluat buxhetin në 300 mijë euro Universitetit të Gjilanit, e në buxhetin e vitit 2022 projektionet ishin që të kishte jo siç është tash 100 mijë euro, por 400 mijë euro. E kundërshtoj këtë zvogëlim prej 300 mijë euro të Universitetit “Kadri Zeka”, sepse është i pamjaftueshëm buxheti aktual.

Në rrugën nacionale Prishtinë - Gjilan - Konçul vlera totale e projektit është 66 156 501 euro, kurse në projektbuxhetin e 2023-ës janë ndarë 27 milionë euro, ama jo me mjete të reja për vitin 2023, por me vazhdimin e vitit 2022, që është ndryshe. Shihni tabelën 3.2 të projekteve kapitale në nivel qendror dhe bindeni se është kështu qysh po them unë. Domethënë, tabelën 3.2. Gjersa, me buxhetin e vitit 2022 parashihej që në vitin e ardhshëm 2024 buxheti të ishte për këtë rrugë rreth 20 milionë euro, me projektbuxhetin e vitit 2023 për vitin 2024 projektionet janë vetëm 5 milionë euro. Si u bë që për vitin 2024 u zvogëluan projektionet prej 15 milionë euro për këtë rrugë kaq të rëndësishme për komunën tonë?

Ndërtimi i impianteve për ujërat e zeza në Gjilan janë ndarë vetëm 6 977 510 euro, ku vlera totale e projektit është 20 932 530 euro. Pse u zvogëlua buxheti edhe për ndërtimin e impianteve për ujërat e zeza?

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk e votoj këtë projektbuxhet, në qoftë se nuk futen me amendamente këto kërkesat e mija. Pa e përfshirë ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza dhe rritjen e buxhetit për komunën e Gjilanit, pa rritjen e buxhetit për Kampusin e Universitetit “Kadri Zeka”, pa e rritur buxhetin për infrastrukturën e Gjilanit, investimet hyrje-dalje të Gjilanit dhe të gjitha investimet kapitale. Nuk pajtohem me këtë projektbuxhet as për fushat ku mbulon Komisioni për Ekonomi, Tregti dhe Industri. Domethënë, zyra e Rregullatorit për Energji është 153 000 euro më pak, domethënë 16,1% më pak ka investime në zyrën e Rregullatorit. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për buxhetin e vitit 2022 në shumën prej 344 996 euro, kurse në projektbuxhetin e vitit 2023 ka rritje prej 14,17% të buxhetit në shumën prej 393 860.

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka rritje të buxhetit. A keni thënë ju si Qeveri se do të shuani AKP-në? A e keni marrë parasysh premtimin e Qeverisë për shuarjen e AKP-së, ndërsa keni ndarë mjete jashtëzakonisht të majme për AKP-në. Departamenti i industrisë ka 131 426 euro për vitin 2023, kurse në buxhetin e vitit 2022 kishte 153 987 euro, që i bie tash ka më pak se që kishte në vitin paraprak.

Departamenti i tregtisë në vitin 2023 ka vetëm 189 285 euro, kurse gjatë vitit të kaluar kishte 386 716 euro, dyfish më pak se vitin e kaluar.

Divizioni për investime dhe strategji ka 196 502 euro, me një rritje rreth 90 mijë euro gjatë vitit 2023, që është shumë pak pasi që ka të bëjë me investime strategjike.

Regjistri Kosovar i Bizneseve ka 249 467 euro, kurse kishte 231 185 euro, domethënë këtë vit ka rritje.

Ndërmarrësia aktualisht ka 37 712 euro, kurse vitin 2022 kishte më shumë gati dyfish, 53 618 euro.

Të nderuar kolegë deputetë,  
Projektbuxheti i vitit 2023...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Po, urdhëro, por më duket e morëm thelbin, se çfarë po do të thuash. Urdhëro, fjala është e juaja, zonja Bunjaku.

**VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI:** Nuk e di, kryetar, a e keni marrë thelbin, se kam pas shumë për të thënë, veç desha në fund të potencoj, domethënë Projektligji i buxhetit për vitin 2023 është kundërkushtetues, sepse cenon pavarësinë e pushtetit lokal, neni 9 i Ligjit të buxhetit 2023, paragrafi 6 e ka shtuar pasusin. Të gjitha të hyrat vetjake të mbledhura para vitit fiskal 2022 dhe të shpenzuara bëhen pjesë e fondit të Kosovës në bilancin bankar.

Pse komuna duhet t'i kthejë mjetet Qeverisë dhe në qoftë se, bie fjala, që komuna duhet t'i kthejë mjetet Qeverisë, të cilat nuk mund t'i shpenzojë, atëherë ministritë që kanë pasur progres zero.

Shumë ministri, kujt duhet kthyer mjetet? Kështu që unë nuk pranoj këtë projektbuxhet të vitit 2023, sidomos në qoftë se në amendamente nuk na përkrah, amendamentet të cilat do t'i propozoj unë për komunën time. Faleminderit!

**KRYETARI:** I kërkohet ndjesë Blerta Deliu-Kodrës, sepse e kalova më herë. Fjala është e juaja znj. Deliu-Kodra.

**BLERTA DELIU-KODRA:** Faleminderit, kryetar!  
Kolegë deputetë,  
Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë e kuptoj që është thënë shumë, se jemi që nga orët e hershme të mëngjesit duke diskutuar për njërin prej dokumenteve më të rëndësishme që është Projektbuxheti për 2023, por ajo që duhet të thuhet është se në fakt as për së afërmi projektbuxheti nuk i reflekton nevojat e qytetarëve të Kosovës, sidomos në përballje me inflacionin, në përballje me çmimet e larta, me paga e ulëta në sektorin publik dhe atë privat.

Nuk ka asnjë rritje të pagave për mësimdhënësit, për mjekët, për shërbyesit civilë, për policët, zjarrfikësit e deri te punëtorët e sektorit privat. Pra, edhe pse kryeministri më herët tha që është ndër buxhetet më të larta ndonjëherë, inflacioni rreth njëzet për qind në bazë të raportit të Bankës Botërore e zhvlerëson edhe këtë rritje të cilën e përmendi Kryeministri. Në fakt, të vetmen rritje reale që po e shohim shumë hapur, është rritja e luksit për qeveritarët. Krahasuar me vitin paraprak ku shpenzimet për mallra dhe shërbime, paga e shtesa kanë qenë 74 milionë më shumë, në vitin 2023 Qeveria ka paraparë gati trefishim të buxhetit, pra 164 milionë euro. Pra, 164 milionë euro kolegë deputetë për luksin e Qeverisë Kurti.

Po i kthehem raportit të fundit për vendit, ku të gjeturat flasin për 18 për qind të qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët jetojnë në varfëri. Me vetëm 1,5 euro në ditë, d.t.th. një euro e gjysmë në ditë i kanë tetëmbëdhjetë për qind e qytetarëve të Republikës së Kosovës. 5,1 për qind e popullsisë jetojnë nën pragun e varfërisë së skajshme. E për këta të fundit, pra për qytetarët e Kosovës që jetojnë nën pragun e varfërisë së skajshme, kryeministri Kurti me qindra herë është deklaruar se nuk do të lejojë kurrë një gjë të tillë.

Në fakt, çka po bën ai sot, po e mirëmban këtë gjendje të mjerë me këta qytetarë, të cilët vazhdojnë të përballen me varfëri të skajshme. Nëse i referohemi të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, që nga viti 2019 deri në vitin 2021, 1 514 familje në Kosovë i janë shtuar listës së asistencës sociale. Pra, për tre vjet sa është Qeveria e Lëvizjes Vetëvendosje në pushtet 1 514 familje janë shtuar në listën e asistencës sociale. Në vend se Qeveria të kujdeset për këto kategori, ajo rrit buxhetin për vete, pra buxhetin për Zyrën e Kryeministrit, i cili këtë vit është paraparë të rritet për 5,8 milionë euro, apo më mirë të themi 35,8 për qind më shumë sesa vitin e kaluar. Nga 16 mijë sa ka qenë në vitin 2020, në 21 mijë milionë euro në vitin 2023. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur për shtatë milionë euro në Zyrën e Kryeministrit, pra nga pesë milionë sa kanë qenë në fakt këtë vit, parashihen dymbëdhjetë milionë euro për mallra dhe shërbime në Zyrën e Kryeministrit.

Të nderuar kolegë,

Si opozitar, Albin Kurti akuzonte atëkohë Qeverinë kur buxheti për Kryeministrin ishte më i lartë se ai për Kuvendin e Kosovës. E kujtoj si sot që ai në deklaratimet e tij për buxhetin e vitin 2018 thoshte se nuk mundet një shtet parlamentar të jetë buxheti për Zyrën e Kryeministrit më i lartë se buxheti për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Besa-besa, ai shkonte edhe më tutje, thoshte a është Kosova shtet parlamentar, apo është shtet kryeministror. Unë sot nuk e kam

Kryeministrin këtu, por sot po e pyes me të drejtë atë, çfarë është Kosova sot me këtë rritje të buxhetit të Zyrës së Kryeministrit? A është Kosova shtet qeveritar, apo është Kosova shtet parlamentar, apo më mirë të them shtet kryeministrit, siç e thoshte Albin Kurti si lider i opozitës.

Kryeministri u deklarua që buxheti për shëndetësi do të jetë më i larti ndonjëherë. Kam fare pak besim që kjo do të reflektojë në përmirësimin e gjendjes të cilën ne sot e kemi në këtë sektor. Tash e sa muaj unë shoh shumë qytetarë që në emergjencë sot përballen sot me mungesë të karrocave. D.m.th. është çështje thelbësore që të ketë karroca për të lënduar në Qendrën Klinike Universitare, në emergjencë. Pra, e kemi parë përpjekjen e kryeministrit që duket sikur ai vetë po i merr frenat e shëndetësisë. Edhe me këtë rritje të premtuar, pjesa më e madhe e buxhetit do të shkojë për mallra e shërbime. Pra, prapë se prapë ai i cili do t'i vuajë pasojat, do të jetë qytetari i Kosovës, i cili do të vazhdojë të blejë barna me çmime të larta pa sigurime shëndetësore dhe fare pak pres që të kemi zgjidhje edhe për listën e barnave esenciale të cilën sot e përmendi Kryeministri.

Sa i përket fushës së arsimit, tridhjetë për qind e vendit është në arsim sot, në çerdhe, në shkolla fillore e të mesme, në universitete, e për krejt këto janë ndarë vetëm 285 milionë euro. Pra katër për qind më shumë sesa në buxhetin e vitit 2020. Kryeministri deklaroi më në fund se e kanë paraparë ndërtimin e njëmbëdhjetë çerdheve. Edhe pse ky është një lajm i mirë, kjo as për së afërmi nuk i përmbush nevojat dhe premtimet e kryeministrit për ndërtimin e 160 çerdheve, të cilat i ka premtuar në fushatën zgjedhore.

Në anën tjetër, ju si Qeveri, Kryeministri i cili nuk është këtu dhe Qeveria Kurti, e dini që keni ardhur në pushtet me mbështetjen më të madhe të grave ndonjëherë. Nuk keni paraparë dhe s'keni projektuar një linjë të veçantë buxhetore për këtë kategori. S'ka ende një buxhet të ndarë dhe s'ka buxhetim gjinor të Qeverisë, kur kemi parasysh po e them barrierat me të cilat përballen sot gratë në Kosovë.

Një element tjetër për këtë buxhet që nuk është aspak buxhet zhvillimor, por është buxhet politik janë edhe kërkesat e komunave të cilat janë skajshmërisht në gjendje të rëndë dhe përballen me neglizhencën e kësaj Qeverie për t'i përkrahur. Me ndarjet buxhetore 2023 Qeveria po cenon funksionimin e pushtetit lokal, pra po cenon pavarësinë financiare të komunave, po e shkel kështu Ligjin për financat publike dhe po e shkel edhe Ligjin për financat lokale.

Të gjitha të hyrat vetjake të mbledhura për vitin fiskal 2020 e të pashpenzuara, pra bëhen pjesë e fondit të Kosovës në bilancin bankar. Ky është ndryshimi të cilin e ka bërë Qeveria në projektbuxhet. Pra me këtë po shihet se po provohet që komunave të Kosovës t'u merren të hyrat vetjake të cilat kanë qenë të pashpenzuara. Siç e dini komunat e Kosovës e kanë të rregulluar pavarësinë financiare dhe ne kemi pasur në fundmi një reagim të Asociacionit të Komunave të



Kosovës që të mos ketë ndërhyrje nga niveli qendror, sepse po bëhet fjalë për tetë milionë euro të komunave, të cilat janë të pashpenzuara, e Qeveria e Kosovës po synon t'i marrë ato.

Pra Qeveria po bën diskriminim të madh në raport me komunat të cilat nuk i qeveris. P.sh. ta zëmë për çerdhet, Qeveria për vitin 2023 ka ndarë zero euro për ndërtimin e çerdheve në Vitit, në Deçan, në Malishevë, në Gjilan, Ferizaj, Prishtinë, Prizren e në Vushtrri. Kryeministri i përmendi njëmbëdhjetë sosh, për të cilat unë nuk e di se ku i ka planifikuar t'i ndërtojë.

Pra, të mos harrojmë prapë po e them se ky pushtet ka premtuar ndërtimin e 160 çerdheve. Në buxhet për vitin 2023 janë ndarë vetëm tre milionë euro për ndërtimin e çerdheve. Më thoni ju të nderuar deputetë, sa çerdhe mund të ndërtohen me këto tre milionë euro.

Qeveria s'ka paraparë buxhet të mjaftueshëm për projektin për furnizim me ujë të pijes në Prizren. Në Skenderaj, s'po mund të përfundojë projektet e filluara, për shkak të mungesës së vazhdueshme të mbështetjes financiare nga buxheti qendror. Projektet të cilat janë përmendur edhe nga kolegët e mi deputetë janë shumë, po ndër të tjera po përmend projektet e kanalizimit Klinë-Kuçicë, të kanalizimit Çitak-Padalishtë, të kanalizimit Vitak-Çubrel, Prekaz-Mikushnicë, ai në Qirez, ndërtimi i kanalizimit Likos, faza e parë, pastaj rehabilitimi i rr. Ilaz Kodra dhe rregullimi i shtratit të lumit Klina, që s'po mbështetet.

Në Drenas e kemi të njëjtën gjendje, pra financimi i projektit zgjerimi i rrugës Komoran-Drenas-Skenderaj, një rrugë strategjike shumë e ngarkuar, rruga që lidh komunat si Drenasin, Skenderajn, Mitrovicën e Istogun dhe Shtimen me rrugën e kombit, për këtë vit janë ndarë vetëm një milion euro që janë pak për këtë ritëm dhe kjo rrugë nuk mund të përfundojë me këtë ritëm as për nëntë vitet e ardhshme. Pastaj ndërtimi i rr. Gradicë-Zhilivodë, projekti i liqenit të Vërbocit është hequr prej planifikimit buxhetor për vitin 2023.

Në Vushtrri është shumë me interes riasfaltimi e sinjalizimi i rr. Vushtrri-Skenderaj. Ta keni parasysh sot sa aksidentet me fatalitet i kemi pothuajse çdo muaj në atë pjesë të rrugës. Këtu janë paraparë vetëm 81 mijë euro të bartura nga viti e kaluar, si dhe është me rëndësi edhe përshpejtimi i punimeve të autostradës Prishtinë-Vushtrri e cila nuk po përfundon tash e sa vite.

Njëjtë e kemi gjendjen edhe në Komunën e Gjilanit, ku e kemi kryetarin që e udhëheq partia e cila udhëheq me vendin, vazhdimi i autostradës prej fshatit Bresalc deri në dale të Gjilanit. Propozim-ndarja e buxhetit 27 milionë për autostradën e Gjilanit për vitin 2023, projekti i miratuar është prej Banullës së Lipajnit deri në fshatin Përlepnice. Shpronësimet, kontraktimet me operatorë ekonomikë dhe punimet janë bërë pjesë e autostradës vetëm deri në fshatin Bresalc e projekti i miratuar është deri në fshatin Përlepnice. Njëjtë e kemi me projektin e impianteve të zeza, njëjtë dhe më keq e kemi komunën e Kaçanikut.

Kolegë deputetë,

Ta keni parasysh që ky është viti i pestë që nuk ka asnjë projekt të vetëm nga niveli qendror për qytetarët e Komunës së Kaçanikut. Edhe pse ka pasur kërkesa të shumta për ndërtimin e shkollës “Emin Duraku”, e për shumë projekte të tjera. Po e përmend edhe Istogun për të parë se kjo Qeveri ka shkelur investimet në komuna. Asfaltimi i rrugës së Livadhit të Istogut, Mokën janë 500 mijë euro të bartura prej vitit 2022, asnjë cent nuk është shtuar në 2023. Njëjtë e kemi rrugën e Bjeshkës, Luboshtë-Lug i Butë që nuk ka pasur investime të reja.

KRYETARI: Ia zgjatni edhe një pjesë të kohës deputetes në fjalën e saj.

BLERTA DELIU-KODRA: Prandaj kolegë deputetë, kryeministri dhe zv.kryeministri nuk janë këtu,

I nderuar ministër,

Natyrisht që vota jonë nuk do të jetë pro këtij buxheti që është buxhet tërësisht politik, që ua minon ekzistencën komunave, që edhe atë buxhet të cilin komunat nuk e kanë shpenzuar, synon që t’ua marrë. D.m.th. janë tetë milionë euro të cilat me ndryshimet në projektbuxhet po synon që Qeveria t’i marrë përsipër për vete, janë para të komunave e në kohën kur mungojnë investimet kapitale, një projektbuxhet totalisht politik është i pakuptimtë dhe natyrisht nuk do ta ketë votën e Partisë Demokratike të Kosovës dhe timen assesit.

Prandaj, po them do të kemi amendamentet tona, të cilat do të prekin edhe ashtu jetën e rëndur të qytetarëve të Kosovës në këtë përballje me inflacionin, me çmimet e larta, me papunësinë, me ikjen e qytetarëve, me nepotizmin, punësimet që i kemi çdo ditë të zyrtarëve të partisë në pushtet, por asnjë projekt strategjik për qytetarët e Kosovës.

KRYETARI: Tash ia japim fjalën deputetes Eliza Hoxha.

ELIZA HOXHA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

U tha disa herë që buxheti i Kosovës natyrshëm ka pasur rritje ndër vite. Por të lavdërohesh me buxhetin e rritur në kohën e inflacionit, i cili e ka varfëruar qytetarin, por e ka pasuruar shtetin, si pasojë e rritjes së çmimeve, e që si reflektim ka taksa më të mëdha për shtetin.

Se si përkthehet ky buxhet në të mirën publike si aspekt zhvillimor për të ardhmen, e jo si aspekt i ndihmës sociale për mirëmbajtjen shoqërore dhe paqen publike është vështirë të thuhet.

Një gjë tjetër që vërehet brenda buxhetit është se si shtrihet buxheti në aspektin e logjikës investive në raport kohor. Nga viti 2023 në vitin 2025. Këtu do të ndalem te investimet kapitale

që vijnë në disa komuna e që janë buxhetuar me zero buxhet për vitin 2023, zero buxhet për vitin 2024, por me shumëfish buxhet në përfundim të mandatit qeverisës të komunave, bash para zgjedhjeve buxheti dyfishohet. Kjo nuk ndodh njëjtë me komunat që menaxhohen nga Lëvizja Vetëvendosje, sepse aty buxheti investiv ka një konstantë të shpërndarë ndër vite.

Në një shtet si Kosova që lavdërohet nën sloganin..., vëmendja për rininë nga kjo Qeveri është vetëm 1,6 milion. për një Qeveri që po ashtu lavdërohet se është pjesë e Cop 27 dhe kërkon qasje në fondet globale për ndryshimet klimatike dhe çështjet mjedisore, vëmendja e kësaj Qeverie në nivelin e shtetit për adresimin e po këtyre çështjeve mjedisore dhe klimatike është fare e vakët e në çështje të caktuara si ajo e energjisë edhe më shumë kontradiktore.

Në një dinamikë të koncepteve smart, qyteteve të mençura dhe institucioneve të mençura, fokusi në inovacion, digjitalizim dhe edukim në këtë fushë sërish nuk e merr vëmendjen e duhur. Edhe pse të gjithë e dimë që për shkak të zhvillimit të hovshëm teknologjik, shumë profesione do të shuhen, shumë të tjera do të transformohen dhe nevoja për përshtatje me tregun e punës brenda dhe jashtë Kosovës është domosdoshmëri.

Kur jemi te ekonomia e dijes, atëherë për mua është shqetësuese se si kjo Qeveri nuk i jep vëmendje universitetit primar të Prishtinës, duke e lënë me buxhet të njëjtë për tri vitet në vijim. Nëse kaloni nëpër këtë shtyllë, kuptoni se ai buxhet që është i fokusuar është vetëm për renovime, investime dhe pajisje apo inventar. Po ky buxhet nuk lë hapësirë për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore. Nuk lë hapësirë për buxhet për hulumtime dhe kërkime shkencore dhe mundësitë e zhvillimit institucional bazuar në dije dhe kompetencë e jo në çështje teknike të cilat nuk mund të them se janë të parëndësishëm, por nuk janë më të rëndësishmet nëse flasim për vitet e cilësisë në arsimin kolektiv.

Nuk ka buxhet për publikime që mbajnë logon e Universitetit të Prishtinës e që është domosdoshmëri për aspektin kompetitiv me botën. Stafit i UP-së vazhdon të cenohet për punën profesionale duke vlerësuar vetëm për orët e mbajtura mësimore, por jo edhe për mundësitë dhe kontributin shkencor dhe hulumtues brenda institucionit. Përderisa shohim gjueti dhe përndjekje mbi mekanizmat drejtues dhe stafin e UP-së në emër të cilësisë dhe performansës, pikërisht këtu buxheti mungon. Aspekti teknik njëmend e përmirëson mjedisin ku zhvillohet procesi mësimor, por pa mbështetje financiare në proceset hulumtuese dhe kërkuese, cilësia në arsim as nuk rritet e as performansa e stafit të saj.

Po ashtu shoh që brenda buxhetit buxhetohen investime për FNA-Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës nën kodin 1941. Po ju ritheksoj kolegë të nderuar, se fakulteti i arkitekturës është njësi e pavarur që nga viti 2019. E kam kërkuar tash e sa herë radhazi kur kemi shqyrtuar buxhetin e viteve të kaluara që përmes amendamentimit të bëhet një kod i veçantë për të, sepse është njësi e veçantë akademike tashmë dhe nuk ka implikime buxhetore, por kjo nuk është

votuar. Kështu si është ndarja buxhetore e dëmton Fakultetin e Arkitekturës si njësi, për shkak se ka më pak programe sesa ai i ndërtimtarisë e që merret si bazë e ndarjes së buxhetit, bazuar në nevojat dhe këtu shkelin parimin e barazisë midis njësive akademike.

Po ashtu brenda MASH, buxheti i universiteteve të tjera publike ose është i njëjtë ose është në rënie. Një gjë shqetësuese është diskrepanca midis ndarjeve buxhetore për investime kapitale. As nuk respektohet kriteri i popullsisë, as kriteri i territorit, e në këtë rast as nevojat e qytetarëve që jetojnë aty. Edhe te mënyra e shpërndarjes së buxhetit ndër vite për këto komuna ka diçka për t'u shqetësuar. Po ndalem pak te arsimit. P.sh. ndërtimi i çerdhes në Prishtinë, nëse e shikon ndarjen buxhetore ndër vite, viti 2023 dhe 2024 janë me zero buxhet, tek në vitin 2025 parashihet pesëqind mijë euro buxhet. E njëjta logjikë përdoret në Prizren, Vushtrri, Mamushë, Fushë Kosovë, Mitrovicë, komuna këto të udhëhequra nga partitë e tjera. Përderisa, nëse e shikoni të njëjtën gjë, pra ndërtimin e çerdhes në Komunën e Shtimes, e udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje, investimi shtrihet në aspekt kronologjik trevjeçar, 150 mijë euro në vitin 2023, 150 mijë në 2024 dhe 300 mijë në 2025.

Njësoj e shohim situatën me shkollat fillore, ku buxheti për vitin 2023 dhe 2024 është tepër u ulët që pamundëson investimin dhe realizimin e projektit dhe rritet shumëfish në 700 mijë euro, pikërisht në përndim të mandatit qeverisës në këto komuna që nuk udhëhiqen nga Lëvizja Vetëvendosje. Kjo logjikë penalizon komunat që udhëhiqen nga të tjerët dhe i fuqizon ato me buxhet pikërisht para zgjedhjeve, si kartë për lavdërim nga pushteti aktual dhe penalizim i qeverive aktuale lokale. Këtë gjë nuk e vërejmë çuditërisht te institucionet të cilat nuk lidhen me investimet kapitale. P.sh. inspektorati i arsimit në vitin 2023 ka 180 mijë euro buxhet, në 2024 ky buxhet zbret në 20 mijë euro, thua se është e parëndësishme që inspektorati ta bëjë punën e vet për cilësinë e arsimit, përderisa në 2025 ka zero buxhet të planifikuar.

Në anën tjetër, besoj se ju kujtohen këtu shkollat e muzikë të realizuara në Vushtrri e Kamenicë vitin e kaluar, ndërsa sivjet shohim të jenë buxhetuar në Prizren e Mitrovicë, por jo edhe në Komunën e Prishtinës, apo më mirë të them në kryeqytetin e Kosovës. Pyetja ime është: pse penalizohet kryeqyteti i Kosovës tash e sa vite? Prishtina as këtë vit nuk e ka të buxhetuar shkollën e ulët të muzikës që ka qenë premtim i znj. Nagavci, edhe kur ka qenë drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës në Komunën e Prishtinës, por edhe si ministre e arsimit tash e sa vjet. Si ka mundësi që të penalizohet kryeqyteti deri në këtë masë si qendra kulturore e shtetit e për ironi buxhetohet liceu artistik, shkollë e mesme. D.m.th. nuk kemi shkollë të ulët, objekt të përshtatshëm për të kryer funksionin bazë, por planifikojmë lice artistik si shkollë profesionale e mesme. Meqenëse unë i gëzohem, por megjithatë mendoj që kulmi nuk qitet para se të qitet baza e themelit.

Kjo Qeveri vazhdon e lavdërohet për anëtarësime në federata ndërkombëtare, por nuk e buxheton infrastrukturën që duhet ndërtuar, bazuar në këto standarde siç është stadiumi kombëtar i Kosovës.

Sa i përket sektorit të kulturës, vetëm treqind mijë euro për shërbimet kulturore janë ndarë për kryeqytetin e Kosovës, aty ku pjesa më e madhe e aktiviteteve kulturore vjetore ndodhin. Vetëm dhjetë mijë euro për muzeun e artit bashkëkohor, edhe pse thuhet se është prioritet i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, e edhe këto janë të bartura nga viti i kaluar. Ndërtimi i arkivit në Gjilan, Prizren e Mitrovicë, është planifikuar, por jo edhe në Prishtinë. Qendra rinore gjithandej, po jo në Prishtinë as edhe një e vetme.

Dhe sërish e bëjë pyetjen: pse vazhdimisht penalizohet Prishtina nga kjo Qeveri, kur fluksi më i madh i migrimit të brendshëm shoqëror, por edhe profesional, arsimor e kulturore lidhet me kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën? Shkolla-shtëpi e Herticëve e shpallur muze i ka vetëm tridhjetë mijë euro të ndara dhe ato të bartura nga viti i kaluar. Asnjë cent këtë vit, edhe pse MKRS thotë se trashëgimia kulturore e shpirtërore ka prioritet të lartë në këtë ministri.

Kur jemi këtu, dua të theksoj se çdo buxhetim i njëjësive trashëgimore sillet aty diku midis njëzet a pesëdhjetë mijë, përderisa shohim që aktualisht mbi tre milionë euro janë bërë kontrata njëburimore nga kjo Ministri aktualisht për intervenime e restaurime në trashëgiminë kulturore në emër të emergjencave.

Logjika e mbajtjes peng të komunave deri në vitin 2025 në shumë sektorë, flet për shpirtngushtësinë tuaj dhe kalkulimet e juaja partiake dhe me këtë nënkupton që nuk e adreson të mirën publike në parimin e barazisë dhe gjithëpërfshirjes, por ka fokus dhe përkëdhel komnatat e qeverisura nga Lëvizja Vetëvendosje.

Me një fjalë, buxheti adreson agjendën tuaj partiake, por jo edhe atë qytetare prej të cilëve keni marrë votën dhe jeni sot këtu. Thjeshtë një mashtrim i radhës për qytetarët e Kosovës.

**KRYETARI:** Fjalën ia japim deputetes Albana Bytyqi tash.

**ALBANA BYTYQI:** Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Sot në pikën e diskutimit të buxhetit të shtetit për vitin 2023, ka shumë gjëra për të cilat duhet të diskutojmë qartazi dhe në përpikëri të ndajmë baras buxhetin për secilin institucion dhe komunë aq sa u takon në bazë të ligjeve dhe rregulloreve.

Nuk do të kisha dëshirë që ky diskutim të shtrihej në aspektin politik ose partiak, thënë më mirë dhe të bëhen ndarje buxhetore partiake nga paratë e qytetarëve tanë. Në shumë segmente buxhetore kam tentuar të lexojë më shumë rreth pjesës së qytetarëve nga ana e qytetarëve që i përfaqësoj dhe kam parë se nuk janë vazhduar, apo thënë më qartë nuk u është dhënë buxhet shtesë për vitin 2023.

Shumë nga projektet e nisura e që kanë mbetur në gjysmë janë: ndërtimi i mbikalimit në Klinë të Epërme, ndërtimi i urës në fshatin Rogovë të Komunës së Gjakovës, zgjerimi i rr. Dollc-Gjakovë, ndërtimi i qarkores së Gjakovës, riparimi i rrugës rajonale Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë, ndërtimi i rrugës qendrore në Deçan, asfaltimi i rrugës Fortesë-Hamoc-Rahovec, ndërtimi rr. Maja e Zezë-Rrethi i Mitrovicës, ndërtimi i rr. Brigada 123-Sheshi Suharekë, ndërtimi i rr. Baçevc-Sallagrazhdë-Grejok-Korishë-Suharekë, ndërtimi rrugës në Rahovec nga rrethrotullimi deri në dalje të rrugës për Xërxë, ndërtimi i rrugës nacionale Deçan-kufiri me Malin e Zi, ndërtimi i rrugës transit në Klinë, ndërtimi i rrugës Qafë e Dules-Topillë-Grejqevc-Papaz.

Përveç këtyre rrugëve, ka projekte madhore të rinisë dhe kulturës që po ashtu nuk janë përkrahur këtë vit nga Qeveria Kurti. Ato janë ndërtimi i kompleksit të tenisit në komunën e Gjakovës, qendra e kulturës në Rogovë të Hasit-Gjakovë, renovimi i sallës në shtëpinë e kulturës Jusuf Gërvalla-Deçan, shtëpia e kulturës në Drenoc-Deçan, qendra rinore në Deçan, muzeu etnografik në Gjakovë.

Përveç kësaj, janë edhe projektet për shkolla që nuk janë përkrahur nga buxheti i shtetit për vitin 2023. Ndërtimi i shkollës fillore në Vranicë-Suharekë, ndërtimi i aneksit dhe renovimi i shkollës në Samadragjë të Suharekës, ndërtimi i çerdhes në Deçan. Përderisa te Komuna e Suharekës keni ndarë për kategorinë arsim dhe shkencë 8 285 095 euro, ndërsa në Komunën e Podujevës të qeverisur nga partia juaj keni ndarë për të njëjtën kategori 12 290 428 euro. Po ashtu në Komunën e Deçanit janë ndarë 29 mijë euro për zhvillim ekonomik, ndërsa për Komunën e Kamenicës i keni ndarë 141 mijë euro.

Duhet të shtoj që janë edhe disa projekte siç është pika renovimet në Akademinë e Kosovës për sigurinë publike që nuk i është ofruar buxhet për vitin 2023 dhe që sipas mendimit tim është rrezikshmëri që këto kategori të mos furnizohen nga buxheti i shtetit për renovime, kur e dimë rëndësinë e tyre të lartë dhe infrastrukturën që u nevojitet për zhvillim. Andaj, kërkoj që buxheti ka nevojë që të rishikohet dhe të rivendoset edhe njëherë për këto linja buxhetore. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash fjalën e ka deputeti Ferat Shala.

**FERAT SHALA:** Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara media,

Sinqerisht, në fund të vitit zakonisht do të duhej që të përmbylleshin duke na bashkuar rreth asaj se çka keni punuar në atë që lamë pas dhe nën dy do të duhej të na bashkonin për planifikimin e vitit që na pret. E para, mund të them me përgjegjësi që po e përmbylim kështu siç po e shihni, po e përmbylim me një inflacion të lartë mbi 14 për qind. Po e përmbyll me një... politike jashtëzakonisht të madhe, po e përmbylim me një krizë ekonomike dhe sociale po pse jo edhe politike. Kjo edhe mund të kuptohet për shkak të rrethanave dhe menaxhimit të kësaj Qeverie, po pika e dytë e rëndësishme që do të duhej të na përbashkonte ishte dhe është çështja e buxhetit për planifikimin për të ardhmen, për vitin e ardhshëm, për sferat ekonomike sociale, të arsimit e që praktikisht dy draft-buxhet që e kemi sot, parimisht nuk mund t'i themi që i plotëson konditat dhe as aspektet e planifikimit të mirëfilltë për nevojat që ka vendi dhe shoqëria jonë sot.

Për të ardhur në këtë konstatim, domosdoshmërisht duhet marrë disa mostra. Unë të jem i sinqertë që ministri disa herë e tha nuk e keni lexuar. Nuk e kam lexuar tërë buxhetin, po i kam marrë disa mostra. E mora dhe e shikova çështjen e planifikimit në arsim, në Ministrinë e Ekonomisë, të Mjedisit, shikova rregullatorin e AKP-së dhe e mora për mostër Televizionin Publik të Kosovës. Në secilën nga këto mostra të realizuar dhe të planifikuara në buxhet, lë shumë për të dëshiruar, për të mos thënë janë regresive dhe janë jozhvillimore.

Përsëri mund të mos pajtohem, po ajo çka krahasova gjatë fazës së analizës është pikërisht qëndrimi juaj, planifikimi juaj, projekti juaj dhe objektivat e juaja qeverisëse. Unë e krahasova buxhetin në objektivat e juaj në fushën e arsimit dhe më lejoni t'ju citoj. Pra, ju keni thënë në kuadër të projekteve tuaja mbi të cilat edhe keni ardhur në pushtet, që do të themeloni një fond për hulumtime shkencore. Në projektbuxhet as vitin e tretë të qeverisjes suaj nuk e keni paraparë dhe nuk është themeluar. Ju keni thënë që do të bëni jetësimin e projektit për edukimin parashkollor në çdo komunë që do të përhapet me rëndësi të veçantë ofrimi i kushteve preferenciale të pagës apo heqja e pagës për çerdhe të fëmijëve për kategori të caktuara të popullatës. Po lexoj në programin e juaj, nuk e keni realizuar dhe nuk keni paraparë asnjë cent për këtë.

Ju keni thënë përmirësimin e cilësisë së teksteve të reja shkollore do ta avancojmë në arsimin parauniversitar dhe do të fillojmë planifikimin e shkollave digjitale. Asnjë realizim, asnjë planifikim, asnjë cent. lexojeni atë çka keni shkruar dhe e keni publike. Ju keni thënë se shkollat profesionale dhe të mesme të larta do të ringjallni me modernizimin me mjete me kurrikula dhe materiale mësimore, profilet e në veçanti me programet praktike, shtrirje dhe rritjen e atyre që planifikojnë strategji zhvillimore në këmbim të kërkesës së tregut të punës. Asnjë planifikim, asnjë cent buxhetor as për vitin e ardhshëm.

Pra, keni thënë ju dhe keni të shkruar që universitetin do ta fuqizoni drejt kërkimit shkencor. Nuk është realizuar asnjë hap në këtë dhe nuk keni paraparë asnjë hap në të. Të gjitha këto të arritura

sipas projektit dhe programit tuaj qeverisës keni thënë do t'i realizojmë përmes qëllimeve strategjike. Do ta ofrojmë, lexojeni atë që e keni shkruar ju. Do të ofrojmë të gjitha vendimet dhe shujta falas për të gjithë nxënësit e klasës së parë deri në të pestën. Pra premtim elektorale dhe program qeveritar. Nuk e keni realizuar dhe nuk keni paraparë buxhet për vitin 2023. Keni thënë që do të krijojmë biblioteka të mësimdhënësve duke i pajisur ato me literaturë relevante të kohës. Nuk keni paraparë, nuk keni realizuar asnjë cent për këtë. keni thënë që për mësimdhënësit do të ofrojmë banim dhe kosto të përballeshme. Ofertë e juaj publike qytetarëve dhe mësimdhënësve. Dhe dihet çka u keni ofruar. Asnjë cent nuk e keni paraparë këtë në buxhetin e vitit të ardhshëm buxhetor.

Qeveria gjithashtu do të angazhohet për përmirësimin e infrastrukturës dhe shfrytëzimin efektiv të teknologjive digjitale për procesin mësimor. Pjesë e programit tuaj qeverisës po e lexoj dhe nuk keni realizuar dhe nuk keni paraparë asnjë cent për këtë pjesë të programit. Apo pika tjetër: harmonizimi i arsimit dhe aftësimi profesional me kërkesa të tregut të punës. Asnjë veprim, as ushtruar, as i realizuar. Menaxhim efektiv i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, pjesë e programit tuaj qeverisës. Asnjë cent i ndarë për vitin e ardhshëm në këtë pikë.

Pra, arsimit i lartë me cilësi dhe integritet në harmoni me standardet ndërkombëtare, pjesë e programit tuaj, as planifikim dhe as realizim deri sot. Apo fuqizimi me pajisje laboratorike e logjistike kërkimore shkencore për institucionet kërkimore të Republikës së Kosovës. Pjesë e programit të juaj. Shikoni fq. 55 në vitin e kaluar, projektbuxhetin e keni pasur 665 milion e 709 euro, ndërsa për këtë vit për këtë pikë keni arritur të realizoni apo të planifikoni 170 mijë euro. Sinqerisht a kështu do ta zhvillojë shkencën dhe arsimin? Nga gjashtëqind mijë në 170 mijë e keni sjellë. Apo fq. 64, shpenzimet kapitale për arsimin parauniversitar, nga viti i kaluar që kemi pasur 35,9 milionë euro, e keni zvogëluar në 29 milionë euro. Fq. 65, shpenzimet kapitale për arsimin -projektet kapitale në nivelin qendror, nga 55,3 milionë euro sa kanë qenë në 2022, janë zvogëluar në 33,2 milionë euro. Lexojeni nëse nuk e keni lexuar.

Apo mostra tjetër e realizimeve të objektivave ekonomike të këtij vendit sipas Qeverisë. Ministria e Ekonomisë për shkak të kohës, edhe kam folur mjaft, edhe sinqerisht asnjë ndryshim, as programor, as zhvillimor, as buxhetor. E dini saktësisht ku është sot kriza energjetike, ku janë investimet dhe çka keni bërë këtë. por, po e marr edhe mostrën e Ministrisë së Mjedisit, se u fol shumë për krizën e përgjithshme globale mjedisore. Në programin qeverisës për mjedisin, rreth 77 statistikisht e them të objektivave të juaja të planifikuara janë të patrajuara fare në buxhetin e këtij viti. Merreni e shikojeni menaxhimin e integruar të mbeturinave, menaxhimin e ujërave dhe ngritjen e infrastrukturës, mbrojtjen e natyrës, biodiversitetit, planifikimin hapësinor të qëndrueshëm, banimin social dhe banimin e përballeshëm, premtimet e tuaja që nuk i keni fare në program buxhetor për vitin e ardhshëm. Apo më lexoni të përmend edhe dy mostra të tjera. Po ju na thatë edhe e keni të shkruar që AKP do të shuhet. E kuptuam vitin e parë, e kuptuam edhe vitin e dytë qeverisë, po ju në projektbuxhet ia keni rritur buxhetin për njëqind mijë euro. A do ta



shuani apo jo? Çka po ndodh me AKP? Ku jeni ju? Ku është fondi sovran? Ku është fondi i investimeve? Ku janë fondet e tjera për zhvillim digjital?

Pra, praktikisht me AKP ju po vazhdoni dhe e keni rritur buxhetin, apo çka është hale më e pabesueshme, RTK. Televizioni ynë publik e ka të njëjtin buxhet pa pikë, pa presje atë që e ka pasur vitin e kaluar. Po si do të kemi zhvillim tjetër, si do të kemi cilësi dhe kualitet në rrethana tepër të veçanta? Po çfarë kualiteti dhe cilësie programore u ofrojnë qytetarëve të vendit sot, kur ju RTK e abrogoni nga buxheti i vitit të ardhshëm dhe e lini me të njëjtin buxhet që ka qenë tash e dhjetë vjet. Po ju thatë që duhet të ndryshojë. Ju e morët me plot kuptimin e fjalës komplet bordin, i zgjodhët drejtorë dhe nëndrejtorë, i larguat nga puna. Po si do ta zhvilloni?

Janë duke i hequr njerëzit nga puna dhe duke e lënë buxhetin e njëjtë?! Po atje do të duhej të investohet në teknologji të informacionit që RTK-ja të jetë paralel me televizionet e tjera private, e jo ta abrogoni kështu dhe ta sanksiononi. Kështu po e shkatërroni televizionin publik. Dhe kështu, sipas logjikës suaj po flas, po i favorizoni televizionet e oligarkëve, sipas jush, se prej meje, jo.

Prandaj, ky është programi qeverisës për vitin e ardhshëm i Qeverisë. Singërisht, nuk kam koment, nuk do ta cilësoj asfare. Merreni dhe shikojini këto shifra dhe këto mostra të cilat unë i kam trajtuar në projekt-buxhet, nëse dalin ndryshe, jemi këtu.

Por, është e pakuptueshme sot, në kuptimin e përgjithshëm, prapë i kthehem asaj që është zhvillim ekonomik, që asnjë projekt të ri në fushën e industrisë, të minierave, të teknologjisë, asnjë projekt të ti. Dhe, si do të presim zhvillim...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Tash e ka fjalën deputetja Floretë Zejnullahu.

**FLORETË ZEJNULLAHI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Politika e këtyre ditëve ka qenë plot mospajttime dhe me shumë polarizime. Antagonizmat e krijuar e kanë vështirësuar mirëkuptimin mes njëri-tjetrit dhe na kanë larguar nga konsensusi rreth çështjeve përreth të cilave duhet të kemi pajtim gjithë-shoqëror.

Shëndetësia është tema e cila duhet të jetë përbashkuese, e buxheti i vitit 2023 veçse do të rrisë polarizimin e për fat të keq, ky buxhet do të rrisë barrën e qytetarëve, do të rrisë shpenzimet e qytetarëve, do të rrisë, mbi të gjitha, vuajtjet dhe dhembjet e qytetarëve të këtij vendi.

Qytetarët e vendit po ballafaqohen me shpenzime të mëdha, e këto shpenzime më së shumti rëndohen dhe thellojnë varfërinë kur janë për nevoja shëndetësore, sepse nuk ke mundësi të zgjedhësh nëse do apo jo, të marrësh një shërbim shëndetësor, sepse është në pyetje jeta jote apo e familjarëve tuaj.

Buxheti për vitin 2023 nuk parasheh projekte kapitale në shëndetësi, madje asnjë projekt nuk ka përfunduar në vitin 2022, e as nuk parashihet të përfundojë në vitin 2023 apo 2024. Ky është tregues i sakët që nuk ka arritje deri më tani, por nuk do të ketë as deri në fund të mandatit të kësaj Qeverie, gjithnjë sipas buxhetit të vitit 2023.

Nëse e shohim programin qeveritar tuajin, ku sigurimet shëndetësore apo sistemi informativ shëndetësor kanë qenë premtime tuaja, këto projekte as nuk parashihen në buxhetin për vitin 2023.

Në këtë moment që po flasim, Kosova ka më së paku mjekë për kokë banori në gjithë rajonin. Qytetarët tanë shpenzojnë më së shumti në rajon për shërbime shëndetësore e për barna, e në anën tjetër, trendi i ikjes së profesionistëve nga Kosova mbetet shumë i lartë. Kosova nuk ka më mjekë për të humbur. Kosova nuk është shtet shumë i zhvilluar që të marrë mjekë nga vendet e tjera, por Kosova nuk është aq e varfër sa të lejojë humbjen e mjekëve dhe infermierëve tanë, heronjve tanë të përditshëm.

Në shëndetësi situata është e vështirë, dhe madje shumë paradoksale edhe për buxhetin që po flasim sot. Sot, Kosova nuk ka ministër të Shëndetësisë, i cili do të duhej të merrej me planifikimin dhe implementimin e këtij buxheti. Kjo Qeveri ka ndërruar dy ministra, sot presim ardhjen e ministrit të tretë, dhe aktualisht të gjitha pozita kyçe në shëndetësi janë me ushtrues detyre.

Kush është hartues dhe drejtues i politikave shëndetësore nëse ministri nuk është aty për ta bërë këtë? Kush është duke bërë planifikimin e politikave për qytetarët, tani kur ata kanë nevojë më së shumti për shërbime shëndetësore, për barna, për sigurime shëndetësore. Me çfarë guximi po luani me jetën e qytetarëve tanë?

Sot, në QKUK dhe në spitalet rajonale, gjendja është në kaos total. Listat e pritjeve për operacione janë rritur. Pacientët me kancer nuk marrin shërbimet, barnat e as terapinë, e për të kryer një CT e rezonancë magnetike, duhet të presim më shumë se një vit, ashtu siç duhet të pritët më shumë se një vit edhe për stentim.

Është e dhembshme, por sot klinikat në QKUK nuk kanë as letër higjienike, dhe kjo është për keqardhje. Pra, kjo tregon më shumë se gjithçka tjetër se si dhe sa është shëndetësia prioritet për juve.

Në vitin 2022, buxheti për shëndetësi ka qenë 198 milionë euro, ndërkohë për arsye keqmanxhimi e mosplanifikimi adekuat, çdo ditë ka pasur mungesë të barnave në klinikat e QKUK-së e nëpër spitale. Si pasojë e kësaj mjekët kanë pasiguri në trajtim për shkak të kushteve të punës. Një mjek kirurg është përballur me mungesë të materialeve esenciale për operim. Ju jeni ata që keni qeverisur edhe vitin e kaluar. Ju keni planifikuar edhe buxhetin për 2022. E keni sjellë shëndetësinë pranë kolapsit dhe ndërkohë nuk shfaqni vizion për të rregulluar këtë problem as këtë vit, e as në vitet e ardhshme.

Por, ju nuk e keni problem shëndetësinë kosovare, sepse presidentja juaj trajtimet i kryen në spitale privat apo edhe ato në Turqi.

Të nderuar qytetarë,

Sot, kur profesionistët po largohen nga Kosova, arsyeja afatgjatë është domosdoshmëria për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për mbajtjen e profesionistëve në vendin tonë, për të cilët sot kemi më së shumti nevojë.

Ky buxhet nuk parasheh ngritje të pagave për mjekët, për farmacistët, për infermierët, për teknikët, për profesionistët shëndetësorë në përgjithësi, siç nuk parasheh as ngritje të pagave për arsimtarët, për policët, për ushtarët, për shërbyesit civilë.

Ky buxhet nuk garanton zhvillim ekonomik, e as fuqizim të sektorit privat përmes politikave të qarta investive, si rrjedhojë nuk do të ketë as ngritje të pagave në sektorin privat.

Buxheti i vitit 2023 nuk garanton se do të kemi renovim më shumë nëpër klinika, se do të kemi më shumë pajisje të reja për modernizimin e shërbimeve mjekësore. Ky buxhet nuk garanton se pacientët do të kenë më shumë barna, sepse çmimi i barnave është rritur thuajse 100%, ashtu siç janë rritur çmimet e secilit produkt dhe shërbim tjetër.

Ky buxhet nuk garanton se do të kemi më shumë shtretër të rinj për pacientët, se do të kemi shtim të më shumë shërbimeve për pacientët dhe nuk garanton se do të hiqen listat e pritjeve për qytetarët tanë, madje ky buxhet veç do ta rëndojë gjendjen në shëndetësi.

Trendët negativë që rëndojnë mbi supet e Kosovës mund të ndërrojnë kahe vetëm nëse intervenojmë përmes vendimeve politikisht të mençura dhe praktikisht të efektshme. Kjo Qeveri nuk po e bën këtë gjë.

Ky Ligj i buxhetit nuk është thjesht një dokument që do t'u shtohet sirtarëve të Kuvendit, por një plan që do të ndryshojë rrënjësisht jetën e qytetarëve. Në kohë krizash të mëdha ekonomike e sociale, shteti nuk duhet të pozicionohet në rolin e spektatorit. Është gabim. Në fakt, një nga detyrat e shtetit është edhe mbrojtja dhe ndihma për qytetarët në kohë krizash ekonomike.

Buxheti i vitit 2023 garanton që shtetit do të jetë vetëm spektator në raport me nevojat e qytetarëve. Politika është e mirë kur ndryshon jetën e qytetarëve për të mirë, por ajo di nganjëherë edhe të ndryshojë parimet e politikanëve, dhe ju jeni shembulli më i mirë se si ndryshon një politikan nga opozita në pushtet.

Ky është buxhet i varfërisë dhe i lëmshës, ky nuk është buxhet i zhvillimit dhe progresit. Prandaj, ky buxhet nuk duhet të kalojë dhe t'i kthehet Qeverisë për rishikim. Faleminderit!

KRYETARI: Ganimete, ti ende nuk ke folur në seancë, a po? Pra, e kemi nderin të të dëgjojmë.

GANIMET MUSLIU: Faleminderit për konsideratat, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë e ju kolege deputete,

Të dashur qytetarë të Republikës të Republikës së Kosovës,

Sot, po flasim e po krekosen se e paskan rritur buxhetin e sigurisë ata të cilët e refuzuan ta votojnë Ligjin për themelimin e FSK-së në vitin 2014.

Merreni me mend sikur ky vendim të merrej atëherë, ku do të ishin kapacitetet e FSK-së sot. Sot, flasim e krekosen se e paskan rritur buxhetin e sigurisë, sikur ta kishin rritur këtë buxhet me paratë e baxhanakëve, e jo që janë paratë e taksapaguesve.

Sot, flasim e krekosen se e paskan rritur buxhetin e sigurisë, e 12 orë policët e Kosovës punojnë me një racion ushqim. Sot, flasim e krekosen se e paskan rritur buxhetin e sigurisë, ndërkaq 182 ushtarë e eprorë të lartë ushtarakë janë në listën pritëse që kanë bërë kërkesën për demobilizim.

Sot, flasim e krekosen se e paskan rritur buxhetin e sigurisë, ndërkaq çdo i dyti polic i Kosovës punon punë sekondare për ta ushqyer familjen e vet. Sot, flasim e krekosen se e paskan rritur buxhetin e sigurisë, ndërkaq e bojkotojnë mbledhjen e Komisionit Parlamentar, do të votohej Ligji për pensionim të policëve.

Sot, flasim e krekosen se e paskan rritur buxhetin e sigurisë, ndërkaq qindra ushtarë e policë kanë aplikuar për viza pune në vendet e Evropës. Sot, flasim e krekosen se e paskan rritur buxhetin e sigurisë, ndërkaq që tre muaj nuk janë të zotët ta emërojnë një drejtor të policisë.

Sot, flasim e krekosen se e paskan rritur buxhetin e sigurisë, ndërkaq ushtrinë e trajtojnë me fitra me të ashtuquajturin Fond të Sigurisë që as dreqi s'i bie në fije se çka ka ndodhur me atë fond. Sot, flasim e krekosen se e paskan rritur buxhetin, këta që mashtruan mërgatën dhe i detyruan t'i paguajnë policat e sigurisë.

Sot, flasim e krekosen se e paskan rritur buxhetin e sigurisë, ndërkaq ushtarët e policët ngjajnë me mirëmbajtësit e rrugëve, me uniforma të vjetra e me çizme të shqyera, të cilat nuk janë rinovuar

që katër vjet. Sot, flasin e krekesen për rritje të buxhetit, ndërkaq nuk janë në gjendje ta emërojnë një ministër të Shëndetësisë, kurse shëndetësinë e kemi në kolaps.

Prandaj, respekt për të gjithë ata deputetë që janë ndalur dhe e kanë analizuar këtë buxhet në formë tabelare në detaje, por nuk ia vlen të analizohet një buxhet politik, një buxhet diferencues e diskriminues sikurse ky buxhet që e kemi tani.

Unë nuk do të ndalem në asnjë tabelë, në asnjë shifër. Nuk kam bërë asnjë amendament, sepse e di që amendamentet tona nuk kalojnë, por kam vetëm një pyetje për ministrin e Financave; më intereson ta di se a janë përfshirë në buxhet edhe mjetet e grumbulluara nga Fondi i Sigurisë dhe a jeni në dijeni se jeni të obliguar të deklaroni prejardhjen e të hyrave në këtë buxhet.

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Elmi Reçica.

**ELMI REÇICA:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kolegë të nderuar,

Ministër Murati,

Qytetarë të respektuar,

Realisht për seriozitetin e Qeverisë flet vet prezenca e saj. E kemi veç një ministër, zoti kryetar i nderuar, dhe vërtet është shumë joserioze.

Nëse të gjithë themi që buxheti është shumë i rëndësishëm. Është ligj mbi ligjet. E përcakton jetën nga aspekti financiar të një shtetit për një vit, është joserioze të kemi vetëm ministrin e Financave, Transfereve dhe Punës.

Ndoshta këta mendojnë që mjafton ky. Por, ky emrin e mirë e ka shumë, realisht.

**KRYETARI:** Plus është i Ferizajt. Të mos harrosh!

**ELMI REÇICA:** Po e bëj një digresion, ministër, nëse më lejohet. Përpara kanë lënë një kohë të gjatë emra shumë bashkëkohorë, për shembull: Vlorë, Sarandë, Gjergj ose emra të tjerë, dhe në një familje dikush thotë, nuk po i lini emrat tamam tradicional. Kur i thonë, Hekuran, a thotë, ky paska lidhje me Kuran diçka, emrin e mirë e paska. Përveç që është vendas.

Realisht, thashë për rëndësinë e buxhetit, dhe ju keni deputet njëjtë sikurse unë, ka edhe kolegë të tjerë këtu, por e di saktë që kryeministrat dhe ministrat e Financave, kur ka ardhur çështja e buxhetit kanë kontaktuar, dhe në rastet e shumta dhe në shumicën e rasteve janë marrë vesh edhe me deputetët e opozitës. Nuk e kam parë në këtë kohë këtë, edhe s'jam duke e parë.

Unë mendoj që i bën nder as Qeverisë, as ministrit, po as këtij Kuvendi. Do të duhej realisht në këto situata, sepse po e shohim që një parti politike edhe nëse është më e fuqishmja nuk mund t'i bartë të gjitha proceset vet. Kemi proceset aktuale, e kemi buxhetin dhe shumë çështje të tjera.

Dhe, unë ju kisha bërë ftesë që në këto çështje që janë të rëndësishme, jetike, që janë domethënëse dhe që përcaktojnë se nga po lëvizim ne, vërtet të jemi më konkret dhe më bashkëpunues. Ne kemi shumë raste, ne kemi një ministër të Financave këtu që është deputet, kemi Bedri Hamzën, por ka ditur të komunikojë, të kontaktojë dhe të merret vesh për projekte që janë interes më i gjerë se sa i një partie politike.

Këtë po e them për ta pasur parasysh mes dy leximeve për Projektligjin për buxhetin, leximit të parë dhe pastaj leximit të dytë që do të duhej pastaj edhe të miratohej. Dhe, po kam dëshirë dhe po kam shpresë që vërtet të jetë një akt solemn, jo të jetë një akt ku ka të kënaqur dhe të pakënaqur, po ka edhe nga ata që mendojnë që kanë triumfuar se e kanë realizuar qëllimin e vet, dhe ka të pakënaqur që mendojnë që s'janë marrë parasysh fare.

Të hyj në çështje konkrete se janë diskutuar shumë gjëra dhe nuk dua tash të përsëris për aq sa kam mundësi të mos përsëris. Por, ne e dimë që ky buxhet nuk është zhvillimi dhe duhet ta pranojmë këtë çështje. Ne kemi inflacion zyrtar 20%, por e dimë te shporta e domosdoshme familjare me 7 artikuj, ne kemi mbi 30% inflacion, dobësim të fuqisë financiare për të mbijetuar dhe për të jetuar familjet tona.

Duhet ta them që gjatë këtij mandati, i kam parasysh edhe krizat e ndryshme, situata e ndryshme. Ministër, shtresa e varfër ka shkuar në varfëri të skajshme, shtresa e mesme të është varfëruar, ty dhe gjithë neve, dhe kjo është për shkak të inflacionit të madh dhe për shkak të situatave. Çdo rritje që e keni paraparë këtu, realisht nuk ka mundësi ta mbërri atë çfarë është inflacion, dhe s'do të kenë mundësi që të bëjnë asgjë gjersa nuk ka rritje të pagave dhe nuk ka një pagë dinjitoze për të jetuar një familje, ne do të jemi në situatë të rëndë.

Unë dua të them edhe situata që jetojmë aktualisht ne. Rritja enorme e çmimeve në raportin për vendin shihet që 18% e popullsisë jeton në pragun e varfërisë me 1.5 euro. Kjo është e tmerrshme.

Unë e di që pozita e ka marrë qëndrimin, deputetë e pozitës e kanë marrë qëndrimin, do ta votojnë buxhetin, por mirë është të mos bëni zhurmë realisht, nëse ka mundësi.

**KRYETARI:** Qetësi, ju lutem deputetë!

**ELMI REÇICA:** Ndoshta është e kotë të flasim, por megjithatë duhet thënë, dhe nëse është 18% e popullsisë e cila jeton me 1,5 euro në ditë, realisht e rëndës, është situatë e rëndë.

Ne kemi pasur situata që në rrethana të caktuara, realisht kemi pasur një gjendje goxha të rëndë të varfërisë së skajshme, por me kohë me rritje buxhetore, rritje pagash, kemi arritur që ta tejkalojmë atë situatë. Dhe, kjo është ajo çfarë ne kemi mbërri për kohën tonë dhe për fazat tona.

**KRYETARI:** Qetësi, ju lutem deputetë!

**ELMI REÇICA:** Realisht, është e patolerueshme që në këtë kohë për Zyrën e Kryeministrit të ketë rritje të jashtëzakonshme të buxhetit dhe në anën tjetër të mos ketë rritje, ta zëmë, për trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me ambientin. Rritje të ndjeshme.

Ne e kemi një situatë në regjionin e Ferizajt me trajtimin e ujërave të zeza, ku ministri qëllimisht e ka humbur një projekt, ndërkaq nuk po figuron këtu që duhet marrë me atë projekt.

U përmend edhe më herët çështja e energjisë. Ne e kemi pasur një strategji, keni hequr dorë prej asaj strategjie dhe nuk e keni bërë strategjinë e re. Nuk është e logjikshme të heqim dorë prej diçka nëse s'e kemi realizuar diçka që është për masën tuaj. Dhe, në kohën kur ne po flasim, kur kemi situata shumë të rënda energjetike nga të gjitha aspektet, atëherë do të duhej të mendonim për këtë çështje.

Te çështja e sigurisë. Kjo Qeveri është duke e sjellë situatën që çështja e sigurisë të jetë parësore mbi të gjitha, por kjo nuk përcjellët kjo me ngritje buxhetore. Veriu i Kosovës gjersa nuk përmbillet raporti me Serbinë me një marrëveshje të nënshkruar me garanci ndërkombëtare, do të jetë çështje e sigurisë. Nëse është çështje e sigurisë, pse të lihet kaq anash mbështetja për ushtrinë e Kosovës, për policinë e Kosovës dhe për Agjencinë e Inteligjencës dhe të tjerat. Kjo është e domosdoshme. Nëse e bëni një hap dhe një veprim do të duhej përcjellë atë veprim me çështje konkrete edhe mbështetje financiare.

Shëndetësia. Nuk e mbaj në mend që ka pasur situatë më të rëndë në shëndetësi, më vjen keq ta them, se jemi duke jetuar këtu dhe jam deputet, e kam një pjesë të përgjegjësisë. Por, gjendja në shëndetësinë e Kosovës kurrë s'ka qenë më keq. Njëherë që ne kemi investuar në këtë varfri të familjeve tona, shteti ynë si kuadro të gatshme po ikin ose në spital private ose jashtë vendit, ndërsa nuk e kemi hapur si çështje për diskutim Spitalin Regjional të Ferizajt, ku mund të ofrohen shërbime. Nuk figuron fare, barten nga viti në vit, ndërsa është i bllokuar.

Nuk kemi siguruar rritje të dinjitetshme të pagave. E dimë që do të bëhet me Ligjin për pagat, por duhet përshpejtuar procesin dhe duhet të jenë të përcaktuara qartë nëse duam të kemi një popull të shëndoshë, të kemi qytetarë të shëndosh.

Nuk di sa jemi të vetëdijshëm, sa është Qeveria e vetëdijshme. Por, krahas ambientit, krahas mundësisë për të jetuar mirë dhe krahas situatave të tjera, çështja e shëndetit është e

domosdoshme për të pasur një shtet stabil, një shtet të shëndetshëm, një shtet nga të gjitha aspektet që ne mund të llogarisim në të.

Çështja e rinisë. Ministër i Financave, ke pasur miliona euro të destinuara këtë vit te Ministria e Kulturës për të zhvilluar aktivitete rinia. A e di që 0.18% janë shfrytëzuar ato aktivitete në kohën kur rina po na ikë. Merreni dhe shikojeni te Departamenti i rinisë, sa donacione e grante dhe mundësi financiare i janë ofruar rinisë. Dhe, kjo është e patolerueshme.

Në kohën kur po zbrazet Kosova, ne nuk investojmë te rinia jonë. Paratë që kanë qenë të përcaktuara dhe të votuara në rishikimin e buxhetit. Dhe, kjo është ajo që nëse ne nuk jemi të gatshëm për të ndryshuar mes këtyre dy leximeve, do të jetë një buxhet që s'do të jetë i zhvillimit, as i fuqizimit, por do të jetë një buxhet mezi do ta mbajë me frymën e fundit shtetin.

S'po flas për komunat në të cilat është qëndrim, sikurse është yti zoti kryetar i Kuvendit, qëndrim që ne e mbështesim, ai i Asociacionit të Komunave të Kosovës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia shtoni pak kohë për fjalën e tij, zotit Reçica!

**ELMI REÇICA:** Qëndrim i tyre është, nuk jeni duke i përfillur komunat. Lëreni politikën, lëreni kush është. Qysh kenë ardhur ju, mund të vijnë kryetarë komunash të partive të tjera. Ndhimojini komunat, të mos i izoloni.

Secili projekt kur e sheh këtu, për të mos përimtuar, se kanë folur të gjithë, realisht shihet që janë të bllokuar. Nuk ju bën nder kjo as juve, po aq më pak i ndihmon zhvillimit të këtij vendi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Diskutuesi i fundit, deputeti Abelard Tahiri, kryetar i Grupit të PDK-së.

**ABELARD TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ajo që më ka bërë më së shumti përshtypje është kur Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur që të gjitha të hyrat vetjake të komunave, të mbledhura para vitit fiskal 2022, dhe të pashpenzuara, të bëhen pjesë e Fondit të Kosovës në bilancin bankar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky veprim i Qeverisë së Republikës së Kosovës i manifestuar në projekt-buxhetin që po diskutojmë sot, është në kundërshtim të plotë me nenin 124 të Kushtetutës së Kosovës, i cili u jep mundësi qytetarëve nëpër komuna që të organizohen në vetëqeverisje lokale dhe pikërisht në



pikën 5, ku thotë: “Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta, si dhe të marrin fonde nga qeveria qendrore”.

Pra, këto janë të hyra të qytetarëve, të cilat mblidhen nga komunat të cilat ata i votojnë, dhe në fund të ditës, edhe nëse s’arrijnë të shpenzohen në atë vit, pra, që s’kanë arritur të shpenzohen në vitin 2021, barten në vitin tjetër. Pra, janë fonde të cilat nuk u mohohet e drejta e shfrytëzimit, sepse janë taksa të paguara konform Kushtetutës së Kosovës, në qytetet ku ata jetojnë.

Është kundërkushtetuese që të tash i bie, qytetit të Prishtinës, ose kryeqytetit të Kosovës që i ka diku mbi 35 milionë euro të pashpenzuara të vitit 2021, të merren dhe të shpërndahen nëpër qytete të tjera, të çohen 25 milionë euro në Shtime. Është e patolerueshme, sepse janë taksa të qytetarëve të Prishtinës dhe duhet shpenzuar në Prishtinë.

Prandaj, ne do të bëjmë një amendament që këtë pjesë ta heqim nga projekt-buxheti, dhe nëse ju nuk do të na përkrahni, ne padyshim që do ta dërgojmë në Gjykatë Kushtetuese këtë buxhet, sepse është buxhet në kundërshtim me nenin 124, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky është projekt-buxheti i tretë i kësaj Qeverie që e sjell. Dy vite buxhetore i ka konsumuar kjo Qeveri. Pra, në vitin 2021 i ka pasur në dispozicion 2,4 miliardë euro, në vitin 2022 i ka pasur në dispozicion 2.7 miliardë euro, dhe në total, pra në vitin 2021 i ka shpenzuar 2,26 miliardë euro, ndërsa deri në shtator të këtij viti i ka shpenzuar 1,55 miliard euro.

Me këtë trend, besojmë që në këtë vit, do të arrijë shpenzimi deri në 2 miliardë euro. Pra, komplet, 50% e mandatit të kësaj Qeverie, janë shpenzuar diku rreth 4 miliardë euro.

Të nderuar kolegë,

E ka kryer 50% të mandati, na kanë mbetur edhe pak ditë dhe hyjmë në vitin e ri, dhe i kemi 4 miliardë të shpenzuara nga kjo Qeveri në forma të ndryshme; në projekte kapitale, në paga, në subvencione, mëditje, pensione e kështu me radhë.

Mirëpo, cili është efekti i tyre në ekonominë e vendit tonë? Cili është efekti i tyre në shëndetësi? Pas shpenzimit të këtyre 4 miliardë eurove, dy buxheteve, cili është efekti në shëndetësi? A kemi sot shërbime më të mira? A kemi sot spitale më të rinovuara, më të kompletuara me pajisje për dy vitet? A kemi sot largim të qytetarëve tanë në drejtim të spitaleve private qoftë në Kosovë, qoftë në rajone të tjera? Absolutisht, po! Dhe, kjo në masë shumë të madhe fatkeqësisht.

Pra, dy vite të qeverisje suaj, e keni harxhuar tashmë 50% të mandatit, po e përmbyllim vitin e dytë buxhetor, dhe efekti juaj në shëndetësi, efekti i qeverisje suaj, fatkeqësisht është degradues. Ato shërbime veçse kanë shkuar duke u degraduar, jo duke u avancuar.

Kur e shohim ekonominë. Le të themi, nëse kjo Qeveri bie sot, a ma thotë dikush cila është një iniciativë e kësaj Qeveri që po mbetet në gjysmë? A ka një iniciativë të kësaj Qeverie që po mbetet në gjysmë nëse kjo Qeveri e përfundon mandatin sot? Ta zëmë, për një arsye vendos kryeministri të japë dorëheqje. Asnjë iniciativë.

Imagjinojeni, 50% e mandatit tuaj, asnjë iniciativë, sot nëse shkon Qeveria në shtëpi, nuk iu mbetet në gjysmë. Të gjitha janë projekte të cilat i keni vazhduar nga qeverisjet e kaluara. Këtë më së miri e dëshmon edhe shuma e investimeve kapitale.

I kemi 594 milionë euro investime kapitale, dhe nga këto, 543 milionë euro janë investime të bartura nga viti 2022. Pra, vetëm 9% e investimeve kapitale apo dikur rreth 50 milionë janë projekte të reja që Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i fillojë në vitin 2023.

Kur jemi te arsimit për këto dy qeverisje, a ka ndikuar, a është përmirësuar cilësia në arsim? Absolutisht, jo. Sot, shohim se edhe për vitin e ardhshëm buxhetor, fatmirësisht janë në projekt-buxhet një numër i konsiderueshëm i shkollave, mirëpo asnjë projekt nuk është i cili do të ndihmojë në ngritjen e cilësisë dhe shërbimeve më të mira në universitetet tona publike.

Pra, kjo punë që po e bën Ministria e Arsimit sot, më shumë ngjason me punën e komunave, që është përgjegjësi e komunave që të ndërtojnë shkolla, apo me Ministrinë e Punëve të Brendshme që e ka departamentin për inxhiniering, dhe e cila është përgjegjëse që të ndërtojë objekte, por jo Ministria e Arsimit.

Pra, edhe viti i ardhshëm, edhe viti 2023, kur e shohim rritjen të cilën e kemi pasur në sektorin e shëndetësisë, lë shumë për të dëshiruar, lë jashtëzakonisht shumë për të dëshiruar. Bile-bile me atë rritje nuk do të mund t'i përmbushim as obligimet tona shtetërore në listën esenciale të barnave.

Në anën tjetër, nuk kemi buxhetim të Ligjit të pagave. U tha me plotë të drejtë më herët edhe nga kolegët tanë, kërkohet nga sektori privat që t'i rrisin pagat, sepse po rritet fitimi i tyre, ndërsa atë që e ka përgjegjësi ta bëjë vetë, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk e bën. Është e papranueshme.

Ju a e shihni demobilizimin e ushtarëve të ushtrisë sonë? A e shihni kërkesën e policëve që të lirohen nga detyra? A e shihni numrin e mjekëve që e kanë lënë sistemin tonë shëndetësor.

Kolegë deputetë,

Për 2 vjet, më pak se 2 vjet, 350 mjekë e kanë lënë sistemin tonë shëndetësor. 4 mijë e 80 janë të licencuar nga Oda e Mjekëve. Pra, afër 10% e mjekëve për 2 vjet e kanë lënë sistemin tonë. Ju e dini sa merr kohë të përgatitet një mjek, një specialist. Ajo s'bëhet për 2 vjet bre. Ky është dëm i madh.

Kolegë deputetë,

Ky është dëm i madh. Kjo do të thotë që qytetarët tanë do të vazhdojnë t'u drejtohen spitaleve tona private edhe në vitin 2023, sepse as listën esenciale të barnave me këtë buxhet nuk do të mund ta përmbushim.

Kjo do të thotë që me këtë paga mjekët tanë do të vazhdojnë me këtë trend ta lëshojnë shëndetësinë në Kosovë. Ta lëshojnë sistemin tonë shëndetësor. Pra, vendi duhet të qeveriset konform nevojave çfarë ka. Nëse është e nevojshme që të mos jetë asnjë projekt në investime kapitale, mirëpo të investohet në shëndetësi, ajo duhet të ndodhë.

Pra, shërbimet shëndetësore, ta keni parasysh, në bazë të studimeve të Bankës Botërore, në Kosovë janë ato që më së shumti e varfërojnë familjen kosovare, sepse s'arrin shteti t'i përmbushë obligimet e veta që i ka karshi qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ajo që është shumë e rëndësishme dhe që më ra në sy për të keq fatkeqësisht, është Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Ne e kemi plotë gojën luftë kundër krimit të organizuar, luftë kundër korrupsionit. Kush e lufton korrupsionin? Kush janë njerëzit të cilët janë të thirrur të bëjnë luftë kundër krimit të organizuar e të korrupsionit në Kosovë?

Janë pikërisht prokurorët, dhe çka po ndodhë sot? Sot kem zbritje të buxhetit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Kolegë deputetë,

Është e papranueshme. Është e papranueshme që Këshillit Prokurorial të Kosovës nga 17 milionë e 144 mijë euro që e ka pasur buxhetin në vitin që po e lëmë, tanimë në vitin ardhshëm do ta ketë 15 milionë e 913 mijë, apo 1 milion e 230 mijë euro më pak, që i bie mbi 7% më pak. Ne do të duhej t'ia shtonim jo 7%, 70% më shumë, sepse të gjithë kemi kërkesë për një angazhim më të madh të prokurorëve të Shtetit për luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Dhe, ju e bëni të kundërtën? Ju e zbrisni buxhetin e Këshillit Prokurorial, që e pamundëson rekrutimin e prokurorëve të rinj.

E zbrisni buxhetin e Këshillit Prokurorial që e pamundëson luftën kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit.

Kush do ta luftojë korrupsionin? Kush? Po, prokurorët janë ata të cilëve u jep mandat Kushtetua. Dhe, ju në këtë rast me këtë projekt-buxhet e keni zbritur buxhetin e këtij institucioni mjaft të rëndësishëm.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky projektligj, nëse doni mund ta quajmë që është hakmarrës, nëse doni kundërkushtetues, nëse doni diskriminues, por vetëm një buxhet që i përshtatet nevojave të Kosovës, nuk mund të themi që është.

Prandaj, ne shpresojmë që ju do të gjeni kurajën që gjatë dy leximeve të bashkëpunojmë dhe t'i adresojmë një pjesë të çështjeve të cilat janë preokupim edhe i Asociacionit të Komunave që përfaqësojnë kryetarët e komunave të Kosovës, edhe shqetësim i qytetarëve të Republikës së Kosovës, edhe shqetësim i Këshillit Prokurorial të Kosovës, edhe shqetësim i shumë e shumë institucioneve...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia zgjatni edhe pak fjalën zotit Tahiri!

**ABELARD TAHIRI:** Kërkojmë që të gjeni kurajën që të bashkëpunojmë që t'i adresojmë çështjet që kanë ndalë pikërisht nga Asociacioni i Komunave. Nuk duhet të jetë një buxhet hakmarrës. Nuk duhet t'i hakmerreni asnjë qyteti.

Prishtina në zgjedhjet nacionale ua ka dhënë 67%. Pse s'e keni fituar komunën gjashtë muaj më vonë, nuk duhet të diskriminohet Prishtina.

Nuk duhet t'u merren taksat qytetarëve të Prishtinës, mbi 35 milionë të pashfrytëzuara edhe për shkak të mungesës së OSHP-së dhe t'u drejtohen qyteteve të tjera, sepse janë taksa që kanë paguar qytetarët e Prishtinës, ashtu siç janë të Pejës, të Gjakovës, të Skenderajt, të Drenasit, e të gjithë të tjerëve.

Pra, taksat e tyre duhet të mbeten në qeveritë lokale dhe të shfrytëzohen për nevojat e tyre. Faleminderit!

**KRYETARI:** Edhe Ariana Musliu-Shoshi është paraqitur për diskutim.

**ARIANA MUSLIU-SHOSHI:** Faleminderit, kryetar! Të lutem e mbanë qetësinë, sepse është problem të koncentrohemi!

**KRYETARI:** Jo, a po e sheh sa deputeti ka ardhur të të dëgjojë, a nuk po i sheh a?

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Zoti ministër,

Është mjaft shqetësuese që në objektivat e kësaj Qeverie nuk pashë buxhet të ndarë për planifikim për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare.

E dimë që anëtarësimi në Këshill të Evropës, anëtarësimi në Bashkimin Evropian, anëtarësimi në NATO apo anëtarësimi në organizata të tjera ndërkombëtare, në vete përmban kosto financiare.

Ndërkaq, në planifikimin buxhetor atë që e pashë për vitin 2023, 2024, 2025, nuk ka planifikim buxhetor, pra nuk ka buxhet të ndarë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. E pashë që nga kolegët tanë pati lëvdata, pati sharje sa i përket buxhetit, mirëpo mua më intereson konkretisht vetëm kjo pjesë se a keni planifikuar buxhet për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, konkretisht në Këshill të Evropës dhe në Bashkimin Evropian. Faleminderit!

KRYETARI: 82 deputetë qenkemi në sallë.

Të nderuar deputetë,

Përgatituni për votim, po e hedhim në votim Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

82 deputetë janë në sallë. Votohet për projektligjin, i cili është në shqyrtim të parë. Pra, kërkohet votim në parim i këtij projektligji.

Kush është për këtë projektligj? Kush është kundër këtij projektligji? Kush abstenon për këtë projektligj?

65 deputetë kanë votuar për këtë projektligj. 64 vota për, 1 votë kundër dhe asnjë abstenim, kështu që konstatoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi në parim Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL për Buxhet, si dhe nga komisionet e tjera parlamentare sipas fushave që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin me kohë raportin bashkë me rekomandime.

Me këtë rast i mbyllim punimet e kësaj seance, sepse kaq kanë qenë pikat e planifikuara që t'i shqyrtojmë. Mirupafshim në seancat e ardhshme!

*E përgatiti:*

*Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*